Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 1 (164) / 2020. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
NË PESHKOPI
Çdo muaj me
SUPER OFERTA

REPORTAZH

Në Vranjt, aty ku rrezaton drita e diturisë

Nga **MEVLUD BUCI**



8

HISTORI

Atdhetari Elez Murrja

Nga **ARIF MURRJA**



19

HISTORI SUKSESI

Elisabeta Skarra: ushqimin duhet të ta hajë syri e pastaj goja



REPORTAZH: GURI QË SJELLË VDEKJE, LËNDIME, LARGIME NGA PUNA E QË S'PASURON MINATORËT.



Foto: © Atdhe Mulla / K2.0.

Tërmetet e minatorëve të Bulqizës

Nga **NGADHNJIM AVDYLI / K2.0**

Vështirë se Bulqiza do t'i binte ndokujt në vesh po të mos ishte për "gurin e zi me xixa". Vendasit e qytezës veri-lindore të Shqipërisë kështu i referohen kromit, që gjendet me bollëk aty, në minierën më të madhe të këtij minerali në vend. E gjithë jeta e tyre është e lidhur me minierën, ashtu siç u ndërtua edhe qyteza rreth saj.

"Vështirë se mund ta gjesh dikë në Bulqizë që s'ka dikë të afërm a që s'ka punuar vetë nga miniera", thotë një bulqizak.

Prodhimi i kromit në Bulqizë nisi gjatë pushtimit fashist italian, diku kah viti 1942, duke shfrytëzuar mineralin mbi sipërfaqe të tokës. Pas disa vitesh, në fillim të 1948-ës nisi punën miniera nën qeverinë komuniste shqiptare, e në dekadat pasuese kërkimet për krom u avancuan në "kërkime vertikale".

Aty u punësuan qindra minatorë — banesat e para në qytezë, dy e tri katëshe, u ndërtuan për ta në vitet '60 – '70. Përveç minatorëve, në Bulqizë bënin punë të detyruar edhe të burgosurit e asaj kohe, siç ishte praktikë përgjatë regjimit komunist.

(Lexoni në faqen 4-6)

ANALIZË KRITIKE E JETËS DHE VEPRËS SË SKENDERBEUT

Epoka e Gjergj Kastriotit, bazament i vetëdijes kombëtare



Portreti i parë zyrtar origjinal i Gjergj Kastrioti Skënderbeut në një miniaturë të vendosur në kodin "De Romanorum Magistratibus" të shkruar nga Andrea Domenico Fiocco publikuar më 5/11/1465.

Nga Dr. **ENVER HALILI** - FAQE 20,21

NË BRENDËSI:

- Minatorët e Bulqizës protestojnë në Tiranë
- Sindikata e re, lëvizje që duhet mbështetur përballë interesave dritëshkurtër
- Dilemat e Shpendit
- Fiti Capa, një histori dashurie dhe mbijetese
- Për misionin e Enver Kaloshit, arketipin Llan Kaloshi dhe Irfanin - një Kalosh
- Gjithmonë më është dukur se punës i kam mbetur borxh
- Fatmir Terziu mes dibranëve...
- Kur jetën ta prezanton ferri
- Jehon kënga dhe vallja e Folk Alb "Hazis Ndreu"
- "Kushëriri i ëngjëjve"
- Botim: Hazis Ndreu - Personaliteti, krijimtaria
- Ramadan Perhati, heroi i gjallë e njeriu i urtë
- Ushtimat e një mentari
- Musa Lala, ikja pa kthim e një ikone
- Ndahet nga jeta veterani Elez Murra

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 11/12 (163). Nëntor - Dhjetor 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Janar 2020.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Kamber FARUKU
Ngadhnjim AVDYLI /K.0
Atdhe MULLA /K.0
Geri EMIRI
Enver HALILI
Namir LAPARDHAJA
Bajram XHAFA
Mevlud BUCI
Ilmi DERVISHI
Xhafer MARTINI
Halil RAMA
Arif MURRJA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

DEKLARATË E SINDIKATA E MINATORËVE TË BASHKUAR TË BULQIZËS

“Kompania, në shkelje të ligjit, vazhdon të refuzojë që ne jemi përfaqësuesit e punëtorëve, prandaj sot jemi mbledhur këtu, për të treguar se nuk i kemi numrat vetëm në letër.

Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës prej javësh është sindikata më e madhe në kompani dhe përfaqësuesja e punëtorëve! Më shumë se 320 minatorë janë anëtarësuar në sindikatën tonë! Që prej themelimit, rruga e sindikatës sonë nuk ka qenë aspak e lehtë. Ashtu siç është shumë e rëndë përditshmëria jonë nëpër galeri.

Kompania ka pushuar në mënyrë të paligjshme 4 prej drejtuesve të sindikatës. Shumë të tjerëve iu ka bërë dhe vazhdon t’iu bëjë presione. E megjithatë ne jo vetëm që nuk jemi tërhequr, por jemi bërë më të fortë!

Si sindikata më e madhe, jemi përfaqësues të punëtorëve. Na takon negocimi i kontratës së re kolektive, me kushte më mira pune, paga më të larta e trajtim më dinjitoz për minatorët! Por kompania, në shkelje të ligjit, po përpiqet të zvarrisë këtë gjë.

Kemi bërë disa kërkesa gjatë grevës së parë, por kompania nuk i ka marrë parasysh!

Kemi kërkuar një kopje të kontratës kolektive aktuale, por ajo nuk gjendet askund, madje nuk e ka parë asnjë punëtor.

Kemi kërkuar nisjen e bisedimeve për kontratën e re kolektive. Në shkelje të ligjit, kompania dhe shteti nuk na kanë kthyer përgjigje!

Kemi kërkuar të hyjmë në kompani dhe të takojmë anëtarët e sindikatës, siç thotë edhe ligji. Në shkelje të tij, nuk na janë përgjigjur!

Kemi kërkuar që të ndalojnë presionet ndaj anëtarëve të sindikatës sonë. Në shkelje të ligjit, vazhdojnë me presione!

Kemi kërkuar që t’na kthejnë në punë neve që na kanë larguar padrejtësisht, por ata vazhdojnë me paligjshmëri!

Sindikata e vjetër nuk ka bërë asgjë për minatorët. Nuk e ka ngritur zërin për asnjë nga kërkesat që ne kemi prej vitësh. E vetmja gjë që ka bërë ajo sindikatë deri më sot, kanë qenë pazaret në kurriz të minatorëve.

Po ashtu, në bashkëpunim me kompaninë, agallarët e sindikatës së vjetër po bëjnë presione e kërcënime për të detyruar punëtorët që të bëhen pjesë e tyre. Ne iu bëjmë thirrje që të heqin dorë sa më parë nga këto praktika të jashtëligjshme, madje kriminale. Ju bëjmë thirrje edhe shokëve minatorë që t’na lajmërojnë për këto raste. Ne do të marrim gjithë masat e nevojshme ndaj këtyre që bëjnë vetëm dallavere.

Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës ka vendosur një standard të ri në organizimin punëtor në Shqipëri. Më në fund kemi një sindikatë e cila nuk drejtohet nga njerëz me kostume të shtrenjtë e makina luksoze. Më në fund kemi një sindikatë që drejtohet nga të gjithë ne, punëtorët e ndershëm që ia dimë hallet njëri-tjetrit.

Pavarësisht heshtjes së turpshme mediatike, mbështetja për ne është e madhe, nga njerëz të thjeshtë dhe nga sindikata të mëdha nga Evropa dhe bota.

Sot, me vendosmëri i kërkojmë kompanisë dhe shtetit që t’i vënë gishtin kokës dhe të pranojë sindikatën tonë si përfaqësuese të punëtorëve. Kërkesat e minatorëve janë të thjeshta dhe të qarta:

- Negocimi i kontratës kolektive me sindikatën tonë;
- Rritja e pagës;
- Rishikimi i normës;
- Pagesa e shpërblimit të fundvitit;
- Njohja e vështirësisë dhe vjetërsisë në punë;
- Dëmshpërblimi i punëtorëve për aksidentet në punë;
- Ndalimi i presioneve ndaj minatorëve;
- Rikthimi në punë i minatorëve të pushuar padrejtësisht.

Sot nga këtu i bëjmë thirrje shtetit, mediave dhe gjithë shoqërisë, që të kthejnë kokën nga minatorët e Bulqizës dhe nga Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, për të mbështetur përpjekjen tonë që është shembulli i vetëm i një organizimi demokratik në 30 vitet e fundit.” / 21 janar 2020

REAGIM ZYRTAR I ALBCHROME SHPK LIDHUR ME SHKARKIMIN E 4 MINATORËVE NË BULQIZË

Duke marrë shkas nga disa spekulime që janë bërë ditët e fundit lidhur me largimin nga puna të 4 minatorëve nga ana e kompanisë AlbChrome shpk, dëshirojmë të sqarojmë mediat dhe opinionin publik si më poshtë:

• Më 16 Dhjetor 2019, kompania AlbChrome është njohur zyrtarisht për krijimin e një sindikate të re, atë të Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës. 21 minatorë nga 652 minatorët e AlbChriome na rezulton se janë pjesë e kësaj sindikate. 4 prej tyre pasi janë paralajmëruar disa herë për shkeljet e vazhdueshme të kontratës së punës dhe rregullores së brendshme të kompanisë, janë shkarkuar nga puna për vazhdimin e përsëritur të shkeljeve në fjalë, si mungesa të pajustifikuara në vendin e punës.

• AlbChrome dëshiron të sqarojë se respekton të drejtën ligjore të çdo punonjësi për tu grupuar në sindikata të tilla. Nëse kompania nuk do ta respektonte një të drejtë të tillë, reagimi i saj nuk do të kishte prekur vetëm 4 nga anëtarët e sindikatës së mësipërme, por edhe minatorë të tjerë të AlbChrome, të cilët sindikata në fjalë pretendon se janë anëtarë të saj. Nga ana tjetër, vërtet janë larguar 4 minatorë nga puna për shkeljet e përmendura, por janë punësuar menjëhere 4 minatorë të tjerë në vendet e tyre.

• Dëshirojmë të sqarojmë gjithashtu se AlbChrome ka në fuqi një kontratë kolektive me Federatën e Sindikatave të Industrisë, anëtare e Konfederatës të Sindikatave të Shqipërisë.

• AlbChrome i trajton punëtorët e saj me normë dhe u jep pagën e 13-të çdo vit. Ky trajtim, është më dinjitozi i mundshëm në krshasim me secilën prej 36 kompanive të tjera të shfrytëzimit të kromit në vend dhe ftojmë këdo që ta verifikojë nga pranë këtë.

• Gjithashtu, nëse do të kishte patur ndonjë tendencë ndaj minatorëve apo sindikatave, AlbChrome nuk do të kishte punësuar 100 punonjës të rinj vetëm gjatë vitit të fundit dhe nuk do të hapte perspektivën për 200 punësime të reja në vijim falë investimeve të kryera vitin e fundit, të cilat kanë rritur ndjeshëm sigurinë për minatorët.

• Sakaq, vërejmë me keqardhje se prapa 4 minatorëve të larguar nga puna dhe krijimit të sindikatës së tyre qëndron një lëvizje politike, e cila ka qenë amplifikatori që një ngjarje të zakonshme dhe të brendshme të një kompanie private, ta paraqesë si një çështje të rëndë dhe me pasoja edhe për minatiorë të tjerë.

• Sipas Kodit të Punës, kur punonjësi braktis vendin e punës dhe nuk njofton brenda 7 ditëve arsyen e mungesës, konsiderohet si zgjidhje e njëanshme e kontratës nga punonjësi (madje sipas kesaj dispozite, nenit 156, punëdhënësi gëzon të drejtën e dëmshperblimit). Gjithashtu në kontratën individuale të punës, palët kanë parashikuar që kur punonjësi bën më shumë se 7 mungesa pa arsye në një vit, punedhënësi gëzon të drejtën e zgjidhjes se njëanshme të kontratës së punës. Kjo ka ndodhur edhe në rastet tona, megjithatë duam të theksojmë se largimi i tyre është bërë për shkelje të ndodhura përpara se ata ta vinin në dijeni kompaninë për krijimin e sindikatës.

• Ftojmë të gjitha mediat që të vijnë të investigojnë nga prane ngjarjen, për të parë se si qëndron e vërteta. / 27.12.2019

NJOFTIME

Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t’i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6**
ose në faqen tonë
www.rrugaearberit.com

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë.
Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing.
Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.



Pamje nga protesta e minatorëve.
Foto: © Sami Curri

Minatorët e Bulqizës protestojnë në Tiranë

Albchrom: Kemi rritur investimet dhe numrin e të punësuarve

Nga **BUJAR KAROSHI**

Dhjetëra minatorë të Bulqizës protestuan më 26 janar në Tiranë, në një përpjekje për tu dëgjuar zëri i tyre nga institucionet qeveritare dhe kompania Albchrom. Ata u tubuan përballë Ministrisë së Financave ku bënë edhe njëherë publike kërkesat e tyre. Në një pankartë të madhe kishin shkruar kërkesat kryesore, mes të cilave është negocimi i kontratës kolektive më Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, rritjen e pagë, rishikim të normave të punës, njohjen e vështirësisë dhe vjetërsisë, dëmshpërblim për aksidentet në punë, ndalje presioneve dhe rikthimin e drejtuesve të sindikatës në punë, të pushuar padrejtësisht.

Protesta kaloi edhe në fushën e sportit të stadiumit të ri Air Albania. Në ndeshjen e Partizani - Kukësi, tifozët shpalosën banderolën me shkrimin "Me Minatorët e Bulqizës".

Raportimet mbi grevën e minatorëve i kanë raportuar pak disa media, përfshirë Birn Albania, Deutche Welle dhe Zëri i Amerikës, por media kryesore në vend ka heshtur për to. Sindikata akuzon kompaninë Albchrome se ka ndikuar me reklama ndaj këtyre mediave për ndaluar raportimin. Madje në dy emisione më të rëndësishme në vend, Opinion dhe Fiks Fare u shfaqën raportime nga terreni që dukshëm flisnin pro kompanisë.

* * *

Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës (SMMB) është njohur nga Gjykata e Tiranës me 15 tetor 2019, por qysh kur ajo shpalli themelimin e saj në qendër të qytetit të Bulqizës më 17 nëntor 2019, përplasjet mes kompanisë Albchrom dhe drejtuesve të saj kanë ardhur gjithmonë e në rritje.

Një javë pas tubimit themelues, më 23 nëntor 2019, kryetari i sindikatës Elton Dobreshi u pushua nga puna me argumentin se kishte shkelur etikën e punës dhe nuk e kishte respektuar orarin. Pas këtij veprimi, më 25 nëntor minatorët nisën grevën.

Pas kësaj kohe ndaj punëtorëve dhe anëtarëve të sindikatës ka pasur presione nga kompania dhe Federata e Sindikatave të Industrisë, anëtare e Konfederatës të Sindikatave të Shqipërisë, e cila deklaron se është ajo që ka nënshkruar kontratën kolektive më kompaninë Albchrom. Ata u bëjnë presion punëtorëve që të mos anëtarësohen me sindikatën e re dhe të mos bëhen pjesë e grevës.

"Sindikata e vjetër në bashkëpunim me kompaninë Albchrome, kanë nisur një presion të pashembullt ndaj minatorëve, duke i kërcënuar deri në pushim nga puna nëse nuk rianëtarësohen në radhët e tyre. Kjo fushatë terrori ka nisur me qëllim që kjo sindikatë të legjitimojë negocimin e kontratës së re kolektive me kompaninë. Kjo sindikatë e korruptuar, që gjithmonë ka mbrojtur interesat e pronarëve dhe të partisë, sot po vazhdon aleancën kundër minatorëve!", shkruajnë në një reagim të tyre drejtuesit e sindikatës së re.

Sindikata e re e minatorëve pretendon se deri më tani ka të anëtarësuar mbi 320 minatorë dhe është sindikata më e madhe në kompani, ndaj duhet të jetë ajo që duhet të nënshkruajë kontratën e re me kompaninë.

Pas pushimit nga puna të kryetari të sindikatës, kompani Albchrom ka pushuar nga puna edhe tre drejtues të tjerë të sindikatës me të njëjtën akuzë. Një kontroll i Inspektoratit të Punës nuk ka gjetur shkelje ligjore, dhe kjo i ka acaruar marrëdhëniet mes sindikatës dhe kompanisë.

"Galeritë e kromit në Bulqizë dhe Martanesh kanë shkaktuar vdekjen e 27 minatorëve në pesë vitet e fundit dhe plagosjen e dhjetra të tjerëve. Ndërkohë në dy vitet e fundit, vetëm në galeritë e kompanisë AlbChrome janë raportuar 12 të plagosur. Në harkun kohor të 7 viteve në galeritë e Albchrome kanë humbur jetën 8 minatorë" raporton media online "Bulqiza ime".

Një aksident ndodhi edhe me 6 janar të këtij viti, ku u plagosën dy minatorët Altin Kola dhe Mentor Gjeta. SMBB akuzoi kompaninë për shkeljen e rregullave të sigurisë, por nga ana tjetër Albchrom deklaroi se "aksidenti kishte ndodhur për shkak të një gabimi njerëzor nga një tjetër minator dhe se po jep mbështetje maksimale për dy punonjësit dhe po bën maksimunim që ata të rikthehen në shëndet të plotë sa më parë".

ALBCHROM: GREVA, NJË PËRPJEKJE PËR TË DESTABILIZUAR MINIERËN E KROMIT NË BULQIZË

Që nga nisja e grevës kompania Albchrom ka shpërndarë njoftime të ndryshme për median, edhe në faqen zyrtare të saj në Facebook.

Kompania e ka quajtur grevën e minatorëve një përpjekje "për të destabilizuar veprimtarinë minerare në Minierën e Kromit Bulqizë". "Pavarësisht se në rajonin krommbajtës të Bulqizës zhvillojnë veprimtarinë 36 leje minerare disa subjekte të ndryshme, lëvizjet e këtij grupimi rezultuan të fokusoheshin vetëm në veprimtarinë e Albchrome", komenton kompania mbi grevën e minatorëve.

Sipas Albchrom, edhe pse "ka pësuar ulje çmimi i ferro-kromit në tregun botëror prej mëse 1 viti dhe pasojave që ka sjellë një gjë e tillë në shitje dhe prodhim për disa kompani, AlbChrome nuk e ka shkurtuar stafin në Bulqizë dhe vazhdon me kapacitet të plotë prodhimin falë menaxhimit efikas dhe investimeve".

Albchrom thotë se kontrollet e imtësishme nga Inspektoriati i Punës nuk kanë zbuluar asnjë shkelje minimale. Ajo deklaron se "është i vetmi subjekt që operon në industrinë minerare në RSH që ka lidhur Kontrata Kolektive me Sindikatat në mbrojtje dhe përforcim të kushteve të punës. Dhe pikërisht për këtë Minierë ka një kontratë kolektive në fuqi, kushtet e së cilës Palët vazhdojnë ti përmbushin me korrektësinë maksimale".

Kompania deklaron se investimet në vitin 2019 në minierën e Bulqizës kapin vlerën 27.3 milionë USD dhe së fundmi ka nisur funksionimin i një vargu të tërë investimesh, Pusi numër 9, investimi më i madh në sektorin minerar në Shqipëri gjatë 30 viteve të fundit, një investim që nuk ngjen të ngjarë as në epokën e komunizmit.

Kompania deklaron se është një punëdhënës mjaft i madh. "Që kur AlbChrome mori në zotërim minierën kryesore të Bulqizës, numri i punonjësve të saj është shtuar me mbi 400, kryesisht me të punësuar të rinj nga qyteti i Bulqizës".

Aktualisht janë të punësuar mbi 1200 punonjës, nga 841 që kanë qenë më 2013, dhe pritet që numri i personelit të shtohet me të paktën 200 profesionistë të tjerë në subjektet e Minierës së Kromit në Bulqizë, në Traverbankun e Klosit, në Impiantin e seleksionimit në Klos, në Uzinën e Ferrokromit në Burrel, dhe në Uzinën e Ferrokromit në Elbasan.

Gjithashtu kompania ka bërë publike edhe për financime të tjera jashtë minierës, si mbështetje me bursa, investime në infrastrukturën shkollorë, krijime laboratoresh etj.

Gjithashtu, kompania ka bërë të ditur edhe nisjen e projektit të hapjes dhe zhvillimit të vendburimit të Qafë Buallit, ku për hartimin e projektit të zhvillimit dhe projekteve teknike është kontraktuar një kompani kinezë nga më të njohurat në botë.

Sipas kompanisë, kosto totale e investimit do të jetë rreth 25 milionë dollarë dhe periudha e realizimit të këtij investimi shkon në rreth 2 vite. Jetëgjatësia e këtij vendburimi është përllogaritur për rreth 12 vite me një kapacitet prodhues 100.000 ton/vit.

***

Kur kanë kaluar dy muaj nga nisja e grevës, palët duket se nuk janë të gatshëm të bisedojnë me tyre. Ndërsa institucionet qeveritare duket se e vëzhgojnë situatën në heshtje. Një nga premtimet kryesore të kësaj qeverie, miratimi i statusit të minatorëve, mund të jetë një çështje që mund ti ulë palët në bisedime dhe të gjendet një zgjidhje aftagjatë.

SHËNIM

Sindikata e re, lëvizje që duhet mbështetur përballë interesave dritëshkurtër

Nga **GERI EMIRI**

"Shikoni...menojeni vetë, kur nuk e çajnë kokën për Bulqizën që punon hala, si po menokan për ne?". Gjen fuqi të thotë fjalinë e fundit minatori i vjetër.

Mirditori me gjasë nuk jeton më. Silikoza atij dhe shumë kolegëve ja kishte ngrirë mushkëritë nga thithja e kristaleve të pluhurit që lëshonin shkëmbinjtë sa herë shpoheshin në kërkim të mineralit. Lë mënjanë librin e mjeshtrit të reportazhit të gazetarisë shqiptare, të ndjerit Fatos Baxhaku dhe rrëmoj në kompjuter.

Gjej një fotografi të shkrepur në galeritë e Minierës së Bulqizës. Një minator i zhytur në pluhurin që lëshon shkëmbi, proporcionalisht me nivelin e zhytjes së martelit në të. Të punosh në minierë nuk është thjesht një rutinë që nis e mbaron në një orar të caktuar, çdo ditë, me një pagë, e ku nuk ke shumë kokëçarje.

Pasi minatorët humbin kontaktin me dritën e diellit, mbeten ata, elektriku mbi kokë dhe brendësia e malit. Fëmijët presin me ankth orarin e kthimit të babait, shpesh lajmi i kobshëm ka mbërritur në familjet bulqizake dhe qytezat minerare. Prej 6 vitesh në Bulqizë humb jetën në minierë mesatarisht një punëtor në çdo 2 muaj. Nuk di të ketë ndonjë profesion tjetër në vend me këtë bilanc.

Sot minatorët e Bulqizës, me kominoshe të dala boje, kasketa të gërvishtura nëpër cepat e shkëmbinjve, të lagur nga shiu, zgjodhën të zbresin në mejdan, përpara Kryeministrisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe zyrave të Kompanisë Albchrome. Ky i fundit i preu në besë!

Sindikata e re e minatorëve të Bulqizës, zgjodhi të ftonte shumicën e minatorëve që t'i bashkoheshin asaj. Kompania Albchrome do të detyrohej të lidhte "kontratën kolektive të punës" me të dhe jo me sindikatën aktuale (shhhht! Se mos e zgjojmë nga gjumi letargjik sindikatën ekzistuese). Por në këtë pikë, Albchorme shkarkon kreun e sindikatës së re dhe 3 anëtarë të këshillit sindikal.

Në mënyrë të pabesë, atje midis maleve, merren veçmas minatorët dhe vendosen përpara presionit për largim nga puna nëse i bashkohen sindikatës së re, nën emrin Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës.

Kam dëgjuar mjaft "internime". Kryefamiljarë që u degdisën në skajet e fronteve të punës së kompanisë Albchrome, si në Klos, për të shtypur zërat që kërkonin rritje të pagës, rishikim të normës apo njohjen e vështirësisë dhe vjetërsisë në punë.

Inspektorati Shtetëror i Punës duhet të hetojë me seriozitet çdo largim nga puna të minatorëve që kanë aderuar në sindikatën e re, kompania Albchrome duhet të hap derën e hekurt të minierës, që sindikata e re të zhvilloj takime me anëtarësinë dhe të reflektojë, duke u ulur në tavolinë për të negociuar kërkesat e SMBB.

Miniera e Bulqizës u zbulua rastësisht nga italianët, u shfrytëzu nga shteti socialist, u mor me koncension në vitet e demokracisë dhe do vijojë të mbetet pasuri kombëtare, nga e cila çdo vit gjeneron miliona euro fitim. Njerëzit janë të vdekshëm, pasuria kombëtare jo, ajo duhet trashëguar tek brezat që do rrojnë në këtë vend!

reportazh



Në foto: Familja e Ferhat Kurtit, i cili ka nisur të jetojë në Bulqizë që kur ka filluar punë në minierë, tre dekada më parë. Foto: © Atdhe Mulla / K2.0.

- GURI QË SJELLË VDEKJE, LËNDIME, LARGIME NGA PUNA E QË S'PASURON MINATORËT.
- RRETH KËSAJ QYTEZE, MEDIAT SHQIPTARE RAPORTOJNË PËR "MAFIAN", NDIKIMIN E POLITIKANËVE, VRASJET MES BIZNESMENËVE, KORRUPSIONIN, SHKELJEN E TË DREJTAVE TË MINATORËVE SI DHE VDEKJET E LËNDIMET E TYRE.

Tërmetet e minatorëve të Bulqizës

Nga **NGADHNJIM AVDYLI / K2.0**

Vështirë se Bulqiza do t'i binte ndokujt në vesh po të mos ishte për "gurin e zi me xixa". Vendasit e qytezës veri-lindore të Shqipërisë kështu i referohen kromit, që gjendet me bollëk aty, në minierën më të madhe të këtij minerali në vend. E gjithë jeta e tyre është e lidhur me minierën, ashtu siç u ndërtua edhe qyteza rreth saj.

"Vështirë se mund ta gjesh dikë në Bulqizë që s'ka dikë të afërm a që s'ka punuar vetë nga miniera", thotë një bulqizak.

Prodhimi i kromit në Bulqizë nisi gjatë pushtimit fashist italian, diku kah viti 1942, duke shfrytëzuar mineralin mbi sipërfaqe të tokës. Pas disa vitesh, në fillim të 1948-ës nisi punën miniera nën qeverinë komuniste shqiptare, e në dekadat pasuese kërkimet për krom u avancuan në "kërkime vertikale".

Aty u punësuan qindra minatorë — banesat e para në qytezë, dy e tri katëshe, u ndërtuan për ta në vitet '60 – '70. Përveç minatorëve, në Bulqizë bënin punë të detyruar edhe të burgosurit e asaj kohe, siç ishte praktikë përgjatë regjimit komunist.

Përgjatë dekadave, Shqipëria ka eksportuar miliona tonë të gurit të zi me xixa. I përdorur gjerësisht në industritë globale, sidomos në atë të çelikut, kromi është një ndër burimet më të rëndësishme minerale të vendit.

Sot minierat janë ende pjellore — nga thellësitë e tyre nxirren në sipërfaqe mijëra tonë krom. Por, për dallim nga koha e regjimit të Enver Hoxhës, tani shumica e minierave në Shqipëri menaxhohen nga kompanitë



Banesat e para në Bulqizë janë ndërtuar për minatorët në vitet '60 dhe '70. Foto: © Atdhe Mulla / K2.0.

private, pasi shteti shqiptar vendosi t'i jepte ato me koncesion.

Sipërfaqen më të madhe të galerive e ka nën shfrytëzim kompania "AlbChrome", për të cilën punojnë mbi 600 minatorë.

Kjo kompani, bashkë me dhjetëra të tjera, bëjnë pjesë në "Balfin Group", një ndër konglomeratet më të mëdha të investimeve private në Evropën Juglindore. Përveç industrisë minerare, ky konglomerat ka biznese në disa fusha të tjera, si pasuri të patundshme e menaxhim të hapësirës tregtare e industriale. "Balfin Group" është në pronësi të personit më të pasur në Shqipëri, Samir Mane, i cili shquhet si figurë kontraverse dhe akuzohet nga aktivistë të shoqërisë civile se i shkelë të drejtat e nëpunësve minatorë.

Pavarësisht pasurisë nëntokësore, Bulqiza vazhdon të jetë një ndër rajonet më të varfëra të Shqipërisë; sipas Zyrës së Punës në Bashkinë e Bulqizës, më 2016, 28% të banorëve ishin të papunë.

Gratë janë më të prekurat nga papunësia. "Dikush edhe mund të na paragjykojë se gratë s'punojnë, por s'kanë se ku", është përgjigja e një vendasi në pyetjen se kush i punon nga familjarët.

Përtej shifrave, Bulqiza edhe në shikim të parë ta jep përshtypjen e një vendi të varfër. Shumica e ndërtesave janë të vjetra, rrugët të ngushta e të paasfaltuara. Rreth sheshit, shumë lokale janë të mbyllura e në xhama kanë të ngjitura lajmërimet "Lëshohet me qera".

Qyteza gjallërohet gjatë mëngjesit të hershëm, para se minatorët ta nisin turnin e parë të punës, dhe pak para mesnatës, kur shumë prej tyre e përfundojnë turnin e tretë. Për më pak se një orë gjatë këtyre kohëve të ditës, kafiteritë "Duriçi" e "Cupi" vlojnë nga minatorët, e pastaj zbrazen sërish deri në turnin tjetër.

Rreth kësaj qyteze, mediat shqiptare raportojnë për "mafian", ndikimin e politikanëve, vrasjet mes biznesmenëve, korrupsionin, shkeljen e të drejtave të minatorëve si dhe vdekjet e lëndimet e tyre.

Ende pa u futur në Bulqizë, ekipi i K2.0 hasi në një autoambulancë që po zbriste nga kodra e minierës. Nisur nga lajmet e shpeshta të dëgjuara për aksidentet e minatorëve, ekipi vendosi të ndiqte ambulancën. Në të po transportohej minatori Tushë Asllani, që e kishte lënduar syrin gjatë punës në minierë. Ai mori trajtim mjekësor në spitalin e qytezës, për t'u dërguar më pas në Tiranë.

Sipas një hulumtimi të vitit 2015 nga BIRN, aksidentet nëpër minierat e Shqipërisë kanë shkaktuar vdekjet e rreth 300 minatorëve në dekadën e mëparshme. Në Bulqizë, 22 minatorë kanë gjetur vdekjen nëpër parcelat e minierës në vitet e fundit, shtatë prej tyre të punësuar te kompania AlbChrome.

Në shumicën e aksidenteve që u kushtojnë me jetë minatorëve, institucionet shtetërore i lënë fajtorë vetë viktimat. Madje mediat në Shqipëri raportojnë se kompanitë që punësojnë minatorët, për disa nga të cilat është zbuluar se kanë lidhje politike, në shumë raste nuk ndiqen penalisht nga autoritetet e drejtësisë.

Në nëntor 2019, qindra minatorë në Bulqizë u bashkuan për të kërkuar kushte më të mira pune duke formuar një union të ri, Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës (SMBB). Ata kujtojnë se disa ditë pas themelimit të SMBB-së, kompania "Albchrome" filloi të shkarkonte nga puna disa prej sindikalistëve dhe të ushtronte presion ndaj minatorëve për shkak të angazhimit të tyre në aktivizëm.

Qëkur "Albchrome" filloi t'i ndërmarrë këto veprime, minatorët dhe shoqëria civile në Shqipëri po organizojnë protesta kundër pronarit të kësaj kompanie, Samir Mane, duke e akuzuar se po mundohet ta mbysë organizimin e tyre sindikalist me shkarkimet



Bulqiza, miniera më e madhe e kromit në Shqipëri, është gjymtuar nga varfëria. Foto: © Atdhe Mulla / K2.0.

reportazh



Media shqiptare ka raportuar se shumë gra kanë humbur jetën ndërsa punojnë në minierat e vendit, zakonisht duke mbledhë krom nga vendgrumbullimet e mbetjeve të kromit në sipërfaqe. Foto: Atdhe Mulla / K2.0.

e padrejta të anëtarëve të sindikatës. Aktivistët e kanë organizuar edhe një fushatë me sllloganin "Bojkoto Samir Manen", duke u bërë thirrje qytetarëve t'i bojkotojnë bizneset e tij të kudondodhura në vend.

Ndërsa sindikalistët e Bulqizës tregojnë për grevën që e filluan një ditë para se të ndodhte tërmeti i 26 nëntorit në Shqipëri, dhe kujtojnë se e ndalën atë për disa ditë në solidarizim me dhjetëra viktimat që e humbën jetën në këtë fatkeqësi natyrore. Madje, ata thonë se disa nga kolegët e tyre minatorë — të cilët nuk ishin pjesë e grevës — punuan edhe në orët pasi ndodhi tërmeti. Kjo e nxiti edhe më shumë revoltën e sindikalistëve, të cilët edhe sot po vazhdojnë të kërkojnë kushte më të mira pune.

Shumë nga familjarët e minatorëve të vdekur refuzojnë të flasin haptaz — ulen e tregojnë aksidentet e momentet e fundit të familjarëve të tyre, fajësojnë kompanitë private e autoritetet shtetërore, por nuk lejojnë t'u publikohet emri. Disa punojnë vetë në minierë dhe kanë frikë se mund ta humbin punën. E disa të tjerë frikësohen se mund ta humbin dëmshpërblimin financiar që u takon, ashtu siç humbën familjarët.

Nga shumë histori të dëgjuara gjatë qëndrimit në Bulqizë, ekipi i K2.0 sjellë rrëfimet e katër minatorëve dhe familjeve të tyre.

PA GISHT E PA DËMSHPËRBLIM

Tash e shumë vite, Lahim Boja e nisë ditën para orës 5. Shpejt e shpejt e ha kafjallin dhe del nga shtëpia. Pas pak minutave ecje nëpër rrugën e pjerrët e të paasfaltuar, 53-vjeçari ndalet dhe e pret autobusin që e çon nga Fushë Bulqiza në qendër të Bulqizës.

Aty arrin pak minuta pas orës 6 dhe shkon drejt e te kafeteria "Cupi", ku e pi kafen e mëngjesit së bashku me kolegët e tij minatorë. Në më pak se gjysmë ore, gati i gjithë lokali zbrazet, kur Lahimi e kolegët e tij nisen të shkojnë në punë.



Mëngjesin e 6 tetorit 2016, në një aksident gjatë punës në minierë, Lahim Boja e humbi gishtin. Foto: © Atdhe Mulla / K2.0.

Një nga një, ata i ngjiten kodrës për te hyrja e minierës — ajo pamje është pagëzuar nga bulqizakët si "rreshti i milingonave". Nga ora 6 e 45, minatorët fillojnë të futen në zonën e minierës që menaxhohet nga kompania AlbChrome, dhe vazhdojnë punën deri kah ora 3 e pasdites.

Pak a shumë kështu kish' nisur për Lahimin edhe dita e 10 tetorit 2016. Ama ajo ditë s'do të ishte aspak e zakonshme për minatorin, i cili punon në minierën e kromit në Bulqizë për më shumë se 35 vjet. Puna e tij është të sigurojë ashensorët përmes të cilëve qindra minatorë futen në thellësi të minierës.

Atë ditë rreth orës 7 e 30, Lahimi me tre kolegët e tij do të lëshoheshin në nivelin e 14-të të minierës përmes ashensorit. Me çelësat, çekanin e daltën, mjetet e saldimit, maskën e kasketën, dhe i lidhur me konop, ai po kontrollonte nga sipër ashensorin brenda të cilit ishin tre kolegët e tij.

Teksa po kontrollonte njërën prej kolonave të ashensorit, ajo u shkëput dhe ia zuri gishtin e madh të dorës. "Gishti ra poshtë, ashtu i lidhur e tu u mbajtë me një dorë u lëshova brenda ashensorit", kujton Lahimi.

Kur minatorët tjerë e panë gjakun, shpejt e shpejt ia lidhën dorën me një bluzë të grisur dhe e ngjitën në sipërfaqe, e ambulanca e minierës e dërgoi në spitalin e Bulqizës. Mjekët nuk mund të bënin diçka për gishtin e tij, pos t'ia lehtësonin dhimbjet. Për 10 ditë Lahimi mori trajtim mjekësor në spital, e për rreth tre muaj tjerë ishte i liruar nga puna.

Në javët e para pas lëndimit, posa e mori veten paksa nga shëndeti, ai u interesua të bisedonte me kompaninë për të cilën punonte. Kishte frikë se mos do t'i ndryshohej pozita e punës e t'i ulej edhe rroga mujore prej 54 mijë lekësh (rreth 445 euro). U lehtësua kur e kuptoi se kjo s'do të ndodhte.

Kështu, sytë i ktheu kah dëmshpërblimi financiar për humbjen e gishtit në vendin e punës. ''Unë e paguaj sigurimin, ato janë lekët e mia, pse t'mos m'i japin'', ngul këmbë Lahimi.

Kompania i kish' thënë, sipas fjalëve të tij, se në galeri ekziston rreziku, edhe mund të vritesh, porse të takon dëmshpërblimi. "Pra, ma jepni! 'Do ta japim, do ta japim.' Prit, prit, prit — shkoi tre vjetshi", thotë ai plot mllef.

Sipas tij, pas aksidentit nuk është bërë raporti policor, dhe insiston se mungesa e raportit po e penalizon nga marrja e dëmshpërblimit financiar. ''Ju besova, por se kishin pas' bë", thotë Lahimi.

Minatori veteran iu kthye punës tre muaj pasi u lëndua, dhe sot vazhdon të punojë për të njëjtën kompani. Kujton se që nga kthimi në punë, kolegët minatorë kanë shtuar kujdesin ndaj tij dhe shpeshherë e kursejnë nga punët e rënda. Sipas tij, deri më tash kjo është përkujdesja e vetme që ka pranuar në punë pas humbjes së gishtit.

Megjithëse vazhdimisht po bën përpjekje — pretendon se edhe para katër-pesë muajve ishte te zyrat qendrore të AlbChromit në Tiranë — ai ende nuk e di se kur do ta marrë dëmshpërblimin financiar.

Nevojën për ato para ia shton edhe gjendja jo e lakmueshme financiare e familjes së tij. Gruaja dhe vajzat nuk kanë arritur të gjejnë punë asnjëherë. As djali nuk gjeti punë, prandaj emigroi në Greqi.

I gjendur përballë këtyre rrethanave, Lahimi nuk mund të pushojë pasditeve kur kthehet nga puna si minator. Bashkë me gruan e vajzat ai vazhdon punën në bahçe dhe kujdeset për kafshët shtëpiake. Këto punë i bën me orar të plotë ditëve kur e ka pushim nga miniera.

Bereqeti i punëve të shtëpisë është se familja nuk ka nevojë të blejë qepët, fasulet, vezët, qumështin, djathin e kosin, mishin e pulës, apo edhe disa fruta të pemëve, gjë që i kursen paksa financiarisht. "As rakinë s'e cakërruar gotat e mbushura me rakinë që e kanë prodhuar bashkë me gruan.

"Me të mira e të këqija po e përballojmë disi'', thotë ai. Këmbëngulë se s'po dorëzohet, duke iu referuar kërkesës së tij për dëmshpërblim financiar. "Pesë lekë, pesë lekë. Sa të më bien, të miat janë".

TË NDESHËSH ARUSHËN RRUGËS PËR NË PUNË

Pak metra nga qendra e Bulqizës së Vjetër, në një banesë tri-dhomëshe jeton Ferhat Kurti me gruan, nënën dhe dy fëmijët. Familja e tij nisi të banonte në Bulqizë rreth 30 vjet më parë, kur Ferhati, tash 54 vjeç, e filloi punën si minator.

Shtëpia e tij është thuajse aq larg nga qendra e qytezës sa është nga hyrja e minierës në të cilën ai punoi për 30 vjet. Gati e gjithë jeta e Ferhatit sillet rreth këtij perimetri — aty poashtu iu rritën dy djemtë e mëdhenj, të cilët tash kanë migruar. Por ky perimetër i sjell në mendje edhe shumë ndjenja të këqija.

Më shumë se 10 vjet më parë, një ditë teksa po punonte në nivelin e pestë të minierës së Bulqizës, ai e përjetoi një shtrëngim të fortë në gjoks. Ndaloi në vend për pak, por pas disa minutash e vazhoi punën, edhe pse gjoksin po e ndiente më ndryshe. Vendosi ta përfundonte turnin e punës të asaj dite, por dhimbja i vazhdoi edhe më vonë kur u kthye në shtëpi.

Pavarësisht ndjesisë së çuditshme, të nesërmen u zgjua dhe shkoi në punë si zakonisht. Si ndërdhëmbë ua përmendi disa kolegëve të tij minatorë atë ndjesi që po e përcjellte. Ata reaguan menjëherë, e pasi i folën gjatë e me këmbëngulësi, e bindën të shkonte te mjeku pasi ta kryente punën.

"Pfu, pfu, pfu", e kujton ai psherëtimën e mjekut teksa po e kontrollonte.

Ferhati kishte përjetuar sulm në zemër. Mjeku e urdhëroi të shtrihej menjëherë në spital, dhe për një javë e mbajtën aty, ama si me zor. "Nuk ndieja aq dhimbje, më shumë më vinte inat, shumë inat", thotë Ferhati, dhe tregon se ndihej i padobishëm.

Ai besonte se ishte mjaftueshëm i fuqishëm sa ta vazhdonte punën. Për më tepër, e dinte se familja e tij kishte nevojë që ai të punonte, pasi paratë e rrogës së tij ishin të vetmet që u vinin në shtëpi.

Pas një jave, me këto mendime të përziera në kokë, vendosi të ikte nga spitali. Menjëherë rifilloi punën, pa e bërë të madhe punën e infarktit. Për dy javë e vazhdoi hapjen e puseve në minierë, derisa një ditë gjatë punës i ndodhi sulmi i dytë. Kësaj here e la pa ndjenja.

"Më kujtohet vetëm kur jam zgju' n'spital", kujton minatori.

Kësaj here nuk kishte çare pa pushuar më gjatë. Pushimi iu zvarrit edhe më shumë nga infarkti i tretë që e kapi pa kaluar dy muaj nga i dyti. "Na s'jemi edhe aq me shkollë, po besoj se pluhuri [i minierës] e bëri këtë", thotë Ferhati për sulmet në zemër që përjetoi.

Ndryshe nga infarktet, puna që ka bërë me dekada në minierë ka lënë gjurmë të dukshme në trupin e tij. Po t'ia shikosh duart nga afër, majat e gishtave i ka të çara e të ngrëna vende-vende nga të gërmuarit.

Ai vazhdon të besojë se ende është i fortë fizikisht për ta kryer punën e minatorit. Si për ta arsyetuar këmbënguljen e tij, i përmend aksidentet e shpeshta të cilave u ka mbijetuar në minierën e Bulqizës, si vdekjet e kolegëve të tij nga rrëzimi i shkëmbinjve a shpërthimet e gazit, e gjurmët fizike të plagëve që ka në trup nga puna në minierë.

Edhe pas tri sulmeve në zemër, ai e vazhdoi punën në minierë për rreth një dekadë — jo më si minator, por si punëtor i ajrimit, duke ua siguruar minatorëve oksigjenin gjatë punës në birucat e minierës.

Bile nuk u kujdes vetëm ta ruante vendin e punës, por mori pjesë edhe në greva e protesta. Një nga më të mëdhatë prej tyre ishte greva e 2011-ës, ku minatorët në mes tjerash kërkuan rritje të pagave dhe të investimeve në minierë. Por thotë se nuk ua pa hajrin atyre.

Në vitin 2013, kompania AlbChrome u bë pronare me koncesion e galerisë ku punonte ai. Pas disa kohësh, atij i nisën prapë telashet, kësaj here jo nga shëndeti por nga protestat, dhe atë në Ditën e Punëtorëve. "T'jesh në Bulqizë e t'mos dalësh [në protestë] për 1 Maj?", pyet Ferhati, duke e kujtuar atë ditë të vitit 2017 kur minatorët u çuan në një protestë simbolike para minierës.

Atë ditë, inatin më të madh e kishte me udhëheqësit e sindikatës së minatorëve, që sipas tij s'i kishin bërë kompanisë presion të mjaftueshëm për rritje të pagave dhe rregullim të kushteve të punës. "Reagoj pak më tepër. I them [kryetarit të sindikatës] se jeni vrasës ekonomik e psikologjik i minatorëve", kujton Ferhati.

Ai tregon se pas disa ditësh ishte ftuar në zyrë të kompanisë për ta sqaruar reagimin e tij, dhe më pas ishte lajmëruar se e kishin suspenduar nga puna për tre muaj. Gjatë asaj kohe e merrte pagën mujore, dhe ishte në pritje të një vendimi tjetër.

Zyrtarët e kompanisë vendosën ta transferonin në Burrel, rreth 7 kilometra larg, për të punuar në fabrikën e përpunimit të kromit. I thanë se këtë po e bënin për shkak që kishte probleme me zemër. "Probleme me zemër keni ju", kujton t'ua ketë kthyer Ferhati.

Ai beson se vendimi erdhi vetëm për shkak se ishte pjesë e protestës dhe jo se dikujt i bëhej vonë për shëndetin e tij. "E mora si internim, pasi kisha ngritë zërin", thotë minatori, i cili megjithatë pranoi ta vazhdonte punën në Burrel.

Ndryshe prej më herët, tash i duhej të ecte për disa kilometra, dhe atë nëpër mal. "Kam hasë arushën në mal sa shkoja në punë",

(Vijon në faqen 6)

Rruga e Arbërit nr. 164

reportazh

Tërmetet e minatorëve të Bulqizës

(Vijon nga faqja 5)

thotë në një moment Ferhati. Kujton se për atë rast i ka lajmëruar edhe eprorët e tij, por nuk i ka bërë zgjidhje askush.

Ai punoi aty deri në qershor të vitit 2019, kur sipas tij e larguan nga puna me arsyetimin se e kishte prishur etikën në punë dhe e akuzuan se i kishte sharë dhe shtyrë fizikisht eprorët gjatë një ballafaqimi kur kërkonte të kthehej në vend të punës në Bulqizë.

Tash bëhen mbi gjashtë muaj prejse është i papunë. Për ta zbutur sadopak gjendjen e rëndë ekonomike të familjes, gruaja e tij ka filluar punën ilegalisht në një galeri tjetër private, ku mblidhet krom mbi sipërfaqe të tokës.

Më herët, edhe njëri nga djemtë e tyre kishte punuar ilegalisht në minierë për më pak se një vit, derisa një lëndim në këmbë e kishte shtyrë ta linte punën. "'30 vite punove dhe çka arrite? Kur s'ke bërë ti për kaq vite, çka do arrij unë?'", kujton ai fjalët që ia kishte thënë djali i tij, i cili sot jeton në Gjermani.



Elton Debreshi dhe Beqir Duriçi, të cilët disa vite punuan për kompaninë AlbChrome, janë ndër themeluesit e sindikatës së re të minatorëve. Foto: © Atdhe Mulla / K2.0.

REVOLTA E BREZIT TË TRETË

Ende pa i mbushur 20 vjet, Elton Debreshi vendosi të largohej nga Bulqiza. Vështirësitë për të gjetur punë në vendlindje e detyruan të emigronte në Greqi, ku bëri disa lloje të punëve, kryesisht në sektorin e ndërtimtarisë. Por në atë kohë shtetin grek e kaploi kriza ekonomike që i la pa punë qindra mijëra të rinj, përfshirë edhe atë.

Në vitin 2010, Eltoni u kthye në Bulqizë dhe po mendonte se si të shkonte përsëri në Greqi. Por planet i ndryshuan kur pësoi një aksident me motocikletë, i cili e la të paaftë të punonte për disa muaj. Kur u shërua filloi të kërkonte punë në qytezë, dhe siç e dinë të gjithë bulqizakët, miniera është ndër të paktat mundësi për punësim.

Ai e njihte punën e minatorit pasi babai i tij kishte punuar në minierën e Bulqizës për më shumë se 30 vjet, e gjyshi që nga hapja e saj. Kështu, në prill të 2010-ës edhe ai nisi të punonte në minierë.

Atë vit kur Eltoni e nisi punën si minator, një tjetër të riu të kësaj qyteze, Beqir Duriçit, iu bënë tri vjet që po e ushtronte këtë profesion. Edhe ai po e vazhdonte traditën e burrave të familjes.

Vitet e para të punës Beqiri i kujton si jashtëzakonisht të vështira, thotë se ndodhnin shumë aksidente, kushtet e punës ishin të rënda dhe paga ishte shumë e ulët.

Kujton kohën kur minatorët e bojkotuan punën për disa muaj, duke i shtyrë kështu punëdhënësit t'ua rrisnin pagat. Ishte edhe pjesë e grevës së vitit 2011, dy vjet pas së cilës iu ndërrua punëdhënësi. Pjesa e minierës ku ai punonte u mor në menaxhim nga kompania AlbChrome, e cila kishte premtuar se do të investonte në minierë.

Llafet se kompania e re menaxhuese e këtyre galerive do të ofronte kushte më të mira të punës bënë që edhe Eltoni të mendonte të punësohej aty, dhe këtë e arriti në shkurt të vitit 2014. Prej atëherë e deri në fund të 2019-ës, Eltoni e Beqiri punuan për të njëjtën kompani. Që të dy thonë se premtimet e kompanisë për ta përmirësuar gjendjen e minatorëve nuk u realizuan.

"Ç'është e vërteta, kompania investoi vetëm në rritjen e thellësisë së pusit [të minierës] dhe këtë e bëri për profitin e vet", thotë Beqiri. Sipas tij, kjo vetëm e rriti vëllimin e punës, por kompania nuk ua rriti pagat e as nuk i përmirësoi kushtet e punës.

Këto vite ia kanë lënë Eltonit në mendje lëndimet e shumta të minatorëve. "Linja e helikopterit Tiranë-Bulqizë u pat bë si ajo e furgonit", thotë ai.

U shënuan edhe disa vdekje të minatorëve, e për Eltonin dallohet rasti i Eduard Damas më 2017. Ditën kur minatori 27-vjeçar kishte vdekur brenda minierës, lajmi ishte shpërndarë menjëherë nëpër Bulqizë, e bashkë me të edhe inicialet e Damas, të cilat përputheshin me ato të Eltonit.

Eltonin e kishin vërshuar thirrjet e shokëve e familjarëve, por ai nuk kishte qasje në telefon. Edhe ai kish' dëgjuar për aksidentin fatal, dhe po mundohej të merrte vesh nëse ishte mirë babai i tij minator dhe vëllai i vogël që sapo kish' nisur punën në minierë. Tek pasi e përfunduan punën Debreshët e kuptuan se të gjithë ishin shëndosh e mirë.

Eltoni e Beqiri ishin të lodhur nga kjo gjendje, dhe më shumë se me gjithëkë tjetër, mllefin e kishin me sindikatën e minatorëve. Sipas tyre, sindikata nuk po e kryente punën e vet dhe po ia mbante anën kompanisë, jo minatorëve. Prandaj kërkuan nga udhëheqësit e sindikatës që të reagonin dhe t'i kërkonin kompanisë rritje të pagave. Sindikalistët u thanë se do të bisedonin me kompaninë.

Në më pak se një javë, sindikalistët e njoftuan Beqirin se kompania nuk do t'i rriste pagat. Kjo e zemëroi jashtëzakonisht Beqirin, Eltonin dhe grupin prej 30 minatorëve që e kishin përgatitur kërkesën.

Grupi nisi të mbledhte nënshkrime për të formuar një sindikatë të re. Kjo ra në vesh të udhëheqësve të kompanisë e atyre të sindikatës, dhe në pak ditë u mor vendimi që Eltonit dhe Beqirit t'u ndryshohej pozita e punës.

"Më çuan tek niveli i 17-të, aty është puna më e vështirë", thotë Beqiri. E Eltonin, nga pozita e minatorit e kthyen në vagonist. Të dy e vazhduan punën në pozitat e reja, por nuk hoqën dorë nga formimi i një sindikate të re. I mblodhën nënshkrimet e minatorëve dhe dorëzuan në gjykatë kërkesën për regjistrim e pranim të sindikatës.

"Me një grusht djemsh të besës vazhdimisht u morëm me themelimin e sindikatës", thotë Eltoni.

Më 15 tetor 2019, Gjykata e Tiranës shpalli vendim me të cilin e njohu si legjitime sindikatën e tyre. Një muaj më vonë, në qendër të qytezës u shpall themelimi i Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës. Eltoni u zgjodh kryetar, ndërsa Beqiri financier.

Më 19 nëntor, Eltoni u thirr në zyrat e Albchromit në Bulqizë. Aty iu tha se sindikata e re nuk njihet nga kompania dhe u pyet se cilat janë qëllimet e tij. Po ashtu, iu tha që më 21 nëntor duhej të shkonte për takim në zyrat qendrore të kompanisë në Tiranë, ku ai thotë se i dëgjoi gati po të njëjtat fjalë, veçse kësaj here iu përmendën edhe disa mungesa në punë.

Sipas Eltonit, ai u akuzua se muaj më parë kishte munguar në punë për pesë ditë. Ai tregon se ato mungesa i kishte bërë sepse e kishte të sëmurë njërin prej fëmijëve, dhe thotë se kishte raport mjekësor për to dhe i kishte njoftuar eprorët me kohë se do të mungonte.

Megjithatë, me 23 nëntor ai u pushua nga puna, me arsyetimin se ka shkelur etikën e punës dhe nuk e ka respektuar orarin. Me të marrë vesh për shkarkimin e kryesindikalistit të ri, minatorët vendosën të ngriteshin në grevë, të cilën e nisën me 25 nëntor para zyrave të kompanisë në Bulqizë.

Po atë ditë, Beqirit i erdhi thirrja të paraqitej në Tiranë tek zyrat e kompanisë. Sipas tij, kompania e akuzonte se kishte disa mungesa në punë. Gjatë disa ditëve të punës, ai kishte mangu disa minuta, sipas tij për shkak të rendit të gjatë që bëhet kur minatorët janë duke hyrë në minierë.

Beqiri u kthye nga Tirana drejt e në grevë, të cilën minatorët nuk e kishin ndërmend të ndalnin, megjithëse thonin se kompania po u bënte presion të vazhdueshëm. Por e ndalën në ditët pas tërmetit që goditi Shqipërinë në fund të nëntorit, në solidarizim me viktimat.

Grevën e vazhduan më 1 dhjetor për tri ditë tjera, e më 3 dhjetor edhe Beqiri u njoftua se është përjashtuar nga puna. "Më pas nisën t'i shantazhonin minatorët se nëse nuk kthehen në punë, s'do e marrin shpërblimin e fundit të dhjetorit", thotë Beqiri. Tash, në fillim të vitit 2020, pas një proteste të radhës nga minatorët, ata u njoftuan nga kompania se do ta marrin atë shpërblim.

Ai po ashtu thotë se atë dhe Eltonin i larguan nga puna për t'u dhënë shembull minatorëve se në rast se vazhdojnë të protestojnë do të largohen edhe ata nga puna. Sipas tij, ashtu edhe ndodhi me Behar Gjinin dhe Ali Gjetën, pjesë e Këshillit Sindikal të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës — u larguan nga puna me arsyetimin se kishin mungesa gjatë orarit të punës.

''Asnjëherë nuk kisha ankesa nga eprorët se jam vonuar apo larguar nga puna më herët'', thotë Eltoni. "Pse u kujtuan për ankesat vetëm kur bëmë sindikatën e po kërkonim të drejtat tona?"



Minatorët e Bulqizës kanë protestuar për kushte më të mira pune dhe paga më të larta gjatë gjithë këtyre viteve. Foto: ©Atdhe Mulla / K2.0.

 # Kompania AlbChrome është kontaktuar për intervistë nga K2.0, por ata nuk janë përgjigjur.

* Ky artikull është prodhuar për **Kosovo 2.0**, ku edhe është publikuar fillimisht. Botimi i këtij artikulli është bërë me lejen e **Kosovo 2.0.**

Shkrimin origjinal e gjeni në lidhjen e mëposhtëme: **https://kosovotwopointzero.com/minatoret-e-bulqizes/?fbclid=IwAR2osrEi3tRs7TRSxAJdH-rUa7rI-vUctw0gdNEVOlFHGplw7A0dJ6dIXec**

investime

Dilemat e Shpendit





Nga **OSMAN XHILI**

Ashtu si shpendët që nuk ndalen në fluturimin e tyre, ashtu dhe Shpendi Qoku, djaloshi nga Kllopçishti i Maqellarës, nuk di të ndalet në rrugëtimin e tij drejt suksesit. Pasi mbaroi shkollën e mesme, si të gjithë të rinjtë e tjerë, ai qe larguar drejt Italisë, në kërkim të një jete më të mirë. Punoi plot 15 vjet, kryesisht në zonën e Bolzanos, aq të njohur për kultivimin e mollës. Puna e mjeshtrave italianë e mrekulloi dhe mendoi se dhe ai kur të kthehej në Shqipëri, do të bënte diçka të ngjashme me eksperiencën e tyre.

Shpendi ka dhe një lokal të tij, në qendër të Maqellarës, por tundimit për të provuar magjinë e kulturave bujqësore, nuk i rezistoi më. Nuk u mor me mollën. Shërbimet e shumta, krasitjet, spërkatjet e shumta, rezistenca e dobët e frutit, ishin faktorë që duheshin marrë në konsideratë. Por jo vetëm lodhja, se ai nuk i trembej punës, por më shumë i trembej mungesës së tregut. Shihte dhe fermerë të tjerë në Maqellarë, që përpiqeshin të shisnin mollët e tyre gjithë vjeshtës e dimrit dhe prapë nuk arrinin rezultat.

Kësisoj, ai mendoi të investojë tek arrorët. Kishin si familje rreth një hektarë tokë, që e jepnin me qira. Vendosi të mbjellë, gështenja, arra dhe lajthi. Gështenjën e mori vetë në Greqi, në zonën e Verias. E zgjodhi varitetin Maronia, duke sjellë 280 fidanë. Distancat ishin gjashtë me gjashtë, kurse në gropa kishte futur pleh të kalbur mirë. Përveç tyre shtoi dhe 50 rrënjë arra dhe 100 rrënjë lajthi.

Arrat ishin të shartuara dhe me origjinë nga Turqia. Parcelën e ka të rrethuar dhe me vaditje me pika. Kanë kaluar vetëm tre vjet dhe rezultatet duken premtuese. Ai po shijon prodhimet e para dhe ato duken shumë cilësore. Në pak vite të tjerë Shpendi shpreson që të marrë një prodhim të atillë që të mbajë një familje, pa u marrë me punë tjetër.

Një vit më vonë, Shpendi nisi një aventurë të re. Një mik i tij, në Korçë i sugjeroi një tjetër biznes, prodhimin e çajit. Ai i tha se çajin e prodhuar do ta shiste me 7-8 euro kilogramin, se tregu për këtë është tepër i sigurt. I tha se po ta mbjellësh vitin e parë, ai prodhon për shtatë tetë vjet, pa pasur ndonjë kosto shtesë të dukshme.

E gjithë kjo panoramë argumentesh ishte mjaft bindëse dhe goxha e lakmuar për ta bërë realitet. Mori shtatë dynymë tokë me qira dhe e bëri gati me punime, në mënyrën më të mirë të mundshme. Shkoi në Korçë dy vite më parë dhe mori farën e çajit. Sipas llogaritjeve i duheshin 700 gram farë çaji, që kushtonin jo pak, por 700 mijë lekë.

I përgatiti farishtet me kujdes, në mes të muajit mars dhe dy muaj më vonë çdo gjë ishte gati. Fidanët i mbolli me shkop në fushë të hapur, në distanca 70 cm mes rreshtash dhe 40 – 50 cm bima nga bima.

Ashtu si shpendët që nuk ndalen në fluturimin e tyre, ashtu dhe Shpendi Qoku, djaloshi nga Kllopçishti i Maqellarës, nuk di të ndalet në rrugëtimin e tij drejt suksesit. Pasi mbaroi shkollën e mesme, si të gjithë të rinjtë e tjerë, ai qe larguar drejt Italisë, në kërkim të një jete më të mirë. Punoi plot 15 vjet, kryesisht në zonën e Bolzanos, aq të njohur për kultivimin e mollës.

Investimi në gështenja, arra dhe lajthi duket se do të ketë perspektivë. Gështenjën e mori vetë në Greqi, në zonën e Verias. E zgjodhi varitetin Maronia, duke sjellë 280 fidanë. Distancat ishin gjashtë me gjashtë, kurse në gropa kishte futur pleh të kalbur mirë. Përveç tyre shtoi dhe 50 rrënjë arra dhe 100 rrënjë lajthi. Arrat ishin të shartuara dhe me origjinë nga Turqia. Parcelën e ka të rrethuar dhe me vaditje me pika. Kanë kaluar vetëm tre vjet dhe rezultatet duken premtuese. Ai po shijon prodhimet e para dhe ato duken shumë cilësore. Në pak vite të tjerë Shpendi shpreson që të marrë një prodhim të atillë që të mbajë një familje, pa u marrë me punë tjetër. Investimi në çaj rezultoi i suksesshëm vitin e parë, por më pas çmimi nga 7- 8 euro për 1 kg shkoi në 200 lekë. 15 kuintalë çaj të këtij viti po presin në magazinë

Vitin e parë nuk dha prodhim, por vetëm rritje të bimës. Ishte një rritje e bujshme e kërcejve, që mund të shkonin mbi 50 të tillë për çdo rrënjë. Në vitin tjetër, prodhimi qe shumë i mbarë. Ai e korri, e thau në hije dhe e ambalazhoi me kujdes. Lagështira dhe dielli ishin jo të pëlqyeshëm për një tharje cilësore. Rezultati qe vërtet shumë i kënaqshëm. Masa e korrur dhe tharë në hije, rezultonte të qe jo pak, por 12 kuintal.

Po nëse një vit më parë çmimi kishte qenë 7- 8 euro, këtë vit ajo ka rënë ndjeshëm dhe po bie akoma më shumë, deri në kufirin e 2 mijë lekëve të vjetra. Kështu i ndodh gjithnjë fermerit shqiptar. U trumbetua sherebela si mbjellja e shekullit dhe shumë shpejt çmimi ra në mënyrë drastike, aq sa nuk pyeste më njeri për të.

U mbollën mollët me shumicë dhe ata vitin e kaluar u kalbën dhe nuk u interesua kush për to. Ndoshta dhe arrorët, që duken pak më tërheqëse për momentin, mund të kenë të njëjtin fat pas dy tre vitesh. Si nuk u interesua shteti për fermerët e shkretë, ti drejtojë drejt suksesit, ti udhëzojë në kaosin e tregut, ti ndihmojë me subvencione, në mos më shumë, të paktën sa fqinjët tanë, Kosova dhe Maqedonia.

Këtë vit Shpendi mendon se do marrë 15 kuintalë nga parcela e mbjellë me çaj, por çe do. Nëse nuk shitet ai mund të shërbejë vetëm si shtresë për bagëtinë. Në lokalin e tij serviret ky lloj çaji që ai prodhon vetë. Vërtetë shijon shumë dhe siç thuhet lufton diabetin, shërben për dobësim dhe shton forcën imunitare të organizmit. Por kjo mënyrë konsumimi është shumë e paktë dhe e papërfillshme. Nëse gjërat nuk ndryshojnë për mirë, Shpendi do ta shkulë çajin e mbjellë me aq mund e shpenzime, ose do t'ja dorëzojë pronarit të tokës, pasi nuk ka asnjë lloj interesi. As më pak e as më shumë, sikur shkuli parcelën me mollë Sakip Dançja në Allejbegi, Hamit Abazi në Hobok dhe fermerë të tjerë në Korçë.

Shpendi mendon të bëjë lëvizjen e radhës dhe po kështu mendojnë gjithë fermerët e Dibrës. Të dalë nga vallja apo ta vazhdojë atë?

Rruga e Arbërit nr. 164

Në Vranjt shkolla 9 vjeçare ka plot histori drite, veprimtarish plot prova diturie, emra që nderojnë Vranjtin, zonë e Kastriotit Dibrën e më gjerë.

reportazh

Në Vranjt, *aty ku rrezaton drita e diturisë*

Nga **MEVLUD BUCI**

Sapo të kalosh Kubenin e të kthehesh djathtas në sfond, të shfaqet Vranjti i Kastriotit. Fshat me plot bukuri natyrore, peizazhe të blerta mbi cilën qëndron kurora e maleve. Deshati dhe zona minerale e gipsit u japin Vranjtit e Limjanit një bukuri të rrallë. Kalaja e Volës është dëshmia e lashtësisë, qëndresës shekullore e brezave në kohërat e Bizantit, të Skënderbeut e deri në kohët e vona. Gjurmët e luftërave dhe të diturisë, traditat e besimit e të vëllazërisë tregojnë sesi malet e këtyre anëve kanë qëndruar, luftuar e jetuar duke i dhënë bukuri vendlindjes së tyre.

Vranjti dhe Limjani si krahët e një lisi të moçëm zbukurojnë trevën e Kastriotit e më gjerë. Edhe këtu ka jetë, punë, përkushtim, ka dritë e rrezatim diturie. S'ka si rrezatimi i diturisë, si drita e shpirtit dhe blerimi i djersës për vendlindjen, për kombin, për brezat...



GJURMË JETE E PUNE...

Cilido që shkon në Vranjt mëson shumë për gjurmët e jetës e të punës, për gjurmët e besimit. Njerëz të thjeshtë e bujar, të dashur e mikpritës, dashamirë për vlerat njerëzore, për dritën e diturisë. Me djersë e zell kanë zbukuruar vendin. Në arat e kodrinat, në rrethinat e shtëpive ka peizazhe që dëshmojnë se në Vranjt punohet dhe luftohet për jetën, diturinë. Shkolla 9-vjeçare e vendosur më hyrje të Vranjtit ka nxënës nga Vranjti edhe Limjani.

Sido që emigracioni ka bërë të tij ku janë larguar nga treva, ende këto, dy fshatra kanë galerinë e jetës, fisnikërinë e traditave shpirtin e punës duke ngulmuar për të zbukuruar vendlindjen. Mësojmë se, ndonëse kanë lëvizur në vitet e tranzicionit në Vranjt ka mbi 80 shtëpi, kurse në Limjan mbi 70 shtëpi, lagjja e Volezë ka rreth 20 shtëpi. Në këto anë cilido vete nuk befasohet me dritën e mirësisë e të bujarisë, me urtësinë dhe dlirësinë e fjalës që buron nga sinqeriteti i këtyre njerëzve të thjeshtë e shpirtbardhë. Puna zbukuron jetën, puna hijeshon fjalën dhe është dëshmia më e plotë e edukimit të brezave. Jeta dhe puna, tradita dhe dituria, bujaria dhe vlerat e fjalës, krenaria dhe thjeshtësia njerëzore janë moto e malësorëve të Vranjtit dhe Limjanit. Për bijtë e Vranjtit e të Limjanit jo një reportazh, por disa të tillë e pse jo edhe poema e tregime, novela e më gjerë nuk do të mjaftonin. Janë krenari e brezave Sheh Ismaili i Limjanit, Sheh Mehmeti, Sheh Emurllahi e djali Sefulla, teologu Xhezair Fishti e plotë të tjerë. Çdo plis dheu, çdo shteg a brezare në Vranjt e Limjan ka plot histori e gjurmë jete, gjurmë pune e besimi. Besimi për bijtë e këtyre anëve është shtylla kryesore e jetës, është promotori që u jep shtytje punëve, vëllazërimit, unitetit e harmonisë. E ku ka më të shenjtë në jetë se sa harmonia, humanizmi e vëllazërimi?! Jeta dhe puna këtu dritësojnë, shtojnë besimin, vëllazërinë.

SHKOLLA E VRANJTIT

S'ka si rrezatimi i diturisë, si dija, si mençuria e urtësia për njeriun. Populli thurte urtësinë shekullore. S'ke dëm kurrë prej atij që din e prej atij që ka... Dituria çon përpara punët, harmoninë, ajo dëshmon për vlerat, për peshën e njeriut në jetë e në shoqëri. Ideologu i Rilindjes Kombëtare, Sami Frashëri, thoshte: "Për të vlerësuar një fshat, shikoi shkollën, mullirin, rrugët".

Në Vranjt shkolla 9 vjeçare ka plot histori drite, veprimtarish plot prova diturie, emra që nderojnë Vranjtin, zonë e Kastriotit Dibrën e më gjerë. Përkushtimi, takti dhe zelli reformues janë tre veçori, është trinomi i punës për mësim dhe edukim në Vranjt. Mësues të pasionuar, të lidhur ngushtë me profesionistin me përvojat bashkëkohore. Kjo bie në sy qysh në hyrje të shkollës, tek lëndët model, tek veprimtaritë e deri tek ajo më themelorja orët e mësimit, tek puna me nxënësit e vështirë e ato me prirje. Në këtë shkollë ku mësojnë fëmijët e Vranjtit e të Limjanit janë 149 nxënës e tre kopshte. Është sa e arsyeshme edhe mision e detyrim njerëzor që në këtë reportazh të thjeshtë të gdhenden emrat e të përkushtuarve edukatoreve Nurie Shehi, Alltane Muça. Në pedagogjinë suedeze mësuesit e ciklit fillor konsiderohen heronj. Me të vërtetë këto përballojnë sakrificat e sfidat më të mëdha, më humane, më të lodhshme, për të futur në udhët e diturisë fëmijët që mësojnë. Janë në ditarin e diturisë mësuesit e ciklit fillor si Fatmira Elezi, Rrezarta Shahini, Rufat Cara, Zeqir Elezi, Shejdi Shehi. Këta janë dëshmia e qartë se si rritet autoriteti nëpërmjet mësimit, taktit e përkushtimit. Shkolla e Vranjtit ka arritur rezultate si rrjedhojë e shpirtit reformues të kuadrove dhe e mjeshtrisë e zotësisë së drejtimit. Në arsimin e mëson të ulët (ciklin e lartë) shërbejnë me devotshmëri Gëzim Fishti, Veli Xhediku, Mandarine Kaca, Ermira Zollumi, Mirian Tafa, Elton Iskurti, Naxhi Zuna. Tek secili, çdokush mëson për përvojat, dritësimin e veprimtarive, për shembullin në mësimdhënie e veprimtari.

Naxhie Zuna punon me zell në mësimin e edukimin e nxënësit tetraplegjik, Jurgen Riçku.

BIBLIOTEKA

Veli Xhediku ka bërë model bibliotekën, ka pasqyruar përvojën e korifenjve kombëtarë si edhe veprat e veprimtaritë e shkrimtarëve, poetëve e studiuesve dibranë. Puna e mësues Veliut dëshmon si duhet të jetë mësuesi reformues bashkëkohor. Ai ka bërë një punë lavdëruese, pasiononte dhe humane që u shërben nxënësve, lartësimit të vlerave njerëzore, intelektuale. Në stendat e fotografitë na shfaqet epopeja e shkrimtarëve si Haki Stërmilli, Hazis Ndreu, Xhafer Martini, Agron Tufa, Naim Plaku e plot të tjerë. Mësues Veli Xhediku i ngjan një blete që e mbledh nektarin lule më lule. Shembulli e puna e tij në mësim, veprimtari e mbi të gjitha me bibliotekën është një model për kohën, për ecurinë cilësore në mësimdhënie, në edukimin e brezave, në nderimin e pasqyrimin e vlerave të komunitetit.

Në Vranjt, mësojmë se si punon intelektuali e drejtori i talentuar Indrit Fetah Shehi. Ai ka mbi 5 vite që e drejton këtë kolektiv modest e të lidhur ngushtë me shkollën, me prindërit, me veprimtaritë. Drejtor Indriti, pa mëdyshje, të bind se është një krijues, mjeshtër i drejtimit, durues, veprues e mbi të gjitha kuadër i etur për dije, për ndryshim, për pasqyrimin e vlerave. Ai është sa korrekt e veprues, aq edhe kërkues e dashamir. Pra, çelsi i suksesit është komunikimi, lidhja e sinqertë me kolektivin, nxënësit e komunitetin. Shembulli i tij rrezaton, si është drejtori e kuadri është edhe shkolla. Tek Indrit Shehi mëson vetitë e drejtuesit e të punëtorit të palodhur të dijes, mëson thjeshtësinë, përkushtimin, zellin e studimit, respektin për kolegët, nxënësit, prindërit e mbi të gjitha shpirtin e punës e reformës, dëshirën për profesionin. Arti i drejtimit, puna këmbëngulëse për të udhëhequr me shembullin personal, pasqyrim i përvojave janë moto e drejtor Indritit. Ai flet me taktin e veprimin, me durimin e rolin organizativ, me nderimin për kolegët, me rreptësinë pedagogjike aty ku e di puna. Nga drejtor Indriti mësojmë për provat e humanizmin e Musa Riçkut, i cili i ka dhuruar bibliotekës librat e botuar të autorëve dibranë, mësojmë Wordl Vizion, për Majlinda Hoxhën, të cilët kanë dhuruar e nderuar shkollën 9-vjeçare të Vranjtit. Sot kanë ardhur edhe Sadedin Jashari, drejtues i shoqatës "Ardhmëria", Albert Kojku e Bedri Reçi, të cilët dhuruan 5 kompjutera.

Takti dhe puna e drejtor Indritit dhe e secilit mësues në Vranjt i ngjan një magneti që tërheq veprimi, këmbëngulja, shembëllimi në



punën me nxënësit ekselencë e ato me dobësi, puna me këndet e mjedisin flet, dëshmon për provat në frontin e diturisë. Nga drejtor Indriti mësojnë emrat e shumë nxënësve të dalluar, midis të cilëve që do t'i rrezatojnë kohës në të ardhmen në shkallët e dijes janë Blerta Kera (kl. IX) Gëzime Shehi (kl. VIII), Arbër Gjapi (kl. VII), kurse në ciklin fillor dallohen Rabie Riçku (kl. II), Klevisa Fishti (kl. II), s'duhen harruar edhe Esmeralda Muça (kl. VIII) e Kristina Riçku (kl. IX). Një kolektiv me dashuri e respekt për punën, për nxënësit, për traditat, një provë që flet. Të lënë mbresa këndet model si "Mësuesit e fshatit", "Këndi i historisë", "Turizmi në Dibër", "Teologët e fshatit" (Limjan e Vranjt), këndi i letërsisë, krijuesve të vegjël, i piktorëve (letrari i ri, piktori i vogël) e të tjerë janë vërtet dëshmi e punës reformuese të përkushtuar. Dashuria për mësuesinë, mësimin e veprimtaritë, lidhja me prindërit, përvojat bashkëkohore të zbatuara me shpirt krijues janë provat e qarta që tregojnë se përse dallohet shkolla 9-vjeçare e Vranjtit në Dibër. Simbol i dijes e i krenarisë, shëmbëllim i dinjitetit pedagogjik, rrezatim diturie, këto mëson në Vranjt të Kastriotit.

AVDI SHEHI DHE DRITA E BREZAVE

Kur isha në Vranjt në fundvitin e sapombyllur me ftesë të drejtorit e kolektivit të nderuar; pas gati tri dekadash takova, të nderuarin, mësuesin e drejtorin veteran, Avdi Shehi. Ai na priti në hyrje të shkollës. U përqafuam e përfalem me përmallim. Ndonëse, pensionist pak më i ri nga unë Avdi Shehi, si lis kurore për nga mirësia e zelli arsimor na shoqëron në bibliotekën model e tek këndet, klasat kabinete. Plot 43 vjet shërbeu në arsim nga këto 14 vite drejtor, punoi 16 vjet në Blliçe, 7 vite në Vranjt deri gjithçka për shkollën e Vranjtit si mësues e drejtor, la gjurmë që u flasin brezave. Avdi Shehi ka një përvojë të çmuar në arsim si mësues e drejtues, si mjeshtër i mësimdhënies dhe i drejtimit arsimor në bazë. Puna e mirë, takti drejtues, shembulli në veprimtari, dëshmojnë zotësitë, nderimin për punën, dashurinë e respektin për nxënësit, komunitetin, rrezatimin e dritës profesionale. Dituria ka prova, ka dëshmitë e arritura, ka mbi të gjitha rrezatimin në sy të kolegëve, nxënësve e të brezave. Avdi Shehi ka plot përvoja, gjurmë veprimtarish e shembullin në drejtimin e shkollës. Me dashamirësi e thjeshtësinë që e karakterizon na tha: vura nxënësit në punë krijuese. Njëri prej tyre më tha: Mësues a ka mundësi që të na krijoni edhe ju një poezi për Kosovën? Unë, - thotë Avdiu, - e falënderova nxënësin dhe e bëra poezinë. Avdi Shehi i Vranjtit është një "poet" (krijues) i mësimdhënies, i adrejtimit, kuadër i vlerave për Kastriotin, Dibrën e më gjerë. Nga ky intelektual virtuoz mësojmë edhe brezat fisnikë të drejtorëve të shkollës Vranjt. Ata dritësojnë, ata janë gdhendur në kujtesën e brezave të komunitetit arsimdashës. Koha dh ejeta do t'u jenë mirënjohës, ish-drejtorëve të shkollës në Vranjt të Kastriotit si: Ahmet Çaushi, Xhafer Merdini, Ismet Abdia, Xhetan Shehu, Tahir Çela, Ymer Xhediku, Gëzim Fishti e Indrit Fetah Shehi. Breza drejtuesish, të urtë e të palodhur.

(vijon në faqen 10)

FALEMINDERIT MUSA RIÇKU

Mendova sinqerisht t'i shkruaj pak reshta në këtë reportazh për birin human të trevës së Kastriotit (Limjanit) Musa Riçku, sepse ai ka ndihmuar, ka thërrmuar lajthinë në 12 pjesë si i thonë, duke ndihmuar vendlindjen. Provat e humanizmit të Musa Riçkut janë si vetë kurora e Deshatit. Ai nuk i ka bërë për t'u dukur, pro për to flasin bashkëfshatarët, nxënësit, mësuesit, flasin librat e dhuruara në bibliotekën e Vranjtit, botimet e autorëve dibranë. Musa Riçku së bashku me bashkëshorten e nderuar Hasien (bijën e Devës) kanë thërrmuar nga djersa e tyre për të ndihmuar e nderuar, për të shpërndarë tek brezat rrezatimin e dijeve, për të lartësuar vlerat dibrane e kombëtare. Vendlindja e mat burrin, zotësinë, shpirtin, dritën e humanizmit. Ndaj buron nga zemra e cilitdo: faleminderit Musa Riçku!

jetë

Ardhja e fisit Capa në zonën e Maqëllarës duhet të ketë ndodhur diku 150 vjet përpara.

Fiti Capa, *një histori dashurie dhe mbijetese*

Nga **OSMAN XHILI**

FISI CAPA NE MAQELLARE.

Ardhja e fisit Capa në zonën e Maqëllarës duhet të ketë ndodhur diku 150 vjet përpara. Nuk mendohet që hasmëria të ketë qenë shkaku i kësaj zhvendosje. Më shumë se sa kjo, shkaku duhet kërkuar tek toka e begatë e kësaj treve, sasia e madhe në sipërfaqe dhe të qënurit afër Dibrës së Madhe, një qytetërim shumë i zhvilluar i kohës. Një nga përfaqësuesit më të moshuar të këtij fisi, Mexhit Capa, banon në fshatin Kurtbeg. Ai tregon se stërgjyshi i tij pati zbritur nga Selishta, duke qenë se kishte marrë të shoqen tek fisi Keshi në Majtarë. Djali i tij, Beqiri u rrit në Majtarë, pranë trojeve të dajave të tij. Nga martesa e tij erdhën në jetë katër fëmijë, dy vajza dhe dy djem, Ymeri dhe Mehmeti, që është dhe babai i Mexhitit.

Në kujtimet e tij, Mexhiti e përshkruan xhaxhain e tij, Ymerin si një njeri të ditur e trim. Ka qenë diku viti 1917 dhe luftohej kundër serbit, që për të disatën herë shkelte trojet shqiptare dhe Dibrën në veçanti. Xhaxhai i tij me disa burra të tjerë, nën komandën e Halit Lleshit, ishin vendosur në një kullë në një fshat të Zerqanit. Forcat serbe rrethuan kullën dhe bënë thirrje për tu dorëzuar. Ymeri me disa shokë të tij çanë rrethimin nga ana e pasme dhe u larguan në pyllin që ndodhej ngjitur me shtëpinë. Kur shkoi te Halit Lleshi, komandanti i tij e vlerësoi dhe përgëzoi për trimërinë e treguar. Ymeri nuk jetoi gjatë. Ai u martua, lindi një vajzë dhe ndërroi jetë shpejt.

Dhe babai i tij Mehmeti, ishte njeri punëtor, bujar dhe trim. Pati tre djem, Dilaverin, Beqirin dhe Mexhitin. Si njeri nacionalist dhe i papërkulur, nuk u bashkua me lëvizjen dhe forcat komuniste dhe kjo nuk u pa me sy të mirë nga qeveritarët e rinj. Shumë shpejt do të fillonte hakmarrja mbi të, familjen e tij dhe mbi shumë të tjerë në zonë, që kishin mbajtur të njejtin qëndrim.

Ishte viti 1946. Komandanti famëkeq Mehdi Bilbili, ishte hedhur në aksion për të gjunjëzuar dhe eleminuar "kokat" e Maqëllarës dhe gjithë Dibrës . Në fshatin Bllatë e Sipërme kapën dhe arrestuan Dalip Lazrin, në Majtarë arrestojnë Lam Zeqën, në Allajbegi Haxhi Rushitin, në Grezhdan babain e Gafur Agës, në Kurtbeg Bit Demën, ... Kurtullën në Pocest dhe Murat Daten në fshatin Erebarë. Këtë të fundit e pushkatojnë në përrua, akoma pa dalë në xhade, kurse të tjerët i nisin për në burgje dhe hetuesira. Po në këtë natë forcat e sigurimit rrethojnë dhe shtëpinë e Mehmet Capës dhe i bëjnë thirrje të dorëzohet. Armën e kishte. Mund dhe të vriste dy tre syresh, mund të çante dhe rrethimin e të ikte. Jo, nuk do ishte vendimi i duhur. Pas do të linte gjashtë fëmijë dhe dy gra. Do të shpëtonte jetën e tij dhe pas tij një familje, ku nuk do të kishte asnjë të mbijetuar. Makineria shtetërore komuniste nuk do të kursente as gratë dhe fëmijët. Dhe pse u dorëzua Mehmeti, shtëpia e tij i'u nënshtrua një kontrolli të pashembullt, i denjë për filmat horror. Mexhiti, fëmijë 5 – 6 vjeçar aso kohe, kujton pamjet e tmerrshme. Nënëmadhen, kështu quhej gruaja e parë e Mehmetit, e torturuan në mënyrë të pashembullt. Vëllain e madh, Dilaverin, që kishte mbushur vetëm 13 vjeç, e torturuan po aq mizorisht. "Kush ka ardhur te ju, nga njerëz të huaj? Na thoni emrat! Po Sabri begu, a ka qenë këtu te ju? Këto e shumë pyetje të tjera u bëheshin fëmijëve, të tmerruar nga veshjet e tyre, nga armët e tyre, nga zërat e çjerrë. E mbërthenin Dilaverin për fytit të njomë, gati për ta mbytur. U deshën më shumë se



dy muaj, pas këtij episodi, që ti shërohej fyti dhe plagët e shkaktuara, prej atyre njerëzve të pashpirt.

Babain, vazhdon tregimin, Mexhit Capa, bashkë me të tjerët, i dërguan në burgun e Peshkopisë. Tortura e tortura të pafund. Të pakuptimta dhe absurde. As ai vetë nuk e dinte përsenë. Nuk kishin kaluar vetëm se dy muaj dhe babai , Mehmet Capa ndërroi jetë. E vranë, e helmuan, apo vdiq në tortura, askush nuk e mësoi të vërtetën. Bile sot e kësaj dite as varri nuk i dihet. Bashkë me dy bashkëvuajtës të tjerë mund të jenë në të njejtin varr, ose në Kamen, ose në Llasen, në hyrje të qytetit.

Nuk kaluan vetëm pak muaj nga këto ngjarje të tmerrshme, kur një tjetër aksion, po aq i lemerishëm, u shfaq në popullatë, aksioni i mbledhjes së armëve. Nuk kishte afate, as mirëkuptim për ti dorëzuar, vetëm urdhër dhe mundësi të arta, për të goditur ndonjë të pabindur. Mexhiti tregon se familja jonë dorëzoi dy pushkë, kurse një nagantë e fshehëm diku, për ta pasur për çdo rast. Qendrën e grumbullimit të armëve e kishin te xhamia e Bllatës së Sipërme. Ne kishim një kushëri të afërt, Osman Capën, babain e Ramiz Capës. Një ditë ai vjen te shtëpia jonë i zbehtë, i lodhur dhe tejet i mërzitur. Nënëmadhja e pyet se çfarë kishte ndodhur. – Më kanë rrahur e dërmuar, oj mixhavajc, - i thotë Osmani. – Shif si më kanë bërë! E ngren pak këmishën e bardhë tek ijet, aty ku dallohesin të enjtura dhe plagë të mavijosura.- E dorëzova pushkën që kisha, por më kërkojnë një nagant dhe unë nuk kam ku e gjej.

Nënëmadhes i erdhi keq. Shkoi e mori nagantën që kishte fshehur, diku në hatulla dhe i'a dha në dorë. – Merre dhe shko dorëzoje. Kështu bëri Osmani i shkretë. E dorëzoi atë mjet të vogël vrasës, por torturat që i kishin bërë kishin qenë tepër ekstreme. Shkoi të mjekohej disa herë në spitalin e Dibrës së Madhe, por nuk e mori më veten. Në krye të gjashtë muajve ndërroi jetë si pasojë e plagëve që i shkaktuan policët e shtetit.

ARRATISJA

Kohë të vështira erdhën për familjen e Mehmet Capës. Ishin kohë krizash për gjithë vendin, për gjithë njerëzit, një varfëri ekstreme. Mungesa e kryefamiljarit ishte një sfidë shumë serioze për tetë anëtarët, ku pothuaj asnjeri në gjendje për të punuar. Jo vetëm kaq. Gjithë këtyre të këqiave, u shtohej dhe një e keqe akoma më e madhe. Në vend që dikush të na mëshironte e të na mbushte atë boshllëk që linte mungesa e babait, kjo ishte një arsye për të na poshtëruar akoma më shumë. Në një takim të fshatit vjen shefi i policisë, apo kryetari i degës, që do të deklaronte me solemnitet. Ja, dhe këtyre, duke na treguar ne me gisht, do t'jua nxjerrim shpirtin, siç bëmë me babain e tyre.

Pas shumë përpjekjesh, Mexhiti merr një leje pune për të punuar si zjarrmëtar në minierën e Bulqizës, në sektorin ku punonin të burgosurit. E çfarë mund ti bënin më shumë?! Çdo ditë në fronte të reja, në hapësira të rrezikshme, me materiale plasëse nëpër duar. Por dhe atje nuk e lanë. Një ditë, tregon Mexhiti, na thirrën, mua dhe dy kolegë të tjerë. Na kërkuan disa sqarime për biografinë tonë dhe na larguan nga puna. E shihnim që fati i zi po na ndiqte si gjarpër kudo. Nuk mund t'i fshiheshim, nuk mund të iknim gjëkundi. Kur të gjitha shtigjet ishin bllokuar, ndoshta vetëm një kishte mbetur hapur. Sytë e tyre u drejtuan tej kufirit, që nuk ishte vetëm disa qindra metra larg. Ata i dinin rreziqet e kësaj pune. E dinin që mund ti kapnin dhe duke e kaluar atë, e dinin që mund ti kthenin dhe pasi ta kishin kaluar atë. Por ata i besuan ëndrrës së tyre. Ndoshta vuajtjeve e poshtërimeve të vazhdueshme u kishte ardhur fundi?

Ashtu në heshtje bënë përgatitjet e fundit. Do të niseshin dy vëllezërit me familjet e tyre. Dilaveri, më i madhi i tre vëllezërve, nuk ishte përfshirë në këtë plan. Beqiri ishte vëllai i mesëm dhe kishte tre fëmijë, Jenen pesë vjeçare, Metin trevjeçar dhe Zenin vetëm një vjeç. Po sikur njëri nga dy çunat e vegjël të qajë dhe ti diktojnë? Kishin marrë dhe pak pambuk me vete, për të amortizuar sadopak qarjen e fëmijëve të vegjël, nëse kjo do të ndodhte.

Janar i vitit 1969. Dy familjet, bashkë me fëmijët e vegjël u nisën drejt të panjohurës. Mexhiti kujton se ishte borë dhe kufirin e kaluan diku poshtë fshatit të Kllopçishtit. Me vete kishin një armë, thjeshtë për të qetësuar vetët e tyre. Shkuan në Dibër të Madhe dhe u dorëzuan atje i mbajtën 17 ditë atje, derisa bënë verifikimet. Fati i keq i ndoqi sërish. Në atë kohë dy shtetet kishin një marrëveshje për rikthimin e të ikurve dhe kësisoj ata duhet të ktheheshin në Shqipëri. Sikur të mos mjaftonin hallet që kishin, tani do të gjykoheshin dhe për tradhti ndaj atdheut. Kthimin e bënë në Qafë të Thanës. Më pas i dërguan në Pogradec e që aty në Tiranë, ku i mbajtën pesë ditë në burg. Që aty, me autoburg i dërgojnë në birrucat e Peshkopisë, për t'ju nënshtruar hetimit të mëtejshëm. Shumë tragjik ka qenë momenti i ndarjes me fëmijët. Nuk ishte një ndarje sa për të shkuar një shëtitje, por 15 apo 25 vite pa i parë e pa u dëgjuar zërin. Daja i fëmijëve, Selman Rexhepi nga Hoteshi i mori për te shtëpia e tij. Që tani e tutje, ai do të ishte për ta,dajë, prind, edukator, kujdestar e çdo gjë tjetër, për tu zbutur sadopak dhimbjen e pikëllimin.

Gjashtë muaj ndenjën në birucat e Peshkopisë. Katër muaj nga kjo periudhë, pa dalë në gjyq. Të gjitha llojet e torturave u aplikuan në trupat e tyre. Lloj lloj spiuni u futën në qelitë e tyre. Ishte një ferr i vërtetë, që nuk dinin se kur do të përfundonte. Dhe ja tek erdhi dita e gjyqit. E zhvilluan te Kinemaja e qytetit. Vunë dhe altoporlantë, që të dëgjonin dhe qytetarët se si u jepej dënimi i merituar " kriminelëve dhe tradhëtarëve" të vendit. Prokurori pyeste Mexhitin: Përse ike në Jugosllavi? Ti ishe me punë në Bulqizë! Mexhiti j'u përgjigj se ishin shtatë veta e nuk mund të jetonin me një kile bukë misri në ditë.

Gjyqi vazhdoi dy ditë rresht. Në seancën tjetër e hoqën altoporlantin. Kishin ardhur dhe civilë për të dëshmuar kundër nesh e që kërkonin dënimin tonë maksimal. Mexhiti kujton dhe shumë syresh, gjykimin e të cilëve ja ka lënë Zotit për kompetencë. Prokurori dha pretencën. Dy burrat të dënohen me pushkatim, kurse gratë me dhjetë e pesëmbëdhjetë vite burgim. Çfarë keni për të thënë si fjalë të fundit? Ngrihet Mexhiti e i thotë trupit gjykues, le të pushkatohej ai dhe të shpëtonte vëllai, se kishte tre fëmijë të vegjël. Sapo mbaroi ai fjalën, u ngrit i vëllai, Beqiri e thotë se ai është fajtori më i madh, se ai i kishte mbushur mendjen vëllait të vogël. Ashtu po "ziheshin " dy vëllezërit, ku secili e kërkonte vdekjen për vete e jetën për vëllain e tij. Trupi gjykues u tmerrua nga ajo skenë e jashtëzakonshme e dashurisë së vëllait për vëllain e tij.

Pasdite u dha vendimi përfundimtar. Beqir Capa dënohej me pushkatim, Mexhiti me 25 vjet heqje lirie, e shoqja e Mexhitit me 15 vite, kurse kunata e tij me dhjetë vite, pasi ishte nëna e tre fëmijëve të vegjël. Pas apelimit në Gjykatën e Lartë, vendimi u la në fuqi, kurse një muaj më pas, Presidiumi e ktheu në 25 vjet dënimin me vdekje të Beqirit.

DEGEZIMI I RESHANIT

Një degë tjetër e këtij fisi të shquar u rrit dhe u zhvillua në Reshan, një lagje e vogël e fshatit të Bllatës së Poshtme. Si fillesë e tij përmendet Miftar Capa i vjetër, që nuk e pati jetën e gjatë. Një sëmundje e rëndë e ndau nga kjo botë në një moshë të re, duke lënë pas vetëm një djalë, Hasanin shtatë vjeç. Vetëm një vit më vonë një goditje tjetër e shokon djalin e vogël. Ndërron jetë dhe nëna e tij, duke e lënë dyfish jetim. Tofik Xharri nga Pesjaka, daja i jetimit, do të bëhej tani e tutje për të, nënë e baba, mësues dhe edukator. U rrit e u martua në Pesjakë tek dajat e më pas kërkoi të shkojë në vendlindje.

Në pamundësi për të bërë, apo për të blerë një shtëpi, ndenji disa vite në Bllatë të Sipërme, tek miq të familjes, tek Hamdi Dida, Hysen Arapi e së fundmi tek Lut Troca. Ndërkohë, disa familje të fisit Daci në Reshan, u larguan për në Turqi dhe në njërën prej tyre u fut Hasan Capa, me familjen e tij të re. Ai kishte njerëz të afërt tek fisi Sohodolli, në Kojnarë të Dibrës së Madhe, ndaj Sigurimi i shtetit e survejonte, se mos Hasani ndonjë ditë do të kalonte në anën tjetër të kufirit. Në fakt, nuk ndodhi ashtu. Hasani ju përvesh punës dhe bashkë me të shoqen, rritën gjashtë fëmijë, katër djem e dy vajza.

Vështirësitë ekonomike nuk u dhanë mundësi fëmijëve të Hasanit të shkollohen sa duhet dhe sikur dashuria për librin të ishte e madhe. Ata punuan fort, në sektorë të ndryshëm, me bujqësi e blektori, me minierë e me tregëti dhe falë Zotit, arritën të krijojnë familjet e tyre, të ndërtojnë shtëpi të bukura e të fitojnë respektin e komunitetit ku banojnë.

Miftari është më i madhi i tyre dhe i vetmi që ka mbetur në Reshan, atje ku u lindën dhe u rritën gjithë fëmijët. Shtatë fëmijë lindën dhe rritën, bashkë me Naimen dhe secili prej tyre sot ka krijuar familjen e tij. Djali i dytë Xhelali ka tre tre djem e një vajzë. Ka ngritur një vilë të bukur në Maqëllarë dhe po aty një market shumice, ku punon, bashkë me familjen e tij. Zeneli, i treti nga djemtë, ka vetëm një djalë, Benardin. Pas mbarimit të shkollës së mesme, ai studjoi në Universitetin e Tetovës për biznes. Bashkë me babain e tij kanë ngritur një biznes mjaft të suksesshëm, për prodhimin e jufkave. Zeneli dhe vëllai më i vogël, Hajriu kanë dy vila të bukura në rrugën që të çon për te dogana e Bllatës.

Të duket vërtet interesante puna e Krijuesit të Gjithësisë. Shumë e shumë vite më parë Hasan Capa ishte një jetim shtatë vjeçar, pa të dy prindërit, kurse tani, vetëm nga brezi i parë i fëmijëve kemi të paktën njëzetë veta.

(vijon në faqen 18)

Enver Mehmet Kaloshi ka marrë përsipër një mision: Atë risk që për shkaqe politike fati i rëndë i rezervoi jetës së tij dhe gjithë sojit të tij gjatë komunizmit deri në krijimin e "Sagës së Kaloshëve"

Për *misionin* e Enver Kaloshit, *arketipin* Llan Kaloshi *dhe* Irfanin - një Kalosh

PROF. DR. BAJRAM XHAFA

Enver Mehmet Kaloshi ka marrë përsipër një mision: Atë risk që për shkaqe politike fati i rëndë i rezervoi jetës së tij dhe gjithë sojit të tij gjatë komunizmit deri në krijimin e "Sagës së Kaloshëve", siç e artikuloi me të drejtë shtypi pluralist, po e fikson në libra të dobishëm me vlerë që i kalojnë caqet e interesave personale, të familjes apo fisit. Tregimet verbale dhe ankesat për të kaluarën para njerëzve të lodhur deri në kapitje, ndonjëherë të venë dhe në pozitën e qaramanit, tregime që shpesh i merr era. Verba volant, scripta manent (fjalët fluturojnë = i merr era, të shkruarat mbeten), thotë latini. Me dije apo pa vetëdije, mbase edhe Enveri nuk don të përjetojë thënien e La Fontenit: - Vdiset dy herë, shkruan ai, vdekja e dytë është të jesh i harruar. Enveri assesí nuk don të mbetet i harruar. Lidhur me vlerën e të shkruarit, me këtë "hall njerëzor" dijetari islam Hasan Basri thotë: "Boja e shkrimit e dijetarëve krahasohet me gjakun e shehitëve (dëshmorëve), boja e dijetarëve vjen më e rëndë". Kjo e bën të shkruarin mesazh hyjnor. Për këtë edhe Enveri është i fiksuar, i vendosur.

Të shkruarit bën që vuajtja dhe pësimi të shpërndahet e pjesëtohet në më shumë njerëz, si solucioni (i idhtë) në ujë. Kjo e lehtëson shpirtin e njeriut të vuajtur e të munduar. Ia lehtëson atij edhe të kaluarën dhe bën që ajo të mos i qëndrojë si gjyle e rëndë hekuri që duhet ta heqë zvarrë e në vetmi deri sa të vdesë. Kur shoqëria merr pjesë në një fatkeqësi njerëzore që kaplon një familje, një bashkësi, një krahinë apo mbarë kombin, atëherë misioni bëhet shoqëror, kombëtar. Kur dhemb një gjymtyrë, dhemb gjithë trupi. Vetëm atëherë mund të quhesh vërtet shoqëri njerëzore në kuptimin e plotë të fjalës. Vetëm atëherë mund të quhesh *nacion, komb*. Kështu i shërben më mirë dhe së ardhmes. Përndryshe shkon gjakhumbur, si individ, si shoqëri, si komb. Alem kalem, t'i drejtohemi Burimit të Parë që vjen nga qielli: *"Nun. Betohem për penën dhe për atë që shkruajnë"* (Kur'an, El-Kalem (Pena) - S: 68:1).

Duke ruajtur "pronësinë" e kapitalit, në këtë mision Enveri kërkon për ndihmë edhe shokë e miq. Në njëfarë kuptimi kërkon t'i shmanget subjektivizmit të mundshëm, kërkon konsensus, ndan përgjegjësinë. Kjo tregon urtësi e vetpërmbajtje. Më nderoi edhe mua duke më marrë si "argat" e duke më përzgjedhur si mik të vjetër të shkruaj diçka për "Kaloshët", trungun fisnor, familjen e tij apo diçka më specifike. E quajta dhe e quaj përgjegjësi të madhe, sepse kjo lidhet me shkallën e njohjes dhe artin e të shkruarit, gjë që nuk ia njoh vetes. Dhe, kur nuk thua gjë, rrezikon t'i hysh në hak mikut dhe hyn në gjynah edhe me lexuesin. E ata janë "Kaloshë". Nuk (m)bân puna.



ARKETIPI LLAN KALOSHI – LAVDIA HYJNORE DHE GJAMA NJË POPULLI

Kaloshët janë një emër i madh. Kjo është sfida e parë kur merr të shkruash për ta. Unë nuk marr përsipër të bëj apologjinë apo historinë e madhe të lidhjes së Kaloshëve me Kastriotët, siç bën Fehmi Kaloshi me "Epopeja e Kastriotëve", një libër me mbi 500 faqe, sepse ajo kërkon specializim të veçantë dhe një jetë e tërë nuk do të mjaftonte. Mbase ajo do të ishte historia e vërtetë e Shqipërisë dhe "Kaloshët" do të ishin në epiqendër të historisë kombëtare. Por edhe duke e anashkaluar me vetëdije atë tezë, ata, Kaloshët, qenë përsëri në qendër të kësaj historie. Në kohët e reja ata kanë vend dinjitoz në historinë e Shqipërisë. Historiografia shqiptare i ka anashkaluar deri në mohim për rolin që kanë luajtur e vendin që kanë ata dhe gjithë kategoria e tyre shoqërore në historinë e Shqipërisë. Kaloshët kanë histori tipike të racës shqiptare, tamam Histori Shqiptare, **genuine** (e vërtetë, e njimendtë, e sinqertë).

Kaloshët janë "racë" vitale, energjike, luftarake, palcë shqiptare. Ato pak gjëra që dua të them nisin me Kaloshët e Sinës, nënkrahina e Çidhnës (një ndër "Nantë Malet" e Dibrës), në Dibër të Poshtme. Në kushtet e zgjerimit të marrëdhënieve të tregut gjatë shekullit XIX një pjesë e Kaloshëve të Sinës u vendos në anën e tej Drinit, në Kandër e afër Kastriotit (Fajer = Fier), por brenda njësisë, Malit të Çidhnës, duke i ruajtur lidhjet me ata të përtej Drinit, të Sinës. Ashtu si më parë, ata përsëri mbetën një, "një fis e një farë", Kaloshë, në sifat (cilësi, sjellje, virtyt) e nasihat (mësim).

Ndër Kaloshët, Llan Kaloshi përbën ndoshta prototipin e fatit dhe fatësisë së shqiptarit mbase qysh nga Pellazgët Hyjnorë e Ilirët e deri tek Arbërit e së fundmi, Shqiptarët. Si një fill e përshkon i njëjti fat këtë popull, *"pa kundërshtim ma i moçmi i gjithë Evropës, ma i vjetër se grekët e se të gjithë të tjerët kombe që njihen prej historijet"*, që *"ka qenë gjithmonë një komb fund e krye luftëtar"* siç shkruan **Pashko Vasa** në ***"Shqypnia dhe shqyptarët".*** Llan Kaloshi është "arketipi" i genit të shqiptarit.

Për energjinë dhe forcën që tregonte, Turqia i dha Kaloshit edhe një gradë, "çaush" (rreshter), me ruejt kufinin nga bjeshkët e Hinoskës deri në Gramë. Kjo i dha dorë me u forcue dhe me u zgjerue nga ana ekonomike. Ndër Kaloshët, më tipiku dhe më epiku është Llani, Asllan Kaloshi. Ka qenë edhe më jetëgjati, më dramatiku e më heroiku, deri në kufijtë e legjendës. Jeta e tij, si në ciklin e kreshnikëve. Në historinë e jetës së tij duket se është mishëruar e koncentruar gjithë heroizmi dhe epizmi, mallkimi dhe drama e Kaloshëve në veçanti dhe e dibranit e shqiptarëve në përgjithësi.

Llan Kaloshi ishte kundërshtar i Turqisë. Po kështu edhe miqësia e tij. U dënua me 101 vjet në burgun e Manastirit. Atje e kishin vu në nji qoshe, sikur të kishte qenë nji krye vendi, me rroba të bardha, nji brez i ngushtë për mesi, çibukun e gjatë me dru abanozi e qelibar e mbante ndezun dhe kur i ndalej kishte të rinj që i jepshin zjarrm me dorë në zemër, shkruan **Xhelal Ndreu** në librin e tij ***"S'ka qetësi në Lisivalle"***. Pastaj lirimi i tij nga të birt në stilin e çlirimit të detyruar të pengjeve, nga vetë Sulltani, një histori ku rreziku dhe heroizmi përzihen me aspektin komik.

Ndër të paktët, në mos i vetmi nga Malësia e Dibrës që kishte shkuar në Qabe dhe ishte ba "haxhi", ndaj u quajt Haxhi Llani, me ç'rast në shtëpinë e Kaloshit u kurdis bukë e madhe në të cilën u shtrua i gjithë 'Dheu'. Në një kohë zie buke, sofrat e Kaloshit s'mejshin tue u shtrue në shtëpi, oborr e livadhe jashtë. U njoh fort si bukëdhanë, madje edhe në kohë zie. Buka e dhanme në kohë zie asht nji bujari e teprueme. Në Çidhën e në Dibër shtëpia e Kaloshit ua kaloi dhe oxhaqeve të para, ia kaloi dhe Hetem Tajis së Persisë që përmend Sheh Sadiu në Gjylistan, shkruan **Xh. Ndreu**. *-Shifshe, - vazhdon më tej ai, - gra e fëmijë familjarisht, të kapur dorë për dore tue ardhë si me drojtje, me sy të përhumbun e të përlotun, tue u ulë në sofrat e shtrueme jashtë n'oborre e livadhe, pa i thanë kujt "mirë se u gjeta" e pa u thanë kush "mirë se erdhe". Ha e ngopu dhe merr dhe copa buke në dorë e shko; as faleminderit, as s'ka përse, s'dihej as kush e dha atë bukë, as kush e hangër, si në përrallat e vjetra, kur njerëzit hajshin sendet e blatueme nga qielli*. Me të vërtetë, sofra e Kaloshit mbeti teprinë ç'mban Dibër. Kanga e popullit se ***"Karahasanit s'i del kush, as me sofër as me pushkë",*** tashti i përshtatej ma shumë Kaloshit. Kamba e udhëtarit, pazarliut dhe e mikut prapë ndalej në Fajer te kullat e Llan Kaloshit. *"Sofra e Kaloshit, rana e Gjelagjoshit"* (Xh. Ndreu, "S'ka qetësi në Lisivalle", Korabi, Shtypshkronja "Ergei", Tiranë 1996, f. 88).

Por, për Shqipërinë erdhën kohë edhe më të vështira, më të vështirat në historinë e saj mbi 2500-vjeçare. Shqiptarët kishin marrë pjesë në luftrat e përbashkëta me Perandorinë kundër armiqve të saj dhe të Shqipërisë. Tatëpjeta në të cilën Perëndimi e kishte hedhur Perandorinë Osmane, mori me vete edhe Shqipërinë. Luftrat e tyre po bëheshin gjithmonë e më të pafat. Në fyell e në çifteli u këndon dibrani kangën si elegji të asqerëve të mbretit, që i mbyti peksimeti i thatë, e tue u lutë me gjithë zemër *"hej zot sjellna nji devër tjetër"*. Shqiptarët deshën t'i ikin këtij fati, deshën 'devrin' e tyre, prandaj u ngritën në luftë për autonominë e vet, por për ta ishin bërë plane dhe prita ogurëzeza. Kësaj radhe puna e tyre kishte shkuar në zgrip, në teh të greminës. Kishte 150 vjet që shqiptarëve u shkonin punët vetëm teposhtë.

Asllan Kaloshi ishte edhe në moshë të tejshtyrë, edhe 'haxhi', dhe si i tillë kishte kohë që pushkën e kishte varë në kunj për të mos e kapur më. Por Atdheu ishte në rrezik. Llan Kaloshi mori vendim: rruajti mjekrën e 'haxhiut' se iu desht me kapë edhe nji herë pushkën, kur u thirr me mbledhë forca për të luftue me Karadakun - dhe në këtë luftë me Mal të Zi qëndroi si burrë me taborin dibran në llogoret e Taraboshit për tetë muaj rresht pa dalë prej istikamit, natë e ditë me pushkë për faqe pa e lëshue taben. Me bukë e pa bukë, me ujë e pa ujë, me tirqet e përllangët deri në gju, fshinë fytyrën nga djersët e filxhanin e kafesë me peshqir të nximë tetë muaj pa la. Edhe nga Taraboshi u kthye fitimtar dhe e bani detyrën e vet. Kështu e përshkruan nipi i Elez Isufit dhe i Kaloshëve, Xhelal Ndreu (f. 84). Ku krisi pushka për luftë dhe Kaloshët të mos ishin të tabe të parë: Që nga "Kriza Lindore" dhe Lidhja e Prizrenit e deri te Lufta e Dytë dhe e ashtuquajtura Luftë "Nacionalçlirimtare". LDB dhe Lufta Civile i gllabëroi Kaloshët në syrin e ciklonit nga doli kënga vajtimtare e quajtur "Saga e Kaloshëve" me 23 të vrarë.

Por Kaloshët, ashtu si të gjithë shqiptarët kishin edhe një sindrom, të rëndë, shumë të rëndë: E kanë mbajtur "pushkën në gropë të zjarrmit". Edhe për këtë personazhi ynë, që është person real, historik, Llan Kaloshi është më fatziu, arketipi, tipiku në "ambientin" tipik. Djemtë e tij, Hasani, Manja, Mahmuti dhe Sula ishin nipërit e Murres në Luzni (Selane). Lije Murrja, si Lije Murrja me za, burrneshë e meçme, e pritshme, bijë Murresh, e shoqja e Llan Kaloshit lindi katër djem si dragoj dhe pesë vajza. Nga pushka i shkuan të katër, nga "pushka në gropë të hinit". Së pari Sula, djali i katërt i tij, i hollë e i gjatë si Ndue Lleshi i Mirditës, aq i pashëm, si yll drite, që u vra pahir (padashje) kur i patën dalë në pritë nji hasmi nga Luznija te Ura e Lushës n'Arras, shkruan autori i lartpërmendur (Xh. N.). Nuk ka mbetur pa arsye ajo fjala kobndjellëse për pushkën, se ajo virane "sa ka grykën ka nafakën".

Kaloshit të Epërm dhe Kaloshit të Poshtëm, vllazën të nji zjarrmi e hiç ma pak, u hyni tenja, hynë në luftë e ranë në gjak me njëri-tjetrin. Një ditë, të tre të birt e Llanit gucnin me fjalë Halilin, për do hesape të vjetra, për të dalë e për t'u vrarë me të si burrat. Por ai u punoi një reng, la nji dajën e vet të flasë me ta dhe vetë doli përmbas shtëpish e u shkoi me nja tre vetë me armë ndër duer drejt e mbas shpine, nji thumbi e i lanë që të tre të vramë, tue u përpëlitë n'agoninë e vdekjes e tue shti duert në zorrët e mushkënitë e njeni tjetrit, që u kishin dalë jashtë dhe iu vinte era barut e gjak, derisa të tre vdiqën e mbaruen.

I ktheu kushrini për së mbari, u mbylli gojët e sytë...dhe shkoi e u mbyll në kullë. Ky qe kulmi i gjaksisë së Kaloshëve. Llan Kaloshi mbet në jetima, dy djemtë e të birve, njeni shtatë e tjetri tre vjeç dhe nji djalë i veti, sugjar me Bojkën, nji vjet e gjysmë. Haxhiu s'e kapte ma pushkën, u bani mortën të birve dhe me durim n'atë kryevendi priste miq e dashamirë, sehirxhi e hasëm, që vijshin për kryeshëndoshë (f. 85, 86).

Në raste të tilla vakijatesh bëheshin edhe bilance. Tue pi kafe e duhan, njerëzit në mortë i numruen sa të vramë e të plagosun kishin të dy palët, doemos nga gjaku e nga ndihmëtarët miq e nipní – i nxjerrshin deri njëqind e dymbëdhjetë. Edhe lufta midis shtetesh nuk korr aq shumë në një betejë. Vdekjen as'e kam pasë dhe as e kam për pesë (si asgjë) thoshte Haxhi Llani. Shqiptari në përgjithësi udhëtonte me qefin për brezi. Në odat e burrave, në mexheliset, vrasjet nuk kalonin pa gjykim. Kaloshit të poshtëm i eci pushka, por hije s'i pat, vrasje si me pabesi. Kësaj i thonë edhe *pushkë* e *pagjetme* siç ka edhe pushkë për të cilat thonë "i lumtë pushka". Ndër të gjitha gjakësitë, odat e burrave nxirrnin ma të këqijat ato në vllazni e ato në pabesi. *"Ta mbash pushkën në gropë të zjarrmit, asht teposhtë"* (Xh. Ndreu, f. 55, 86, 90). Asht vu re edhe, se dibrani nuk asht vra kurrë ballë për ballë, por gjithnjë me pusi e prita. Ndërsa në Dibër thonë se vetëm shkodrani vritet ballë për ballë, sy për sy e gisht për gisht, burrash.

Tash që mbetën në mashkulli të mitur, disa nga kufitarët me tokë e me ara, filluen t'i prishin megjet, t'i zaptojnë ara e livadhe, i shtijshin gjanë e gjallë në meja e në arat e mbjella për të damtue, si në mall pa zot. Do nipa e stërnipa të tij ia prunë ma ngushtë. Të tjerë morën guxim dhe filluan t'i përzënë gjënë e gjallë të Llan Kaloshit, bile i përzunë dhe qetë në arë duke lëruar dhe zunë pendët e veta, kush në krye e kush në fund. Si Kont Ugolini që shkoi tre herë tek shpatat e të birve, ashtu dhe Llan Kaloshi u ngrit e shkoi te armët e të birve, vjerrë me gryka poshtë, zymtë-zymtë u kthye e u ul në vend të vet. Ndezi nji çibuk, u ngrit, mbathi këpucët dhe muer udhën për kah shtëpia e Halilit. Kur u afrua te porta e avllisë, gratë e shtëpisë e njohën, shkuen e i thanë Halilit të mshefet se po vjen babgjyshi e të mos i dalë para, as mos ta presë në dhomë.

U ul babgjyshi në krye të vendit pa folë e pa u përshëndet me asnji, tundi çibukun për votre tue bërtitë nji të madhe: "ku asht?" disa herë. Shkuen e i thanë Halilit të vinte se e kërkonte. Emën nuk i zu. E mbërrini Halili, me droje, kryevjerrë, u ul në fund të dhomës, kacipup pa ba za, pa i dalë ndër sy. Haxhi Llani i ra votrës me çibuk dy tri herë e me nji za të ngjirët e të mekun i përsëriti dy herë: "Or babgjysh, janë tûe më qitë" (nënvizimi B. Xh.) dhe bani në të ngrejtme, pa ndrrue ma asnji fjalë e shkoi pranë gjaksit, nipit dhe duel.

Llani nuk dinte shkrim e këndim. Nuk dinte dhe s'kish si të dinte për Homerin dhe Iliadën, por veprimi dhe fjala e tij ishte më homerike se edhe tek vetë Homeri. Shpejt, me "gjykim të shkurtuar" (po të flasim me gjuhën dhe praktikat e sotme juridike), por providencial, aty për aty mendoi dhe e zgjidhi: shkoi tek hasëm-vëllau a vëllau-hasëm; kurrkund tjetër dhe e "urdhëroi". Edhe ai shpejt e kuptoi dhe iu përgjigj duke iu betuar, me fjalë dhe veprime saktësisht providenciale.

(vijon në numrin e ardhshëm)

FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

Marrë nga libri "Toponimia e Çidhnës" i autorëve

Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri,

Botimet M&B, Tiranë, 2016.



FJALË TË RRALLA

K

►***kallçaj / kałʧaj / kállçâj-t':*** Çorape grash, të shkurtër, prej leshit të deles, të cilët visheshin mbi çorapet e gjatë. *Kallçajtë*, sot bëhen me penjë të linjtë dhe quhen *sporta*: *hoqi opingat dhe ecte veç në kallçaj.* E njëjtë me *kalcinj* e *kalcunja*, nga it. *calze*, çorape.

►***kërlup / kərlup / kërlūp-i:*** *Tamahqar, i babëzitur, që han shumë*: *hajde kërlup, hajde; ai është kërlup i madh, s'e llâ (ngop) asgja.* Duhet të ketë lidhje me *llup, llupës, kërlup*.

►***kashnajk / kaʃnajk / káshnâjk:*** *Kashnik*, shajak: *end kashnik në vek; kashnik për tirq.*

►***katrrosh / katrɔʃ / katrrósh:*** *I çregullt, i ngatërruar, i katrruar, katrrosh*: *dhëmbë katrrosh, ai që i kanë dalë dhëmb mbi dhëmb*.

►***kllajk / kłajk / kllájk-u:*** *Dukë e mirë. Hije e dukë, kllajk e trup.*

►***k***ërçajke / kərʧajkɛ / kërçájke-t: Krandet e holla që mbledhin gratë për të zënë zjarrin ose për të pjekë flija. *Mora një barrë me kërçajke. Kërçik e kërçunë, kërcunë*, të një burimi.

►***karajek / karajɛk / kárajek-u:*** Për qentë: *karajak*, qen i zi (nga turq. *kara*) dhe i fuqishëm. *Karajak e bishtcub.*

►***kaptell / kaptɛł / kaptéll-i:*** Dërrasë e hollë në formë harku mbi kryet e djepit për ta mbrojtur fëmijën nëse djepi përmbysej dhe për ta përkundur atë. Nga lat. *capitae, krye*.

►***kulloh's / kułɔh's / kullóh's-a:*** Napë e pastër që vihet mbi enë për të kulluar qumështin. *Kullohës qumështi, djathi* etj.

►***k't'bajm' / k't'bajm' / k't'bájm':*** Njëfjalësim i ç'të bëjmë.

►***k'ban / k'ban / k'bán:*** Njëfjalësim i ç'ban.

►***kunjas / kuɲas / kūnjas-it:*** *Fije mishtore që u dalin lopëve në mishrat e dhëmbëve e s'i lënë me hangër*. Çabej, *dhambzit.*

►***kalamet / kalamɛt / kálamet:*** Njëlloj me *garamet*që përmend Çabej. *Alamet e kalamet, kush ka vdekë e kush ka mbetë*.

►***kamatruc / kamatruʦ / kámatruc:*** Njëlloj me *galacu* që përmend Çabej. U mblodh (rrinte) *kamatruc*, që i ka këmbët e mbledhura *truc*, por edhe *kapatruc.*

►***kaçëk / katʃək / káçə̀k-u:*** Njëlloj si tek Çabej, *gur i vogël zalli, por edhe lojë fëmijësh që luhet me pesë gurë të vegjël*.

►***kaklic' / kakliʦ' / káklic'-a:*** Nga *kakë*, shkurtim prej saj, *kaklicë*, jashtëqitja e shpendëve, njëllojë me *glasë*.

►***kaçups / katʃups / káçups-i:*** Lloj zogu që ka në krye një xhufkë. *Kaçups* thirren me përkëdheli edhe djemtë e vegjël.

►**e *kaça / ɛ katʃa / e káça:*** E njëjtë me foljen *kafshoj* te Çabej. E *kaça* mollën. Mollë e *kaçme*. Nga folja *kaç* rrjedh edhe emri *kaç/ë-a*. Hangra dy *kaça* (kafshata) nga molla. Neologjizmi *kaçajtë* është sinonim i fjalës *kafshatë.* Kjo fjalë përdoret edhe me kuptimin *copa-copa*. *Ra, e u bë kaçajta. Kaç* vetëm njeriu.

►***k'llajsh / k'łajʃ / kllâjsh-i:*** *Këllirësh, i këllirët*, njeri i papastër. Thuhet për dikë që vishet keq, që nuk e mban veten. Emri *kllan/ë-a* lidhet me emrin këllirë dhe përdoret në ligjërimin gojor për të treguar dy persona që kanë probleme për të zgjidhë. *U zunë se kanë kllana të hershme* (kupto: probleme të hershme).

►***kam'z / kam'z / kám'z-a:*** *Këmbëz peri*. Përveç kuptimeve që jep Çabej, në të folmen vendore, *këmbëza e perit* dallon me *shkul penjësh*. Këmbëza e perit është shumë herë më e vogël se sa *shkulmi* i perit. Shkulmi mblidhet në dy mënyra: duke sjellë perin në pjesën e parakrahut nga pëllëmba e në bërryl, ose në mes të dy gjunjëve, ndërsa kamëza mblidhet duke pasë për kufi gishtin e vogël dhe të madhin të pëllëmbës. Shkulmi i perit shërben për të thurur trikon ose çorapin, ndërsa këmbëza e perit përbëhet nga penj me ngjyra që shërbenin për të bërë qendisur ojnat.

►***kajkatar' / kajk'atar' / kájk'atar'-i:*** *Këngëtar*, nga *kajkë*. *Thajrri teçe e agallarë / jeniçerë e spahillarë / sazexhi e kajkatarë*.

►***kajrre / kajrɛ / kájrr/e-ja:*** Tokë jopjellore, tokë e papunuar. Çabej e ka në formën *kër* dhe me prejardhje nga turq. *kir - fushë, dhe i papunuar*.

►***kajrr / kajr / kájrr:*** E njëjtë me *gërhet,* ndërsa emri *gërhimë* vjen në formën *kajrrëm. Dukej se ishte shume sëmurë se kishte kajrrëm në fyt. Kajrr*, bën *kërkër* me fyt, onomatope. Nga *kajrr* është formuar *kajrret, kërret, e njëjtë me gëret, gërhet*.

►***karthaj' / karθaj' / kárthâj'-a:*** *Karthi*. Përveç kuptimeve që jep Çabej, me këtë emër thirren edhe *shtizat* që shërbejnë për të thurur çorape apo triko leshi. Quhet *karthajë* edhe thupra që përdorë lodraxhiu për t'i rënë lodrës.

►***këk'lë / kək'lə / kèklè/j, -va:*** *Kokloj, lidhet me kokël, kokërr, veshkë. Qëlloj në kokël, shkokloj lë vdekur*: *O moj Çidhën moj karakolle / Hasmit zemrën ia këklëve.*

►***kuskun / kuskun / kúskun:*** Nga turq. *kuskun*, *kushun, qingël, nënbarkës e kafshës*; që *vjen nga turq. kushun.*

►***kërlik / kərlik / kërlik-u:*** Çabej e ka në formën *kërluk,* që vjen nga *të folët e Dibrës*. Kërraba e çobanit.

►***karpajt / karpajt / kárpajt:*** Jep shenja jete, po përmirësohet ngadalë: g*jyshja ka fillue me karpajt.*

►***kurt / kurt / kúrt-i:*** Çabej emërton *avllinë.* Në të folmen lokale, oborri, pjesa para shtëpisë. Fjalë e indoeurop.: sll. *grad* (kështjellë, qytet, vend i rrethuar); gjerm. *garten* (kopsht); it. *giardino*; në të gjitha rastet *vend i rrethuar*.

►***kalkuri / (kalkuri / kalkurí-a:*** E njëjtë me fjalën *rrozgë* që sjell Çabej, *kërcuj e cokla që sjell lumi.* Kërcunjtë e shkurret që sjell lumi quhen *kalkuri.* Jo rrallë herë përdoret edhe me kuptimin konotativ, për të treguar njerëz që kanë trup shumë të madh.

►***kamas / kamas / kámas:*** Ecje e veçantë e kuajve, ndërmjet vrapit dhe ecjes së zakonshme. Çabej sjell formën çapun*.*

►***kanet, më / (mə kanɛt) / (kânet, më):*** *Ma ka ënda*, këtu me kuptimin *më pëlqen të kryej një punë*.

►***katajk / katajk / katájk-u:*** Çdo lloj ushqimi që shtrohet për të shoqëruar bukën në drekë apo darkë.

L

► ligoc / ligɔʦ / lígoc: Njësoj si kilokos: mos e ligoc fëmijën.

► l'go / l'gɔ / l'gó-j: Ligoj, lëndim padashje i plagës së dikujt: iu l'gue plaga.

► llakuc / łakuʦ / llákuc-i: Dikush që nuk ngopet, që han shumë, llups.

► llahus / łahus / llahús: Gruaja lehonë për një periudhë të shkurtër pas lindjes, deri kur të mbushë ditët e veta, dyzetë ditë pas lindjes. Sipas besëtytnisë, fëmija-vajzë duhet të ndodhet tek prindërit e nënës, ndërsa djali i sapolindur deri sa të bëjë ditët (dyzetë ditë) nuk duhet të dalë nga shtëpia.

► l'voshk/ë-a / l'vɔʃkə: Kashta e kallirit të misrit. Lëvoshkat e misrit. Fig. u lëvoshk, kur dikush fërkohet duke u plagosur lehtë. Përdoret edhe dëlveshk.

► l'nor' / l'nɔr / l'nór: Kreh leshin me gërhanë (krehëra të posaçëm) dhe e përgatis për ta tjerrur. L'nor lesh, lesh i l'norun. Përdoret edhe për të treguar kur dy a më shumë veta zihen.

► lugjavajn' / luɟavajn' / (lúgjavajn'-a: Tokë e lugët, lugavinë.

► lefterajs / lɛftɛrajs / lefterájs: Nga greq. λευτεριά, liri, lirohem. Nusja u lefteros, lindi; plaka u lefteros, dha shpirt e vdiq.

► l'vajr / l'vaj'r / l'vájr-a: E lvajrme, e gërvishtur e lehtë. Fig., i lodhur shumë, që ka bërë shumë përpjekje për të kryer një punë: jemi l'vaj'r ka nji thmajkë t'i mbledhë arrat.

► lenue / lɛnuɛ / lênue, i: Që nuk është mirë nga mendja. Thuhet për dikë që ka shenja të turbullimit.

► lopardh' / lɔparθ' / lopárdh'-a: Një tufë barishtesh, një copë e madhe leckash ose llastiqesh, që ndizen natën dhe shërbejnë për të ndriçuar udhën, njëlloj me pishtar. Lopardhat e ditës së verës. Lopardhat e Shën Gjergjit. Zjarthe të vegjël si pishtarë që mbajnë fëmijët për të festuar.

►leskoviç / lɛskɔviʧ / léskoviç-i: Njeri i lëkundshëm: eh, ç'është nji leskoviç ai.

Në Vranjt, aty ku rrezaton drita e diturisë

(vijon nga faqja 8)

Vërtet është sa e lashtë aq edhe aktuale thënia filozofike ruse: "Njeriu më i lumtur në jetë është ai që kur kthen kokën pas nuk i skuqet fytyra nga e kaluara e tij".

Avdi Shehat Shehi, ka një mal me punë, një jetë me shpirtbardhësi e përkushtim në arsim, një jetë që rrezaton dituri, që rrezaton dritën e brezave. Jetë të gjatë e mirësi Avdi Shehi, veterani i mësuesisë dhe i drejtimit arsimor!



GJURMË QË FLASIN PËR SOT EDHE NESËR

Puna dhe shembulli i mirësisë dhe i diturisë i ngjan mineralit, kurrë nuk tretet as nuk vyshket, por rrezaton. Për Vranjtin e Kastriotit të Dibrës për mësuesit, nxënësit e njerëzit e mirë të kësaj treve flet shpirti, flet puna e përkushtuar, provat e diturisë e të besimit, nderimi e dashuria për traditat e vendlindjes e më gjerë. Janë 32% nxënës cilësorë, 3 nxënës ekselentë, 9 klasa kabinete, kënde e mjedis që dëshmon kulturë, vizion dhe dituri. Një konkurs model, Libri apo kompjuteri midis dy grupe nxënësit i drejtuar nga mësuesi i palodhur Mirian Tafa. Pyetje, argumente, debat, recitime etj. Gjithçka për t'u admiruar, gjithçka që flet e dëshmon sei ndrit pasioni, zelli për mësim e veprimtari. Drejtori i talentuar e masovik Indrit Shehi, i cili ka hobi vallet dhe aktrimin. Së bashku me shokët e shoqet e punës demonstrojnë nderin, reformim e përkushtim për mësimdhënien, veprimtaritë dhe mirëmbajtjen e mjedisit shkollor duke u përgjigjur kërkesave bashkëkohore.

Një kolektiv me prova e shëmbëllim për detyrat mësimore-edukative, me dritësim ndaj traditave e veprimtarive. Këtu flasin gjurmët e mjaft kuadrove, të cilët nëpër vite bënë epokë me shpirtin krijues për dituri, flet humanizmi i Musa Riçkut për pasurimin e bibliotekës model, të cilën e ka shndërruar në vatër diturie mësuesi shembullor Veli Xhediku. Një dhimbje e thellë na preku shpirtin sepse mësuam se ishte ndarë nga jeta, ish-drejtor i kësaj shkolle e mësues i dalluar i matematikës Ymer Xhediku. Ai sikur na thotë: Ecni përpara, jeta është e shkurtër, por kërkon dritë, djersë e gjurmë pune, për të dritësuar brezat. Koha dhe shembulli, fjala e vërtetë dhe vlerat rrezatojnë si drita, si dielli.

Dituria dhe sinqeriteti, kararet e dheut dhe traditat e komunitetit, zelli e nderimi për to e bëjnë shkollën vatër të dijes, vatër të kulturës. Vranjti e Limjani fshatra me shkollë 9-vjeçare të përbashkët, një komunitet me tradita diturie e besimi me prova, vëllazërimi dhe uniteti dëshmojnë sesi blerojnë vlerat në demokraci. Është madhështi dhe pasuria më e çmuar kur gjurmët flasin për sot edhe për nesër. Këtë e garantojnë provat e dijes, provat e punës e të vëllazërimit. Këtë trinom jete, këtë trinom hyjnor - dije, punë, vëllazërim - e gjen në Vranjt të Kastriotit ku rrezaton drita e diturisë.

Rruga e Arbërit nr. 164

kritikë

Shënime mbi përmbledhjen me tregime
“Kur këndonin gjelat e tretë” të Agron Tufës

Kur jetën ta prezanton ferri

Nga **NAMIR LAPARDHAJA**

Në traditën popullore, këndimi i gjelit të tretë, simbolikisht lidhet me ardhjen e agimit. Në tregimin, që ka shenjuar titullin e veprës, “Kur këndonin gjelat e tretë”, nuk kemi të bëjmë me ardhjen e mëngjesit, por me një simbolikë tjetër: gjelat e tretë këndojnë në kohën e gjumit më të thellë. Vrasjet dhe krimet bëhen pikërisht në këtë moment. Ndërkohë që të gjithë heshtin për të lënë diktaturën të lulëzojë, disa “gjela” këndojnë dhe kanë zë kundër saj. Është momenti kur rrëfimtari tregon se toga e pushkatimit ka ardhur në qeli për të marrë e për t’i çuar përpara ekzekutimit 12 të dënuar me vdekje. Janë 12 njerëz dhe atdhetarë të mirë, të shkolluar, të cilët s’kanë bërë kurrfarë krimi, që janë gjykuar dhe po ekzekutohen nga kriminelë të kualifikuar me një përvojë të gjatë antishqiptare. Është At Gjergj Suli ai që po rrëfen, i cili është nxjerr nga radha për t’u pushkatuar i fundit, me qëllim të bekimit të të gjithë të ekzekutuarëve, përpara se ata të zbresin të falur në botën e përtejme. Toga e pushkatimit nuk kursen asnjë, madje as priftin, i cili nuk mundet të lërë amanetet e fundit, se “po vdes i pastër para Zotit e popullit tim. Pa damkën e tradhëtisë...”. Plumbat janë më të shpejtë se amaneti. Ai i kosit të gjithë pa dallim, është mjeku ai që përkulet për të verifikuar vdekjen në mbarim të agonisë. Togeri i togës së ekzekutimit kap nga jaka e veladonit priftin dhe i thotë nën ngërdheshjen ironike: “S’kam asgjë personale me ty, At. Është thjesht çështje detyre... Mandej, duke mposhtur të qeshurën nën hundë, shton, pa hequr grykën e kobures nga tëmthat e mia: Ju e kuptoni, At i nderuar, dhe jam i sigurt, se do të luteni për mua... në botën tjetër!...”

Ky është një ndër 84 tregimet e shkurtra, të rrëfyera në vetën e parë, nga sytë e protagonistit, i cili herë është i gjallë, herë i vdekur, ndonjëherë i kallur në dhe pa varr, herë është fëmijë e herë i rritur, herë vajzë, grua, herë djalë, burrë. Kemi rrëfimtarin e kudondodhur, i cili lëviz me një shpejtësi të hatashme në një shumësi ngjarjesh dhe veprimesh. Këto tregime, të cilat, në dukje, nuk kanë asnjë fije të përbashkët, kanë unitet tematik, që mban të bashkuar logjikën e ngjarjeve dhe të rrëfimeve. Bashkekzistenca e shumë rrëfimeve krijojnë një ansambël polifonik, ku zërat e shumë subjekteve kompozicionalë pikëtakohen dhe jetojnë si një tërësi.

Tek “Testamentet e tradhëtuara”, Milan Kundera sjell në retrospektivë një bisedën e tij me Gabriel Garsia Markezin, i cili 20 vjet më parë i pat thënë se është Kafka ai që i kishte bërë të kuptojë se mund të shkruhet ndryshe. Që do të thotë të kapërcesh kufirin e gjërave të gjasshme. Një gjë e tillë jo duke u mërguar nga bota reale (në mënyrën e romantikëve), por duke e ngërthyer më së miri atë.

Është bash ajo që Tufa ka bërë në librin e tij: ka kapërcyer kufirin e perceptimit njerëzor të ndodhisë. Ai nuk e ka shpikur atë, por ka ndërtuar mbi realen një shumësi rrëfimesh. Nuk kemi një vepër biografike, por një dhembje kumbuese deri në palcë. Kemi variacionin autorial të ngjarjeve, duke i rikompozuar tërësisht ato, duke u futur në thellësinë e mendimeve, në vuajtjet e zemrës, në dhimbjet e shpirtit, edhe pse historitë e rrëfimeve janë marrë nga dëshmi konkrete.

Me këtë libër, Agron Tufa ka arritur që nëpërmjet narrativës së tij të sintetizojë fatkeqësinë e një populli të tërë. Vepra i ngjan një muzeu të vërtetë dhimbjesh njerëzore.



> Agron Tufa në këtë libër ka kapërcyer kufirin e perceptimit njerëzor të ndodhisë. Ai nuk e ka shpikur atë, por ka ndërtuar mbi realen një shumësi rrëfimesh. Nuk kemi një vepër biografike, por një dhembje kumbuese deri në palcë. Kemi variacionin autorial të ngjarjeve, duke i rikompozuar tërësisht ato, duke u futur në thellësinë e mendimeve, në vuajtjet e zemrës, në dhimbjet e shpirtit, edhe pse historitë e rrëfimeve janë marrë nga dëshmi konkrete.

Kemi një lloj letërsie të angazhuar, përsa i përket pikënisjes dhe qëllimit, ashtu siç e pranon vetë autori në shënimet përcjellëse për librin, ku, mes të tjerash, pohon se: “... Qëllimi im ka qenë t’u jap zë hijeve tragjike, të cilat mbushën skenat mortore përgjatë ritualit satanik të flisë në “meshat e zeza” që bënte diktatura komuniste me adeptët dhe xhelatët e saj të përzgjedhur...” Pavarësisht kësaj, ky angazhim mund të rrezikojë të cenojë krijimtarinë e Tufës përsa i përket lexuesit. Dihet që shoqëria jonë është thellësisht e polarizuar përsa i përket së shkuarës. Ky polarizim mund të dëmtojë veprën. Mirëpo, duket se një gjë e tillë nuk e frikëson autorin, moderniteti i krijimtarisë së të cilit kërkon lexuesin model të së ardhmes, i cili do të jetë gjakftohtë përsa i përket historisë dhe do të arrijë të receptojë veprën i lehtësuar nga barra ideologjike dhe konfliktuale e së shkuarës.

Tek këto rrëfime, Tufa ka arritur të na japë atë që Kundera e quan bukurinë e barbares. Vuajtja nuk është fshehur, tmerri është aty. Vetëm se është rrëfyer duke dëftuar artistikisht shëmtinë e saj. Kemi të përshkruar portrete fëmijësh që hidhen në pus e mbyten, vajza që vuajnë e vdesin nga uria, burra që ekzekutohen, gra që përdhunohen, njerëz që gjymtohen, sakatohen, ngelin shurdhë, të tjerë që jetojnë me “mallkimin fillestar” të ekzistencës njerëzore, gjithsesi, të pakuptueshëm dhe të pamotivueshëm, njerëz që lindin dhe vdesin, pa kurrfarë faji dhe përgjegjësie, nga të ngjashëm që portretizohen me të gjithë tiparet dhe karakteristikat e tyre. Të gjitha këto dëshmi, të gjithë këto momente,

> Historitë e kësaj vepre të ngelin gjatë në kujtesë. Është një libër që mund të lexohet shumë shpejt si vdekja, ashtu siç mund të lexohet shumë ngadalë si jeta. Çdo tregim është një rrëfim tek i cili mund të qëndrosh gjatë. Duket se gjithçka këto tregime e kanë me bollëk. Ky libër do t’i mbijetojnë kohës për shkak të mjeshtërisë rrëfyese, vërtetësisë së ngjarjeve dhe, mbi të gjitha, paanësisë së të treguarit. Ndofta duket si paradoks, por viktimat tregojnë për vetveten dhe për xhelatët e tyre me një paanësi të lakmueshme. Ndonëse janë në gjendje të pashpresë, në vuajtje ose të larguar nga kjo botë, ata thjesht rrëfejnë me një objektivitet të pashpjegueshëm. Është pikërisht ky parim, që vjen prej agut të letërsisë së madhe, ai që do ta mbajë në shinat e artit letrar.

histori dhe ngjarje, kanë një rëndësi të barabartë estetike.

Tregimet e këtij libri i ngjajnë prozës së shkurtër poetike. Në to ka figuracion të pasur letrar, ka ngjeshje rrëfimi, ka muzikalitet dhe ritëm, që harmonizohen në ngjarjet dhe historitë e rrëfyera. Poeti brenda Agronit nuk është shkëputur plotësisht, kurse shkrimtari Tufa na përcjell mesazhe të thella humane nëpërmjet prozës rrëfimtare.

Historitë e kësaj vepre të ngelin gjatë në kujtesë. Është një libër që mund të lexohet shumë shpejt si vdekja, ashtu siç mund të lexohet shumë ngadalë si jeta. Çdo tregim është një rrëfim tek i cili mund të qëndrosh gjatë. Duket se gjithçka këto tregime e kanë me bollëk. Ky libër do t’i mbijetojnë kohës për shkak të mjeshtërisë rrëfyese, vërtetësisë së ngjarjeve dhe, mbi të gjitha, paanësisë së të treguarit. Ndofta duket si paradoks, por viktimat tregojnë për vetveten dhe për xhelatët e tyre me një paanësi të lakmueshme. Ndonëse janë në gjendje të pashpresë, në vuajtje ose të larguar nga kjo botë, ata thjesht rrëfejnë me një objektivitet të pashpjegueshëm. Është pikërisht ky parim, që vjen prej agut të letërsisë së madhe, ai që do ta mbajë në shinat e artit letrar.

Në të ardhmen, kur historia e letërsisë shqipe të shkruhet, me siguri që studiuesit do të përmendin se përmbledhja me tregime “Kur këndonin gjelat e tretë” është vepra e fundit që Agron Tufa botoi përpara kërkimit azil politik në Zvicër. Arsyet e këtij veprimi mund të gjenden (edhe) mes tregimeve të këtij libri. Mirëpo, në atë kohë, ndofta, imagjinata nuk do të jetë e aftë t’i vijë në ndihmë kujtesës dhe të rindërtojë të shkuarën e largët. Ndaj kjo vepër do të marrë rëndësi, pikërisht për të mbajtur gjallë kujtesën, që lexuesit të mos vdesin pa e marrë vesh të kaluarën. Ose, ashtu siç thotë vetë Tufa në fund të librit, “...puna e dëshmisë me format e larmishme të saj, është rezistenca e vetme..., për të mos u njëjtësuar të gjithë me krimin e pandëshkuar”.

(Marrë nga FB i autorit)

cyan magenta yelloë black

receta gatimi

Revista prestigjioze Living-Al shkruan
për dibranen Elisabeta Skarra

Elisabeta Skarra: Ushqimin duhet të ta hajë syri e pastaj goja!



Revista e njohur Living boton një shkrim të shkruar nga Santana Çomora dhe disa receta të përgatitura nga Elisabeta Skarra.

Po kush është Elisabeta Skarra?

E lindur në Shumbat të Dibrës më 16 maj 1987. Një nxënëse e shkëlqyer në shkollën 8-vjeçare "Hasan Leka" në Shumbat. Pas ardhjes në Tiranë të familjes përfundoi shkollën 8-vjeçare "Ahmet Gashi" .

Edhe në gjimnazin "Ismail Qemali" u dallua si nxënëse e mirë, por veçanërisht ra në sy pasioni i saj për gatimin e për kuzhinën në përgjithësi. Nga viti 2005 jeton e punon në Gjeneva, Itali. Elisabeta Skarra është martuar me një shtetas italian Luca Talariko dhe ka një djalë 3 vjeç me emrin Noah.

MBRETËRESHA E ËMBËLSIRAVE

Elisabeta Skarra jeton prej pesëmbëdhjetë vjetësh në Xhenova. Ajo është nënë e përkushtuar e një djali trevjeçar dhe bashkëshorte e një burri italian, i cili e mbështet në çdo gjë. Edhe pse bën një jetë frenetike, është e lumtur, sepse bën punën që ka ëndërruar gjithmonë. Profesioni i saj ka lidhje me kuzhinën, por në kohën e lirë i përkushtohet pasionit të saj si blogere dhe *food photography,* që tashmë i janë shndërruar në punë të dytë. Kompani të ndryshme e kontaktojnë nëpërmjet faqes së saj në Instagram, duke i kërkuar receta që i botojnë në portalet e tyre, në kalendarë apo revista të ndryshme. Kuzhina është vendi i saj i preferuar, ku gjen frymëzimin për të eksperimentuar me receta të reja dhe që i largon çdo energji negative. Gatimi është terapia e saj më e mirë.

Ajo thotë se realizimi i fotove do kohën e vet: së pari, duhet të jetë vetëm në shtëpi dhe, së dyti, të ketë këndin e duhur për t'u dukur sa më bukur në fokusin e aparatit. Fotografia është një pasion tjetër i saj, që mbart një histori më vete dhe përcjell emocion. Është një art i cili kërkon përkushtim dhe përqendrim. Ajo ka bërë edhe disa kurse të specializuara për *food photography* dhe *food styling,* me qëllim që të realizojë foto sa më profesionale.

Për të arritur aty ku është sot, Elisabetës i është dashur të rritej para kohe, të përveshte mëngët e të kapërcente fazën e adoleshencës, që të bëhej më e përgjegjshme dhe më racionale. Megjithatë, këto barriera ranë shpejt, sepse arriti ta përvetësonte mjaft mirë gjuhën e një vendi që nuk ishte i saji, të zinte miqësi të reja e të integrohej në shoqërinë italiane. Eli, siç e thërrasin të gjithë, e ka pasur pasion gatimin që e vogël. Kur e ëma ishte në punë, ajo mundohej të sajonte receta të ndryshme për gjithë familjen. Pastaj, ajo është një vajzë dibrane dhe dibranët mbahen si amvisa mjaft të mira. Një nga ëmbëlsirat e saj të preferuara është bakllavaja e famshme, me të cilën e lidhin shumë kujtime, kur ndihmonte të ëmën me hapjen e petave.

Faqen në *Instagram* e ka hapur para pesë vitesh. fotot e saj të para kanë qenë ëmbëlsira dhe sidomos krostata, ku ka shpalosur fantazinë. Ajo e dallon Elin nga *food blogeret* e tjera janë detajet. Motoja e saj është: ushqimin duhet të ta hajë syri e pastaj goja. Tashmë, nga ndjekësit e saj, ajo njihet si "mbretëresha e pastiçerisë". Nuk ka bërë asnjë kurs kuzhine; të gjitha gatimet e saj janë fryt i fantazisë dhe përvojave të vendeve ku ka punuar më parë. ajo ka në plan që së shpejti të bëjë një kurs të përparuar mbi teknika të pastiçerisë.

Elisabeta është natyrë tepër kërkuese dhe mundohet të japë më të mirën në çdo gjë që bën, ashtu si edhe në recetat për revistën "Living" në këtë fundvit. Dëshiron të ketë një pastiçeri të vetën dhe shpreson që këtë ëndërr ta bëjë realitet sa më shpejt.

RECETA



Brauni me ananas

Përbërësit:
4 vezë, 270 gr sheqer integral
200 gr çokollatë e zezë
150 gr gjalp
150 miell 00
70 gr kakao
1 majë luge çaji me sodë buke
1 majë luge çaji me kripë
Ananas të freskët

Vendosni në zjarr një tenxhere me ujë dhe sipër një enë apo një tenxhere më të vogël për të shkrirë të gjithë përbërësit.

Së pari vendosni gjalpin të shkrijë, me pas sheqerin.

Bashkoni miellin, kakaon, sodën e bukës dhe kripën.

Ndërkohë, shtoni vezët një nga një, duke i përzier mirë me një rrahëse dore.

Dhe në fund, duhet të prisni çokollatën për ta shtuar me përbërësit e tjerë.

Kur çokollata të jetë shkrirë, vendoseni masën në një tepsi me përmasa 26x38.

E dekoroni sipër me feta ananasi dhe e keni gati për pjekje. E vendosni në furrën e parangrohur në 180° për 20/25 min.

Kek i aromatizuar me kafe



Përbërësit:
300 gr miell 00
220 gr sheqer
3 vezë, 120 ml vaj
16 gr fryrës ëmbëlsirash
200 ml kafe ekspres ose kafe turke të kulluar

Për përgatitjen e shurupit:
200 gr sheqer pluhur
40 ml kafe ekspres të ngrohtë.

Në një enë të madhe, me ndihmën e një mikseri elektrik, rrihni për disa minuta vezët me sheqerin derisa të dyfishohet masa.

Bashkoni vajin dhe me pas kafen e ftohtë të përgatitur më parë.

Në mikser vendosni miellin me fryrësin e ëmbëlsirave të situr më parë dhe përzieni mirë të gjithë përbërësit.

Shtojeni masën e përgatitur në një tepsi të lyer me gjalp dhe spërkatur me miell.

Piqeni kekun në furrën e parangrohur për 40 min në 175°.

Sapo të jetë ftohur keku mund ti hidhni shurupin e përgatitur me sheqer pluhur dhe qumësht.

Presidenti i Ansamblit, z.Muharrem Gjoka vlerëson çmimet dhe trofetë e fituara në disa konkurrime ndërkombëtare

Jehon kënga dhe vallja e Folk Alb "Hazis Ndreu"

Nga **HALIL RAMA**



Nën kujdesin e Presidentit të Republikës, z.Ilir Meta, Ansambli Folk Alb "Hazis Ndreu", së shpejti do të marrë pjesë në një eveniment të rëndësishëm tek arbëreshët e Italisë, në javën e kulturës arbëreshe.

Vetëm pak ditë para mbylljes së vitit të shkuar, Ansmabli Folk Alb Kamëz, me propozimin e Presidentit të tij, z.Muharrem Gjoka do të merrte emrin e Artistit të madh dibran Hazis Ndreu. Pa dyshim që me këtë emër, i rritet ndjeshëm kredibiliteti, jo vetëm brenda vendit por edhe në hapësirën mbarëshqiptare në botë. Jo rastësisht ky "pagëzim" do të bëhej në praninë e Prof.Dr.Bujar Kapexhiut, i mirënjohur për vlerat shumëdimensionale në fushën e artit e Kulturës.

Vlerat dhe madhështia e një personaliteti publik konsistojnë para së gjithash në marrëdhëniet me njerëz të moshave e profesioneve të ndryshme, nga më të vegjlit e deri tek më të moshuarit. Tek respekti dhe admirimi i tyre. Më së miri këto mishërohen në veprimtarinë e këtij artisti të mirënjohur, të cilit vitin e kaluar iu shtua edhe dekorata e lartë "Nderi i Kombit", akorduar nga Presidenti i Republikës Ilir Meta.

E kemi parë aktorin e shumë roleve në disa filma shqiptare, edhe si regjisor, edhe si moderator spektaklesh, edhe si skenarist, karikaturist, edhe në juri të ndryshme festivalesh dhe emisionesh radiotelevizive, por edhe si basketbollist ne rininë e tij të hershme. Të gjithë e njohin këtë personazh shumëdimensional. Por ajo që e dallon nga të tjerët është karakteri shumë popullor i Bujar Kapexhiut. Nëse në jurinë e spektaklit "Në kurthin e Piter Pan" të Tv Klan , Kapexhiu jep verdiktin e tij për fëmijën më të talentuar, këtë nuk nguron ta bëjë edhe për një shfaqje festive të Ansamblit Artistik "Folk Alb" të Kamzës, që para pak ditësh u pagëzua me emrin e "Artistit të Meritуar" Hazis Ndreu – "Mjeshtër i Madh", i cili nderohet e kujtohet si ikonë e artit dhe kulturës kombëtare.

Në nderim të kujtimit për mikun e tij të hershëm, i cili për dekada të tëra ka mrekulluar artdashësit tanë e ata të huaj (në festivalet ndërkombëtare në Moskë, Kajro, Stamboll e Prishtinë) me këngët, rapsoditë e kërcimet e tij, Prof.dr.Bujar Kapexhiu ka forcuar miqësinë me ata që po trashëgojnë vlerat e një artisti e shkrimtari që e futi Historinë e Dibrës në shina të sigurta për të ecur me dinjitet në fushën e madhe të Historisë sonë Kombëtare. Ndaj nuk është rastësi që në përgatitjet dhe konkurrimet brenda e jashtë vendit të Ansamblit Folk Alb "Hazis Ndreu", të themeluar e drejtuar nga i biri i tij, koreografi i talentuar Avni Ndreu dhe mbesa, Earta Ndreu, të jetë i pranishëm edhe Bujar Kapexhiu. Autori i librit "Burri i odës dibrane", njëherësh skenarist dhe regjisor i spektaklit me të njëjtin titull në 90-vjetorin e lindjes së Hazis Ndreut, prej vitesh ndjek nga afër edhe veprimtarinë e Ansamblit Folk Alb të bashkisë Kamëz. Ndjen krenari për sukseset e këtij ansambli, që vitin e kaluar u nderua me çmime të para në Festivalin "Kënga dhe vallja na bashkoi" në Plavë dhe Guci; në Festivalin Folk-Fest në Shkup, në Festivalin "Kënga jehon" në Strugë, në Festivalin Ana-Drinit, Rahovec si dhe në Festivalin Ndërkombëtar të Fëmijëve në Stamboll. Po ashtu mori pjesë dhe u vlerësua shkëlqyër në Fest-Folk në Buzgan, Rumani. Pas këtyre suksesеve ata performuan me nivel të lartë artistik në takimin festiv me rastin e Vitin të Ri 2020 në Pallatin e Kulturës Kamëz. Ndaj dhe duke shfaqur krenari të rrallë, Kapexhiu veçoi vlerat e rralla që mbart programi i këtij ansambli, buqetën me këngë e valle të interpretuara mjeshtërisht prej artistëve amatorë, nga mosha parashkollore deri maturantë të shkëlqyer. Këto vlera do të evidentoheshin më së miri nga Presidenti i këtij Ansambli, z.Muharrem Gjoka. Vetëm para një muaj, në 70-vjetorin e Ansamblit "Kuvendi", Zall Dardhë, Muharremi do të spikaste si kryesori në vallen epike të burrave të kësaj krahine, i karakterizuar nga forca, burrëria, trimëria, karakteri luftarak, madhështia etj.

Pasi vlerëson repertorin e Ansamblit Folk Alb "Hazis Ndreu", Presidenti Gjoka thotë se brenda elementit kombëtar, vallet e këtij ansambli kanë mjaft veçori krahinore. Si një ekspert shumëvlerësh ai pohon se veçantia e valleve vërehet në motivet, formacionin dhe trajtën. Në këtë aspekt ai vlerësoi vallen me motive të Jugut të kërcyer aq mjeshtërisht nga grupi i fëmijëve të vegjël, vallen me motive të Matit, si dhe ato me motive arbëreshe e nga Tropoja, të luajtura me virtuozitet nga grupi prej më se 30 kërcimtarësh, djem e vajza të rritura, ku veçon si më të mirët: kompozitorin Xhelil Imeraj, administratoren Earta Ndreu, asistent koreografen Erida Statana, njëherësh valltare dhe këngëtare shumë e talentuar si dhe këngëtarin Zaim Tollja. Mbresëlënës qe edhe një zë i veçantë i vokalit shqiptar, tenori Dardan Pepkolaj, i cili ka kënduar në dhjetëra skena, por dhe në stadium kur kombëtarja jonë ka zbritur në fushë. Valltarët e këtij ansambli sollën para publikut, në mënyrë origjinale një dasëm tiranase si dhe vallen tropojane nën ritmet e këngës "Kuq e zi". Muharrem Gjoka që i ka mbështetur me shumë dashuri të gjitha aktivitetet e këtij ansambli, njeri human dhe me zëmër të madhe, por dhe veteran i folklorit, me modesti falënderon dhe kontributorët tjerë në këtë ansambël, bashkinë Kamëz e veçanërisht nënkryetarin, avokat Hasan Bara si dhe gazetarin e mirënjohur sportiv, njëherësh moderator i dhjetëra veprimtarive, spektakleve e promovimeve, Defrim Methasani..

Siç u bë e ditur në këtë takim festiv, Ansambli Folk Alb "Hazis Ndreu", së shpejti do të marrë pjesë në një eveniment të rëndësishëm tek arbëreshët e Italisë, nën kujdesin e Presidentit të Republikës, në javën e kulturës arbëreshe.

Botim i ri: HAZIS NDREU - Personaliteti, krijimtaria - nga Xhafer Martini



Hazis Ndreu - Personaliteti, krijimtaria
Xhafer Martini
Botimet M&B, 2019
ISBN 978-9928-307-09-5
Faqe 128 / Çmimi: 800 lekë

Haziz Ndreu ka pasur një fëmijëri të vështirë, më të vështirë se bashkëmoshatarët e vet, se të paktën ata, edhe nëse hiqnin e vuanin, ishin në shtëpitë e tyre. Si thonë vargjet e asaj këngës:

"Dhe në vuaj le të vuaj,
Veç të mos jem në dhé të huaj"

Hazizi në dhe të huaj nuk ishte, por ishte në derë të huaj, në një moshë fare të re, kur fëmijët qajnë për hiçgjë, janë kërkestarë e shamatorë dhe ua thajnë lotët nënat. E ëma ia kapi dorën e vogël djalit shtatëvjeçar dhe, ndërsa ecte për ta çuar te shtëpia ku ishte pajtuar, zemra i qante, por i mbante lotët prej vogëlushit. Kur atë e la në dorë të të tjerëve, kur kishte kthyer shpinën dhe ishte larguar disi nga vendi ku u nda me të birin, qau me lot të nxehtë, me "ah" e me"oh", sikur i biri t'i kishte vdekur. Hazizi, aty ku jetonte, i thonin "hizmeqar". Vetë emri të vriste edhe nëse dera ku punonte dhe jetonte mund ta trajtonte si djalin e saj. Ky largim nga shtëpia në atë moshë e bëri Hazizin të vuajë e të dëshpërohet, por edhe të vendosur për të bërë çdo përpjekje, por të mos qëndruar nën këmbët e të tjerëve. Hazizi qysh në atë moshë kishte kuptuar atë që Niçe e ka thënë kur ishte filozof i njohur: "Kërkohet liri derisa nuk kemi forcë. Sapo ajo arrihet, kërkohet sundim; nëse nuk arrihet - kur jemi akoma të dobët për këtë - atëherë kërkohet drejtësi, domethënë fuqi e barabartë. Nuk ke ç`të zgjedhësh: ose lart, ose poshtë si vemje i tallur, i shkelur, i asgjësuar." Hazizi e kishte zemrën të mbushur me urrejtje ndaj të keqes. Nuk e dinte ku është ajo dhe kush e prodhon, nuk ishte në atë moshë për të kuptuar pse disa njerëz i ndjek e keqja, kurse, disa të tjerë, përkundrazi, rehatia dhe kënaqësia. Nuk donte të ishte në anën e të keqes, në asnjë mënyrë. Por ai e kuptonte se në atë anë ishte. Fëmijët e tjerë të asaj moshe shkonin në shkollë, kurse ai rendte mbas bagëtisë në mal. Ishte një padrejtësi e madhe që i bëhej një djali të vogël. Hazizi kurrë nuk bëri shkollë të rregullt dhe ne nuk dimë nëse ai do të ishte nxënës i shkëlqyer, mesatar apo si shumë prej tyre. Por kjo nuk ka shumë rëndësi. Madje, fare mirë që disa të dhëna biografike për Hazizin nuk i fillojmë si për shumë të tjerë, kur i bëjmë nxënës të shkëlqyer dhe pa qenë të tillë, kur i bëjmë të urtë dhe të dashur, të respektuar me mësuesit, shokët, me të moshuarit e të tilla pa fund. Hazizi ka mësuar të shkruajë dhe të lexojë si autodidakt, megjithëse, më vonë, ka marrë edhe dëftesën e Liceut Artistik. Kishte një shkrim të rregullt dhe të lexueshëm. Nuk neglizhonte në të shkruar: përherë njësoj. Ishte respekti për shkollën që ai nuk pati mundësi ta ndiqte si moshatarët. Te Hazizi vepronte si tek rrallë njerëz, teoria e kompensimit: Zoti i kishte mohuar ato që ua kishte dhënë të gjithëve, por nuk e kishte nxjerrë nga sytë: për të do të kujdesej si për të rrallët, do ta pajiste me talent dhe dhunti për shumë fusha. Një fjalë e urtë thotë: "Kur të do Zoti, nuk ke nevojë për të tjerët". Megjithatë, Hazizin e kanë dashur edhe të tjerët. Kjo është meritë e tij. Secili shtron pyetjet: Kur Hazizi pa shkollë ose me pak shkollë, edhe atë me "të vjedhur", shfaqi aq prirje dhe aq talente, si do të bëhej ai po të jetonte dhe të mësonte në kushte shumë të mira? Atë që nuk ka ndodhur, ne nuk e dimë, por, për mendimin tim, si këngëtar, valltar i "*Kërcimit dyshe*", historian i lashtësisë dhe mbledhës e përhapës i alegorisë nuk kishte si të bëhej më i mirë. Këto janë katër shtyllat e personalitetit të tij dituror, që mbajnë dhe i japin përpjetë edhe personalitetit njerëzor.

cyan magenta yelloë black

studim

Kadareja në esenë e tij nuk mund të rrinte pa paraqitur kostumet shqiptare, dasmën shqiptare nën prizmin intelegjent dhe artistik të konceptimit të tij të veçantë ku absurdja dhe logjikja rrinë kaq pranë e pranë sa shpesh alternohen me njera-tjetrën.

"Kushëriri i engjëjve"

Nga **XHAFER MARTINI**



(vijon nga numri i kaluar)

Vigjilencën më të mprehtë ajo e kishte vetë, nuk kishte më dyshimtare se diktatura.

Këto që ne i themi tani, Kadareja i ka thënë tek "Kushëriri i engjëjve". Kadare thotë se diktatura ishte e prirur për valle festive. Në atë sistem u ngritën shumë ansamble të këngëve dhe valleve popullore. Manifestimet sportive dhe veprimtaria e këtyre ansambleve e "zbukuronin" jetën e popullit dhe shtonin atmosferën festive. Diktatura donte të luftonte zymtësinë. Ajo vetë ishte e zymtë, e zezë. Donte ta ndryshojë ngjyrën, veshjen, vallëzimin që të dukej ndryshe nga ç'ishte. Po si do t'ia dilte mbanë kësaj pune që ishte mjaft e vështirë? Si do të arrinte ajo të gënjente, të mashtronte, madje, ajo më kryesorja, ku do t'i gjente ata njerëz që do ta bënin këtë punë, se, pa dyshim, duhet të ishin të zgjuar, se budallanjtë nuk e bënin dot. Kadareja thotë se diktatura është mbështetur gjithmonë tek konformistët. Ajo është shtresa që i duhet asaj dhe që i ka shërbyer më shumë.

Përveç konformistëve, thotë Kadarea, kishte edhe antikonformistë. Këta luftonin njeri-tjetrin si dy rryma krejt të kundërta. Edhe jokonformistët kishin armët e veta. Vallja, si të thuash, nuk ishte arma e tyre se vallet në shumicën dërrmuese të rasteve kontrolloheshin dhe nuk lejoheshin ato që nuk ishin të përshtashme për regjimin. Por jokonfomistët kishin edhe rrugë dhe mënyra të tjera për t'iu kundërvënë konformistëve, gjegjësisht diktaturës që ata përfaqësonin. Për shemull, një prej tyre ishte moda. Një tjetër ishte muzika. Një tjetër ishte piktura, skulptura, letërisa, krejt arti. Por, nëse për artin kishte komisione e nënkomisione, redaksi e shumë organizma për ta kontrollur, moda nuk kishte ndonjë organ të veçantë. Ajo ruhej nga syri vigjilnet. T'i mbaje flokët pak më të gjata se zakonisht, të merrej si oponencë ndaj sistemit. Pak ta kishe fustanin të hapur tek gjoksi, ose mbi gjunjë, i bëje opozitë sistemit. Kishte edhe mjaft shfaqje të tjera në jetë që të nxirrnin në opozitë me sistemin. Fjala opozitë nuk njihej dhe nuk përdorej se konsiderohej diçka e organizuar, puç, kundërrevolucion. Opozitarëve një herë u ishte prerë koka që më 46-tën dhe tani nuk guxonte kush të dilte me platforma. Këta që luftoheshin - jokonformistët - jo vetëm ishin të paktë, por edhe të paorganizuar, këta luftonin më vete. Diktatura nuk ishte budallaqe. Ajo duke vepruar kështu luftonte intelektualët. Intelektualë konformistë nuk ka. Të gjithë intelektualët duhet të jenë jokonformistë. Pra, duke luftuar antikonformizmin, diktatura në të vërtetë luftonte intelektualët. Një shkrimtar që merret me politikë ka thënë: "Dallimi midis shtetit të një vendi demokratik dhe atij të një vend nën totalitarizëm , është se ky i dyti e konsideron si diversion politik çdo lloj antikonformizmi" (Besnik Mustafaj: Fletorja rezervat. Prishtinë 1996, f. 108)

Byroistët nuk kishin karakteristik dinamizmin, por ngathtësinë. "Karaktersitikë e parë e lëvizjeve të tyre është një farë ngathtësie solemne, shoqëruar me një shprehje të ngrirë në fytyrë, e cila është midis buzëqeshjes dhe vërenjtes, dhe bën të njejtin efekt në të dy rastet...lëvizjet e komunistëve janë kryesisht të ngadalta. Ky ritëm i ngrirë vjen, me sa duket, nga lindja aziatike..."(Kadare: Vepra : 2009: 24) Mund të vijë edhe nga bota e egër. Dinozaurët kanë qenë kafshë të egra të tmerrshme, por të ngadalta. Po të ishin edhe të shpejta, sidomos po të ishin fluturuese, e kishin shkatërruar çdo gjë. Por ajo ngathtësi i la në baltë: ata u shkatërruan vetë.

Vallja ishte e lejuar kur ishte pozitive, kur kishte në brendësi të saj elementë festivë, kurse të vallëzuarit modern ishte krejtësisht i ndaluar. Meqë shumica e këtyre modeleve na vinin nga Kina dhe sigurisht edhe nga vendet e tjera aziaike, ishte e rrezikshme të përqafoje elementë të modernitetit. "Më 1967, Kina shkoi më larg: bashkë me vallëzimin klasik në skenë, ndaloi krejtësisht vallëzimin e njerëzve. Akoma më larg shkoi Kamboxhia. Të rinjtë që mund të gjendeshin duke vallëzuar, pushkatoheshin. ...Më 1972, goditja e infarktit që pësoi diktatori, pa së cilës një kohë të gjatë ai lëvizte duke u mbështetur mbi një shkop, përveç valës së re të terrorit, i dha një goditje fatale valles. Ishte hera e parë që Komiteti i Partisë i Tiranës u bëri thirrje komunistëve që të mos vallëzohej edhe nëpër shtëpi, përveç rasteve të dasmave...Për të mbushur boshin që krijohet nga dëbimi i valles, diktatura shton festat festive: festivalet kombëtare, manifestimet sportivo- artistike, gjithëfarë olimpiadësh të fëmijëve, të rinjve, të grave, të veteranëve, të ushtarakëve". (Kadare: Vepra: 2009: 241).

***

Kadare ka shumë sukses në veprat e tij, sidomos në esetë, edhe për faktin se ka një prozë demokratike. Dikush mund të thotë ç'na prralis kështu, se të thuash për shkrimtarin se është demokrat, hadje de, por të thuash për prozën e tij që është demokratike, këtë nuk e kemi dëgjuar. Nuk ka ndonjë rrymë letare apo drejtim letrar që të quhet "demokratik". Nga ana tjetër, demokraci do të thotë pushteti i të gjithëve, dhe i mediokrëve. Kadare ç'është e vërteta kuptohet nga pak njerëz, nuk është "kulturë masive" për masat "shumëmilionëshe".

Megjithatë, mos nguti, o lexuesit e mi, se të urtit nuk nguten. Unë me demokraci kuptoj mendimin kundër, të drejtën e mendimit kundër. Nuk di nëse kjo lloj demokracie kështu si e kuptoj unë, është a -ja e demokracisë, apo Zh-ja, por që është koncept demokratik kjo nuk ka dyshim. Kadare, parë në këtë aspekt, pothuaj çdo frazë e ka demokratike dhe kjo është një cilësi e tjetër e tij. Frazat e tij përshkohen nga të kundërta, janë shprehje e të kundërtave. Po japim një shembull, nga moria e shembujve të kësaj natyre: "Popujt kërcenin kudo e kurdo dhe, ndonëse kishte mendime të ndryshme se në ç'kohë *gjunjët e tyre ndienin padurimin për valle* e në ç'kohë *plogështoheshin*, një gjë është e sigurt: vallja ashtu si jeta s'rreshtte kurrë. Disa mendonin se në prag luftërash, domethënë zhvendosjesh të mëdha, popujt nisnin të kërcenin më shumë e më ethshëm, e të tjerë mendonin të kundrëtën, domethënë, që në prag fatkeqësish, këmbët mpiheshin nga reuamatizma. (Kadare: Vepra 2009: 246) Ose: "Kur Tebës i afrohej lajmësi, që do të sillte gjëmën për krimin e Edipit, thuhej se vallja nuk reshtte ditë e natë. Të tjerë kronistë e poetë rrëfenin se si në vigjilje dramash e tërmetesh, dëshira për valle fashitej....Kurse puçistët në Bashkimin Sovjetik, në gusht të vitit 1991, e shoqëruan shpalljen e puçit me një koncert të pamabrimtë në TV, ku shumicën e vendit e zinin vallja dhe baleti klasik". (Kadare: Vepra 2009: 247)

Fjalitë që nënvizuam dëshmojnë këtë që sapo thamë, mendimin kundër brendapërbrenda një faze. Por kjo mënyrë të shprehur, sipas meje, jo vetëm e demokratizon frazën, por është edhe një hapësirë lirie, nuk i mbyll alternativat nuk ngulmon në një formë të menduari, nuk vendos veton vetëm në një gjë duke përjashtuar të gjitha të tjerat. Këtë mënyrë shprehjeje lexuesi e pëlqen jo vetëm për sa thamë, por edhe për faktin se kjo përjashton monotoninë, është krejt reflekse dhe alternativa. Kundër, kundër, kundër – kjo është demokracia. Duhet të vemë në dukje se Kadare është I vetmi autor në gjuhën shqipe që përdor mirë dhe u jep funksionalitet të ashtuquajturave "konvergjencave paralele". Kjo figurë retorike ka lidhje me aftësinë për të afruar gjëra që jo vetëm nuk lidhen, por edhe kundërshtojnë njeri-tjetrin. Si shembull, japin fjalët "dobësi e fortë", "shpresë e dëshpëruar", "dhunë e ëmbël", "kuptim pa domethënie" e të tjera. (Umberto Eco: "Pape Satan Aleppe- kronika e një shoqërie të lëngshme, "Dituria" 2017: 415) Po Kadareja nuk jep vetëm konvergjencë fjalësh, por edhe konvergjencë kuptimesh, nocionesh, shembëlltyrash, idesh. Si shembull, ai kur flet për vallen, pastaj papritur, shkon tek një vallzim I madh, planetar, që shihet tek rrotullimi I globit rreth vetes, yjet rreth diellit, diejte pafund në harmoni me njeri-tjetrin. Kështu kalimesh janë të pafundme në veprën e Kadaresë. Mosbindja dhe kontradksioni mbrohen dhe shpallen nga artistët më të mëdhenj në botë. Ja çfarë ka shkruar Uollt Uitman:

"Kundërshtoni shumë, binduni pak
Se bindja e verbër të shpie në skllavëri të plotë.
Prej skllavërisë së plotë asnjë populi I botës
Nuk e fiton dot përsëri larine". (Gazeta "Republika", 3 korrik 1997)

Çdo vepër e Kadaresë jo vetëm është kundër diktaturës, por është kundër të keqes në përgjithësi. Por e keqja luftohet kur nuk e pranon atë. Veç të mos ketë bindje- kjo në esencë është demokracia.

Veç të tjerave, Kadare dallohet për mënyrën e përsosur se si i thotë gjërat. Thuaj sa të duash gjëra të drejta, ata nuk ngjisin nëse nuk thuhen në mënyrën më të mirë të mundshme. Gabriel Garcia Marques, kur flet për artin thotë se ai nuk ka as fillim e as fund: të ngjit ose nuk të ngjit. Kjo me të vërtet është cilësi e artit. Nuk ka art të mirë dhe art të keq. Arti ose është art ose joart. Arti, natyrisht duke pasur këtu parasysh në radhë të parë letërsinë, sidomos eseistikën, sidomos eseistikën si të Kadaresë, ka brënda magjepsjen edhe për faktin se nga çdo radhë e tij mëson. Brenda një faqje, madje brenda një pasazhi ai të jep të dhëna ose, më saktë, të jep një informacion dituror që bëhet pjesë e kulturs tënde. Të gjithë veprat e Kadaresë, përveç specifikave të veçanta dhe mesazheve që përcjellin, janë vepra kulture, janë ekrciklopedi artistike, të mësojnë e të emancipojnë njëkohësisht, të kalojnë në anën e progresit. Vetëm në pak radhe Kadare tregon për Edipin e Tebës, për Gjrin Persik duke të sjellë ndërmend luftën e përgjkashme që u bë atje, për puçin e sovjetikëve, për vazot ilire që kishin të vizatuar një valle, për zanafillën e teatrit tragjik e të tjera. Paralelizmat Kadareja I ka të pafund, por të larmishëm në mënyrën e shprehjes. Sa meson prej paralelizmave nuk meson nga asgjë tjetër. Dykuptimsinë çka ne e konsideruam si mjet demokratik dhe si shprehje e demoracisëj, ai e shtjellon më tej duke ngritur në një parim filozofik. Vallja ka trajtë rrethore, thotë Kadareja. Këtë nuk ka njeri që nuk e di. Por mendja e askujt nuk shkon më tej për të zbuluar ndonjë domethënie për këtë trajtë rrethore. Kadare na e shpjegon se kjo trajtë rrethore, "përsërit një nga simbolet më të lashta dhe më universalë të njerëzimit: rrethi, domethënë simbolin e diellit, si dhe lëvizjen e tij në kupën qiellore. (Kadare:Vepra: 2009: 248) Trajtë rrethore ka edhe Zoti, thotë Jose Luis Borges. "Zoti ka trajtë të rrumbullakët, sipas tij, "është një sferë që mund të rroket veç prej intekeltit, qendra e së cilës është gjithkund dhe perimetri askurrkund" . (Jose Luis Borges: "Inkuzicionet e tjera": Tiranë 2005: 10) Po vallja kishte edhe një karakteristikë tjetër: rrotullimin nga e majta në të djathtë, për këtë arsye "vallja i ngjate një mekanizmi që mund të punonte në dy kahje: të mirë dhe të keqe. Ajo të kujtonte kështu orën e mirë dhe orën e ligë, kthimin e papritur të fatit, së fundi, kahjen e rrjdhjes së kohës, këtë enigmë që ka munduar dhe vazhdon të mundojë ç'prej mijëra vjetësh mendjen njerëzore". (Kadare: Vepra: 2009: 48)

Në këtë libër bëhet fjalë për një baletmaestër dhe për vallen. Por Kadareja nuk shpjegon si baletmaestër, madje ai as që shpjegon, ai filozofon rreth valles. Por një filozofi e mirëfilltë rreth valles sigurisht do të ishte gjë e merëzitshme. Kjo është një filozofi me art, me aq shumë dyzime, me aq shumë të kundërta, me aq shumë kapërcime në kohë dhe në hapësirë, sa ti si lexues, ddukesh aq shumë I rrethuar nga dituria, se "nuk ke shteg për dalje", të paktën për disa kohë. Veprat e mëdha të "robërojnë", ata të mbajnë për vete për shumë kohë.Në një kuptim, të dehin, një dehje që vjen nga bukuria.

Të gjithë e dimë se ka valle burarsh, valle garsh dhe valle të përziera, siç ka edhe valle pleqsh. Kjo e fundit është valle dyshe burrash, por kur këtë valle e kërcejnë burra shumë të moshuar, ka një dallim nga vallja e zakonshme. Në shpjegimet e një baletamestri, koreografi e të tjerë, qofshin këto edhe njerëzit më të dalluar të fushës, nuk do të gjenim ndonjë gjë interesante, sepse ata flasin profesionalisht për disa elemente, për veshjen kostumet, mënyrat e lëvizjeve e të tjera. Këto kanë një bojkot në krijimet e Kadaresë. Jo se ai i nënvlerëson etnografët, porse ai shikon përtej tyre, shkikon ndryshe nga ata. Për të vallja e burrave ishte e lidhur me tokën, kjo lidhje me tokën do të thotë lidhje me vdekjen sepse burrat me të vërtetë ishin të lidhur me tokën, por toka shpesh ua sillte vdekjen. Në kanunet shqiptare vetëm po të vriteshe për tokën, do të thoshte se nuk të kishte shkuar gjakuhuptë. Me pak fjalë, quhej vrasje me vend, vrasje e bukur. Kjo mendësi, sipas Kadaresë, (dhe ai ka shumë të drejtë), ka kaluar edhe tek vallja e burrave. "Vallet e burrave kishin një ritëm të përmbajtur, me goditje të shpeshta të tokës me këmbë dhe me përsëritje të mundishme, thua se vallëtarët e kryenin ritin përmes një pengese të rëndë. Asnjë valle burrash shqiptarë s'mund të përfytyrohej pa goditjen e tokës.". (Kadare: Vepra. 2009: 248) Shqiptari betohej: "Për këtë tokë", "Më vraftë plisi i kësaj toke" "Për këtë dhe". Beja për tokën bëhej me njëzet e katër vetë. Ishte beja më e rëndë.

"Kurse në vallet grarishte, ndërsa mungonte prania e tokës, theksohej lëkundja e shamisë, pra, ana qiellore e valles. (Pra, theksohej e lehta, fluidja, e pakapshmja, ose e kapshmja me shumë mundime, pse jo, edhe pabesia). Edhe fjalët që e shoqëronin ishin fare të ndryshme nga ato të ritit burrëror. Ato flisnin më shumë për largësinë, për ndarjen, për mallin. (Kadare: Vepra: 2009: 249). Kurse në vallen dyshe të pleqve vallëzuesit u ngjanin dy kërcunjve të vjetër që zhvendoseshin gjithë mund, mu në buzë të vdekjes". (Kadare:Vepra:2009: 250).

Kadare flet edhe për një vallen Bodrumçe. Këtë valle në shkollën pedagogjike të Peshkopisë, në mbrëmjet e vallëzimit, që pothuaj bëheshin çdo javë, e kërcenin burrat, domethën shkollarët e rinj, në krye të të cilëve printe një kuksian, Nezir Visha, që kërcente aq bukur, jo vetëm me këmbët, por me gjithë trupin, me mimikën, me atë shpalosje burrërie sigurisht në momente të vështira të jetës ku etja për lavdi dhe dëshira për t'u sakrifikuar përziheshin bashkë. Kur mbaronte kjo valle, vallëtarët ndiheshin të lodhur, por këtë lodhje e ndienim edhe ne që nuk kishim kërcyer. Nderim dhe mirënjohja e të gjithëve kalonte tek Neziri. Neziri për këtë valle kishte fituar një status të veçantë. Kur Neziri mbaroi shkollën, vallen e tij nuk e kërceu më askush.

***

Kadareja në esenë e tij nuk mund të rrinte pa paraqitur kostumet shqiptare, dasmën shqiptare nën prizmin intelegjent dhe artistik të konceptimit të tij të veçantë ku absurdja dhe logjikja rrinë kaq pranë e pranë sa shpesh alternohen me njera-tjetrën. Këto ai i jep nëpërmjet balerinit të ri të ardhur nga Franca i cili çuditet sapo shkel në truallin shqiptar, qoftë ky edhe jashtë kufijve shtetëror, si në Ulqin. Kadare di ta organizojë mendimin. Nuk është as dialog, as monolog, as rrëfim linear i mërzitshëm. Kjo mënyrë të treguari është shumë sugjestionuese, e freskët dhe mbresëlënëse. Kadare shkruan: "Balerini i ri, i ardhur nga Franca, hetonte i mahnitur veshjet e burrave dhe të grave, që më shumë se për në jetë, dukej se ishin ishin qepur për në skenë": (Kadare:Vepra: 2009: 252) Të huajt (balerini kishte lindur dhe ishte rritur në Francë, pavarësisht se kishte gjak shqiptar) e vështrojnë me kërshëri shqiptarin, u duket i veçantë, pak teatral siç thotë Konica për të, me lëvizje të prera dhe të guximshme, por pa karagjozllëk. Shqiptari edhe veshjen e ka skenike. Përshkrimi i Kadaresë për veshjen është e pamundur ta komentosh, por edhe mëkat ta bësh një gjë të tillë. Etnografë që janë marrë një jetë me veshjet popullore dhe i kanë përshkruar ato, kostumin e plot të burrave, kostumine plotë të grave, madje edhe lementë të veçantë të tyre, të venë në gjumë me përshkrimet që bëjnë. Janë skrupulozë në përshkrime dhe në paraqitjen edhe të stolive përkatëse, por janë të mërzitshëm, pa fantazi, shih e shkruaj, pa forcë përfytyruese . Etnografët kostumin e shikojnë të varur në kremastar, ose në stendat e muzeut. Te Kadare fryn si fllad mendimi. Ai e shikon kostumin bashkë me njeriun, të veshur prej tij, madje të veshur jo nga një njeri dosido, por që të jetë përkryerja e racës shqiptare. Këtë nuk e them për të mburrur Kadarenë sepse ai nuk ka fare nevojë për një gjë të tillë.Këtë ma imponon përshkrimi që ai i bën kostumit të burrave dhe të grave, përshkrim plot dinamizëm, sugjenstionues. E bën disi me ngut sa të krijohet ideja se kostumi po ikën, po fluturon. Më kujtohet në fëmijrinë time të hershme kur në Ditën e Verës, që festohej aq shumë, një nga drejtimet që merrte festa ishte edhe parada e modës. Nuk kam asnjë ekzagjerim në këtë që them. Visheshin me kosutme nusërie dhe kostume dhëndërie e nusërie vajzat dhe djemtë më të bukur, me trupat si llastarë. Këto ishin kostumet e vërteta plot stoli dhe ornamente, pastaj me kostume popullore vishesh të gjithë të rinjtë dhe të rejat. Por dy, dhëndëri dhe nusja, ishin të zgjedhur.

(vijon në numrin e ardhshëm)

profil

Ramadan Perhati, *heroi i gjallë e njeriu i urtë*

Nga **QAZIM PREJSI**

Ramadan Hazis Perhati është bir Qafëmurras, i Katër Grykëve të Dibrës. Ai lindi më 20 janar 1930 nga një familje me tradita te lashta patriotike dhe Atdhedashëse. Shkollën fillore e filloi në Katundin e vjetër. Ende pa mbaruar klasën e pestë, në moshën 13 vjeçare u arratis nga krahina dhe mbas disa peripecive u rreshtua vullnetarisht në radhët e ushtrisë partizane në trojet e Jugosllavisë "Vishnje Grad". Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të luftës, Ramadani kthehet në atdhe me 15 maj të vitit 1945 në Tiranë për të vazhduar mësimet e mëtejshme në shkollën Ushtarake "Skënderbej". Ai mbasi mbaroi klasën e pestë, tre vitet e Unikës dhe dy vjet e gjysmë të shkollës së Mesme me nota e sjellje shembullore për arsye shëndetësore transferohet nga shteti me bursë në konviktin e shkollës "28 Nëntori" në Shkodër. Në këtë gjimnaz përfundoi shkollën e mesme me nota të shkëlqyera dhe Drejtoria e shkollës i transferoi dokumentet e tij Ministrisë së Arsimit për t'i dhënë mundësi që të vazhdonte arsimin e lart jashtë vendit. Ramadani është dërguar për t'u shkolluar në vitin akademik 1950-1951 në Bashkimin Sovjetik, në Moskë duke u regjistruar në Institutin e naftës me emrin e akademikut IM Gupkin. Në përfundim të studimeve pesë vjeçare në këtë Institut me nota shumë të mira në provime, mbrojti diplomën para komisionit shtetëror. Kishte për temë "Masat teknike e organizative për rritjen e shpejtësisë komerciale për Trustin e shpimeve në Baku të Republikës së Azerbajxhanit". Mbrojtja e Diplomës me nota "Shkëlqyeshëm" "Otliçno" u shoqëruan me distinktivin e argjendtë, lëshuar nga Ministria e Arsimit të Lartë të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike. Me t'u kthyer në Atdhe, Ramadani me Diplomën e Inxhinierit të Minierave, por me specialitetin inxhinier për shpimin e puseve të naftës



dhe gazit u caktua të punonte në Tiranë, në Komitetin Shtetëror të Gjeologjisë. Mbas katër muaj pune ai transferohet të punonte në ndërmarrjet e shpimeve të puseve në Patos. Në naftë Ramadani ka punuar 34 vjet e katër muaj. Gjatë këtyre viteve ka kryer detyra të ndryshme si: Kryeinxhinier e Drejtor ndërmarrje, Kryeinxhinier i përgjithshëm për naftë dhe gaz. Me organizimin e ri në naftë në Fier caktohet Kryeinxhinier dhe më pas Drejtor i Drejtorive të Ndërmarrjeve të shpimeve të naftës. Gjatë këtyre viteve ai ka punuar shumë për kapërcimin e ndërlikimeve gjeologjike për vendburimet e ndryshme të naftës duke vënë në jetë metoda dhe variante kohore, si kusht për zbulimin me rendimente të larta të vendburimeve me veti strukturore të ndryshme. Ramadani gjatë këtyre viteve shquhet edhe për vënien në jetë të metodave e varianteve vetjake e origjinale, të pashkruara në literaturën kohore. Ndër to po përmendim: Shpimin e brimës së shtrembër në kushte të rënda gjeologjike, përdorimin e "Thundrës fluturuese" për çimentimin e kolonave metalike, për trungjet e puseve me prerje karbonatike të

Ramadan Hazis Perhati i Qafë Murrës është nderuar nga Bashkia e Dibrës me titullin "Qytetar Nderi" me motivacionin: Për kontribut të shquar si inxhinier, kryeinxhinier i drejtorisë së Përgjithshme të kërkimeve të naftës dhe Drejtor i Drejtorive të Shpimeve të Naftës, i metodave të reja e bashkëkohore në kantiere.

zbuluara, përdorimin e "Urave artificiale" për mënjanimin e trungjeve të puseve të formacioneve të buta, të mesme e shumë të forta, kriko hidraulike nëntokësore për zhbllokimin e instrumenteve të bllokuara gjatë shpimit, përdorimi i kokës rrotulluese "Perhati" për rritjen e cilësisë së çimentimeve të puseve për shfrytëzimin e gazeve me trysni të lartë. Të tilla metoda kanë ndikuar në rritjen cilësore të metodave të shpimeve në vendin tonë dhe më gjerë.

Për këto aktivitete Ramadani është dekoruar me medalje dhe urdhra pune nga organet shtetërore dhe vendore. Përveç dëshmisë si veteran lufte dhe tre medaljeve përkatëse, veç tjerave është dekoruar me Urdhrin e Punës "Për merita të shquara në miniera dhe gjeologji" dhe atë "Për kontribute të shquara për zbulimin e vendburimeve të reja të naftës". Është fitues i tre konkurseve kombëtare për industrinë e naftës. Ndër to ka marrë çmimin e parë për shuarjen e flakëve të fontanave të naftës dhe gazit me lëndë eksplozive (tritol).

Ramadan Perhati përveç punës drejtuese në ndërmarrjet e shpimeve ka një aktivitet 58 vjeçar në fushën e teknikës dhe shkencës. Ai ka botuar me dhjetëra e dhjetëra artikuj shkencor në revista e buletine shkencore, ka botuar monografi si "Zjarret dhe fontanat", "Një jetë për arin e zi", "Unë kamikazi dhe ministri" etj. Ndër botimet e Ramadanit ai konsideron si kryevepër artikullin e botuar në revistën "Familja" me titull "Zemra e nënës ti Dan je". Krahas këtyre aktiviteteve ai ka mbrojtur dhe udhëhequr shumë Diplomatë të USH Tiranë. Ka mbajtur disa referate dhe kumtesa në seminare kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka qenë delegat i naftës në kongresin e 20 Botëror të gjeologjisë, etj. Për të gjitha këto aktivitete në vitin 1972 ka marrë titullin "Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor" dhe në vitin 1995 ka marrë titullin "Drejtues Kërkimesh". Ramadani ka dalë në pension më 20 janar të vitit 1990 dhe ende vazhdon të mendojë dhe të shkruajë për naftë. Gjatë gjithë këtyre viteve dhe para viteve 1990 e deri në ditët tona kanë shkruar shumë artikuj kolegë dhe të profesioneve të ndryshme, për kontributet që ai i ka dhënë naftës.

Në vitin 1982 Këshilli Bashkiak i Patosit i festoi bashkë me Bashkinë e Shkodrës 82 vjetorin e lindjes së tij duke i dhënë titullin "Personalitet i Shquar për rajonin e naftës Patos ndër vite". Ndërsa Këshilli Bashkiak i Dibrës me vendimin përkatës të datës 30.04.2019 i ka akorduar Ramadan Perhatit titullin "Qytetar Nderi i Dibrës" me këtë motivacion: Për kontribut të shquar si inxhinier, kryeinxhinier i drejtorisë së Përgjithshme të kërkimeve të naftës dhe Drejtor i Drejtorive të Shpimeve të Naftës, i metodave të reja e bashkëkohore në kantiere.

Inxhinier Ahmet Çollaku nga Boston (Amerikë) më 13 mars 2019 shkruan një artikull të gjatë në gazetën "Telegraf" me titull Ramadan Perhati Shkencëtari i Harruar. Ai e përfundon artikullin me shprehjen "Shqiptarë kur kaloni nëpër Shkodër, ju lutem takoni heroin e gjallë dhe njeriun e urtë Ramadan Perhatin".

Ja pra ky është Ramadan Perhati, bir i Qafëmurrës.

SKICË NGA SELMAN MËZIU

Ushtimat e një mentari

Nuk kemi ditur shumë. Ngjarjet përqark nesh kanë qenë të shumta. Kuptohet të gjymtuara në kohëra e hapësira. Trualli u përgjërua. Murrane të ftohta u përplasën egërsueshëm. Ato ngrinë e thanë gjithçka. Por nga grimcat biologjike të tokës një bimëz mbiu. Nga thellësia ajo mori forca energji për të përshëndetur diellin. E gegnisht e emnuan beri. Po, ai që han delet. Thuhet në shumës edhe berishte, barishte. Në një luginë të rrëpirt ku dushku murgullon. Kurse dielli pasi përshëndet Runjën, rrezet ndriçuese jetëdhuruese i lëshonte mbi Gjerdhin e Epër. Pikërisht këtu kishin kullat, trojet fisi i Berishëve.

Gjëmoi historia. Në pak rreshta. Por, me plot kuptim e harqe ylberike heroizmi. Gjeneralët e kastriotit famëmadh të shekullit të pesëmbëdhjetë. Rini mbushur me shkulme heroizmi, trimërie e Nikoll dhe Dhimitër Berisha. Dhimitri u flijua për atdheun arbnor. Me dhimbje rrënqethëse. Me torturat fizike e shpirtërore dëshpruese, therëse, tretëse si tlyeni i shkrimun në ftere. Nga vetë Sulltani i madh me çakejt përbri. Ai mbeti një ndër tetë shtatoret në historin kastriotiane. Por mjerisht vetëm në disa rreshta. I mbuluar nga myku erë qelbur të paditurisë, i cmirave, i padrejtësive, i shpifjeve plangëprishëse. Nikolla la trashgimtarët e tij, plotë shkëlqim e rrezatime margaritarësh.

Njëri prej tyre do të belbëzonte fjalën nanë e baba në qerthullin e viteve tridhjetëtë të shekullit njëzet (15.XI.1929). Xhemali vogëlush leckosur, bark bosh do të shkollohej, në shkollën fillore të Thanxës. Rrafshnalt me rreze pamje mahnitëse të Muhurrit buzë dy lumenjëve. Me lapsa e fletë pa forma e vizime. Por me zell e etje për dituri. Pinjolli i Berishëve do të ngrinte herë pas here dorën, për t'iu përgjigjur mësuesit. Në abetare, këndim, aritmetik me gjuhën brisk. Ashtu i zhdërvjell, ai kalonte dy klasë në një vit. I pakët nga trupi, me kryet e vockël me flokë të zinj, me sy që i shkëlqenin, Xhemali u gjend në shkollën normale të Elbasanit. Me makina rasti në karroceri shkonte e vinte rrallë herë. Me një valixhe prej dërrasash dushku. Veshmbathje prej shajaku mbante. Me çorape të thurura nga nana me shtiza prej dega thane ose lajthie. Portreti i tij në ato kohë skamje rrënqethëse. Duke shitur pak misër e fasule për të blerë, has të bardhë, për kmisha e të tjera veshmbathje. Me pantallona e setren prej qeshne të bardh, të prera sipas trupit heshtak. Me shpirt ndër dhamb. Me ushqime kryesisht, blektoral, kopshtiesh, pemësh, arash e natyre ushqehesh. Në kup prej bote e lugë druni hante. Por kujtesa e vullneti për të mesuar nuk i mungnin. Mbijetesën djaloshi i shkathët e i zgjuar muhurrak e kuptonte



Xhemal Berisha

vetëm e vetëm duke mësuar.

Gjysma e shekullit të njëzetë e gjeti, përgjegjës të shtëpisë së kulturës Peshkopi. Pa lëshuar brisk në faqe. I pajisur me dijet e një mësuesi. I aftë të përçonte ato në trurin njomzak të vogëlushëve. Por rinia e tij ishte e plleshme. Me synime të guximshme. Fillon akademinë ushtarake. Shkëlqen në përvetësimin e shkencave të artit ushtarak. Edhe njëherë shpërthejnë energjitë e Xhemalit. Historia. Kjo karabina e një populli. Qytezat antike. Kalatë. Vendbanimet e stërlashta. Kishat e moçme në maja malesh e kodrash. Toponimet me rranjëza pellazgo ilire. Duheshin bamun të njohura. Lexuar. Gërmuar në thellesi. Nxjerrë në dritën e së vërtetës. Mjeshtrinë mijëvjeçare të shkuar.

(Vijon në faqen 23)

cyan magenta yelloë black

shënime

Mbresa nga takimi me veteranin e shëndetësisë,
96-vjeçarin Imer Pira

Gjithmonë *më është dukur se* punës i kam mbetur borxh

Nga **KAMBER FARUKU**

Është një ditë janari me diell, por e ftohtë. Aliu përpara, unë pas tij, futemi në lagjen "Allias" në Tiranë, aty ku janë një grumbull pallatesh me tulla të bardha silikate. Jam nisur të takoj babain e Aliut, 96-vjeçarin Imer Pira. Siç më kishin thënë, më del përpara po ai burri i dikurshëm në Peshkopi, me trupin drejt si qiri, me një pritje të përmallshme.

-Kisha qejf të të pres në shtëpi, jo në kafe. Është edhe pak ftohtë. . .

-U mbake mirë,-i them duke u marrë n'grykë.

-Mosha e bën të vetën, e bën. Por dhe ti qenke plakur. . . Eu!

-Mosha nuk mban me hatër asnjë,-i them dhe ulemi pranë e pranë. I dal në anën e majtë, sepse vërej një aparat dëgjimi në veshin e tij.

Po mbush shekullin Imer Pira dhe, kur bisedon me të, të duket sikur je futur e po shfleton në një arkiv të gjallë. Kur përballesh me kujtesën e tij të kthjellët për ato kohë, e ndjen veten me fat që takon njerëz si Imer Pira.

U lind në Vajmëdhej, në një shtëpi dykatëshe pranë Drinit. Në Muhurr fisi i Pirajve tradicionalisht quhej Konaku i Poshtëm. Pajtonte gjaqe e ndante Kanun. Si fis kishte edhe një vlerësim tjetër: Pushkatar-Pira.

Drini, pyjet në Griçan e Rrenz, lojërat, bagëtia, përrallat e frikshme me shpëtimtarë, me dasma, me hasëm e miq bashkë. Kjo ishte skena ku rritej një fëmijë në ato kohëra në Vajmëdhej.

Gjithmonë atje, e varur në mur apo në sup dhe e ngulitur në mendjen e në zemrën e një djali, ishte pushka. Imeri, si çdo fëmijë tjetër, sikur përkëdhelej e rritej me të. Përkundej fantazia luftarake sa në betejat për mbrojtjen nga serbët e tmerrshëm, aq te marrja e hakut e mbrojtja prej hasmit. Dëgjonte nëpër oda për luftën kundër turqve osmanë në betejat kundër pashallarëve me historitë e Gjip dhe Abaz Pirës, por dhe për Dalip Pirën me trima të tjerë kundër serbëve më 1913.

Dhe rasti fatlum për të pasur një pushkë erdhi. Vrapoi në shtator 1943 dhe mori armë e fishekë në kazermat e ushtrisë së kapitulluar italiane. Fitimtar, i doli nënës përpara i armatosur.

-Kam pushkë, nënë, pa shihe! - i thotë Imeri.

- Po, mor bir, po. Ta dish se, sa të ngushtë e ka grikën, aq e ka edhe fatin pushka, - i thotë nëna.

Kjo fjalë i mbeti peng. Kur, në gusht 1944 u mobilizua partizan në brigadën e 4-t, djaloshi Imer Pira kishte pushkën e vet. I kujtohej fjala e nënës dhe shihte pushkën te gryka e hollë. "Jo, - thoshte me vete, tani fati çelet i madh. Nuk po vras hasmin në fshat, por po çliroj vendin. Gryka



Shefqet Domi, Imer Pira (në mes) dhe Sabri Haliti në Beograd me studime, 1948.

e pushkës më duket shumë e gjerë, shumë!"

Nga fundi i vitit 1944 vargu i partizanëve kaloi në Kosovë.

- Do të çlirojmë vëllezërit tanë kosovarë nga pushtuesi nazifashist! - u tha komanda.

Shqiptarët e Kosovës i pritën si bijtë e tyre. Po vinin ushtarë shqiptarë. Para tyre, bashkë me italianët e gjermanët pushtues kishin ardhur mësues nga normalja e Elbasanit, nëpunës në prefektura, xhandarë. Kishin ardhur edhe mjekë nga Shqipnia. Aq më mirë që po vinin edhe ushtarë. Shkolla shqip, nëpunës shqiptarë, gjuha shqipe në vend të asaj serbe, fund genocidit dhe raprezaljeve, varrosje e doktrinës së Cubriloviçit për shfarosjen e shqiptarëve në Kosovë. Pushtuesit italianë dhe gjermanë kishin përzënë pushtuesit gjakatarë shekullorë serbë.

- Do ju shpëtojmë nga pushtimi gjerman dhe tradhtarët! - thuhej para kosovarëve në tubime.

- Kur erdhën italianët dhe gjermanët ne u çliruam nga serbët, tani po çlirohemi nga këta. Kush do vijë pastaj? - pyeti një kosovar para të gjithëve në sheshin e fshatit.



Me bashkëshorten, Hasijen.

- Arrestojeni tradhëtarin! - uluriti vllau nga Shqipnia... Një ëndërr e keqe. Mbase do kalonte. Ishte çlirimi më i çuditshëm, një liri apokaliptike, që po e përjetonte Kosova.

Jeta merr një drejtim krejt të ri dhe kjo i ndodhi Imer Pirës në Shkodër në 1945-sën. I graduar nënoficer, partizanin e ri e thirrën një ditë në komandë:

- Do të bësh një kurs 1-vjeçar për infermier në Tiranë në spitalin ushtarak.

- Të mendohem, - thotë Imeri.

"Shkova e pyeta dy bashkëfshatarë të mi, që i kisha në repart, Bafte Likën dhe Ahmet Limanin, kujton Imeri. - Kështu, kështu, si t'ja bëj, - i pyeta. - Shih, atje në ushtrinë italiane, ku kemi qenë, sanitar ishte punë e mirë. Pranoje, - më thanë. Dhe unë pranova. Ishim gjashtë vet në kurs nga reparti, tre dibranë e tre kuksianë. Mësonim dhe punonim. Spitali ushtarak në atë kohë ngjante me një spital në zonën e luftës. Për sigurinë e tij u krijua edhe një batalion me komandant Dan Kaloshin. U bëra infermier. Jeta ime mori drejtim tjetër, nuk u ktheva më në brigadë. "

Më 1 qershor 1946, i veshur partizan, Imer Pira gjendet në fshatin e tij Muhurr. Krahas armës, në sup mbante dhe çantën e infermierit me ilaçe. Kishte filluar ndërtimi i rrugës së rinisë Kukës-Peshkopi dhe ai u ngarkua me detyrën e përgjegjësit të shëndetësisë për zonën B, segmenti nga ura e Muhurrit në urën e Dodës në Draj Reç.

Ushtoi kënga:

Në gazetë "Bashkimi", ka dalë lajm i ri,
Do ta ndërtojm' rrugën, Kukës-Peshkopi!

Vullnetarët kulmonin pushkët me një roje aty pranë punës dhe, me brohorima e vrull rinor, punonin me shumë dëshirë për jetën e re. Çdo pëllëmbë e rrugës u mbush me një gjallëri të paparë. Ato zona të mbyllura sikur morën jetë. Lindi shpresa. I përkushtuar, me palodhje, infermieri i ri nuk ndalej ditën e natën nëpër dhjetëra kantieret e rrugës. Puna kishte edhe plagët e veta të shumta, ata duheshin mjekuar. Ra edhe dëshmori i parë, një djalë i ri nga Tepelena, Kalo Asllani, të cilin e zuri një ledh dheu në Zall Sinë. Pranë tij, të përlotur vullnetarë e fshatarë të zonës, komandanti dhe përgjegjësi i shëndetësisë. Sinja derdhi lot si për birin e vet. Dy vjet më parë, më 26 gusht 1944, Sinja ishte përgjakur nga partizanë të divizionit të pestë, të cilët masakruan zonën e Çidhnës në emër të çlirimit. Partizania e vrarë lart në fshat, Nimete Progonati, dhe vullnetari i ndërtimit poshtë në Zall, Kalo Asllani, përballeshin me njeri-tjetrin kaq afër dhe kaq larg në kohë. . .

Rruga e Rinisë Kukës-Peshkopi mbaroi brenda gjashtë muajve dhe Imer Pira u rikthye kryeinfermier në spitalin ushtarak në Tiranë. Vrull, shpresë dhe shërbim. As që bëhej fjalë për orar pune.

Në shtator 1947 kryeinfermierin e spitalit ushtarak e thirrin në komandë.

- Je caktuar të studiosh për mjekësi në Beograd, - i thonë.

- Të kisha pyetur njëherë, nëna... - belbëzoi Imeri.

- Nuk ka kohë. Do nisesh, populli ka nevojë...

Bashkë me Sabri Halitin nga Zerqani dhe Ismail Fetën nga Zagradi nisin studimet në Beograd të Jugosllavisë. Pas një viti, në shtator të vitit 1948, kthehen nga Beogradi për të mos e parë më atë vend. Titoja ishte shpallur revizionist.

- Eh, hasmi i vjetër nuk bëhet mik i ri. Është fjalë e vjetër, - dëgjonte Imeri bisedat në oda në Vajmëdhej. Kështu kishte ndodhur dhe me rastin e tij. Edhe me Kosovën.

- Do të shkosh në Bashkimin Sovjetik, - e thirri përsëri komanda.

- A mund të mendohem komandant?

- Po, mendoju. . .

Mori leje dhe u gjend pranë familjes në Vajmëdhej.

- Mor bir, gjithë këto vite u humbe, do humbesh krejt tashti, nuk e di..., - merakosej nëna e vjetër.

U kthye Imeri në Tirane dhe, drejt e te komanda:

- Nuk dua të shkoj, u tha, kam halle familjare.

- Mendoju.

- Jam menduar, nuk kam kushte...

- Na gjej një tjetër si ti, - i thotë komandanti, pasi e pa se nuk çahej me të.

- E kam menduar, Ismail Feta.

Kaq mjaftoi dhe miku i tij Ismail Feta shkoi në BS dhe u bë mjek kirurg i famshëm në spitalin ushtarak. Imeri kujton: "U pendova më vonë që nuk shkova për studime në Bashkimin Sovjetik dhe kjo më ngeli peng. Megjithatë, bëra mirë, sepse nuk e di në se do isha bërë mjek aq i zoti sa i ndjeri Ismail Feta."

Mendja i punonte Imerit të kthehej pranë familjes në Dibër. Deshte të ndajë vuajtjet dhe shqetësimet me bashkëfshatarët e vet. Kjo ishte ëndërr, ambicie, krenari. Kështu ishte gatuar në sofrën shekullore patriarkale. Vendosi të shkojë drejt e tek drejtori ushtarak Ismail Dervishi. Vetëm ai e kishte në dorë tranferimin.

"Zyrat ishin te Pallati i Duçes, siç i thoshin atëherë, Korpusi i Universitetit sot, - kujton Imeri. Rrija para derës dhe këmbët nuk më mbanin. Kisha frikë se nuk do të pranohej kërkesa ime.

- Urdhëro, pse ke ardhur?- më pyeti Ismaili, pa e ngritur kryet nga disa shkresa. Më kujtohet si sot.

- Po, ja, kam kërkesë të më transferoni në Dibër...

- Në Dibër?! Partia ka nevojë për ty këtu.

- Dua të shërbej në vendin tim...

- Ore Imer, je në vete ti? Njerëzit duan të vijnë në Tiranë, ti don të largohesh prej këtu!

- Kam nënën atje, kam vëllain...

-Merre nënën këtu... Ik, mendoju njëherë, pastaj bisedojmë.

Dola me mendimin e prerë për tu larguar nga Tirana dhe ushtria. Dhe ashtu bëra.

Pranvera i vitit 1949 e gjeti infermierin Imer Pira në Dibër. Hapi ambulancën e parë në Muhurr te Kulla e Kuqe. Kjo kullë më ngjyrë të kuqe, e ndërtuar nga italianët në qendër të Muhurrit, kishte shërbyer si ndërtesë e postkomandës para çlirimit. Postkomandant ishte Xhek Kupa nga Mati.

- A din të shkruash, or Xhek, - e pyesnin muhurrakët.



Ahmet Kamberi, Imer Pira (në mes) dhe Asllan Koltraka.

- Kup e bëj, Xhek s'un e bëj, - përgjigjej postkomandanti.

Pas lufte aty u vendosën forcat e ndjekjes, të sigurimit. Thirreshin e torturoheshin "armiqtë" e klasës. Deri aty sa operativi kriminel Ahmet Rrapi nga Vlora, në zyrën e tij në katin e dytë të kullës, vret fshatarin Demir Lusha nga fshati Arras.

Me ardhjen e Imer Pirës kjo kullë sikur u bë më paqësore. U hap shitorja, gjendja civile. Njerëzit hynin e dilnin për mjekime, biri i tyre u shërbente ditën e natën me aq dëshirë e përkushtim. Kalonte nga fshatrat poshtë, në malësi dhe binte te shtëpia e vet në Vajmëdhenj. Te NANA. Ta kishte pranë, kjo e kishte munduar. E ndjente veten i plotësuar kur ishte mes njerëzve të tij.

Koha të ndryshon, ajo të jep dorën të ecësh përpara. Pasi mbaroi shkollën e mesme mjekësore në Peshkopi, Imer Pira mori vlerësimin si ndihmësmjek.

Përvoja e jetës, dashuria për njerëzit dhe profesionin, vetitë organizative ishin cilësi të një kuadri, i cili në fillim të viteve 60-të mori drejtimin e seksionit të shëndetësisë. Zgjerimi i rrjetit të shërbimit ambulator, ngritja cilësisht e mjekimit dhe shërbimit në spitale, përgatitja e mjekëve, ndihmësmjekëve dhe infermierëve për të ardhmen, ishin një sfidë disavjeçare e shef Imerit, të cilës i doli zot. Përvoja e mjekëve Hysni Rusi apo Elona Toptani ishin një shembull i gjallë frymëzues në Dibër. Dhe Imeri pati kënaqësinë dhe nderin, siç shprehet, të punonte me mjekë të mëvonshëm të shquar si Mark Mirashi, Ahmet Alliu, Irfan Jashari, Ahmet Kamberi, Xhavit Miftari dhe shumë e shumë të tjerë, breza të artë për ruajtjen e pasurisë më të madhe të njeriut, SHËNDETIT.

Ky njeri, që mban mbi shpatulla rreth një shekull jetë, është dëshmitar i gjallë i atij transformimi që ndodhi me shëndetësinë, nga një spital i vogël te Lagja e Vjetër, te spitali i vjetër dhe pastaj spitali "Rrahim Xhika" sot.

Çdo njeri ka edhe anën e tij vetjake, familjare.

- Nuk kisha shtëpi, u dha leje në atë kohë, kush të mundej, të ndërtonte vetë shtëpinë, se shteti nuk kishte mundësi. Me nxitjen e shokëve dhe miqve, vendosa. Nisa një shtëpi të re në qytetin e Peshkopisë me katër dhoma. Kur po punonim në themele, më vjen miku im Staf Miftari nga Shupenza.

- Çfarë po bën o Imer? - ma priti me të parën.

- Shtëpi të re, e sheh. Thuaj njëherë puna e mbarë.

- Ehe! - ia bëri Stafa.

-Pse, or mik?

- Do marrohesh! Ti ke shëtitur dynjanë. Do tokë dera dhe nuk ke për ta hapur, do mërzitesh,-tha Staf Miftari.

- Nuk do turpërohem or Staf. Nuk do t'i zë rrugën askujt për ta sjellë te shtëpia, por, kur të bjerë dera, ajo do të hapet. Dhe nuk u marrova, e prita mikun dhe hallexhiun, sepse e dija se kë kisha në krah, -dhe i rreh shpatullat bashkëshortes, Hasijes, e cila po dëgjon me mjaft vëmendje pranë tij.

Dhe shtëpia e Imer Pirës vërtet që mbeti një derë e hapur, u përcollën prej aty të njoftun e të panjoftun. U prit me bujari miku dhe nevojtari bashkë, por edhe u këshillua dhe u çua aty ku duhej në spital apo ambulancë, apo u nis me një rekomandim për Tiranë me letër miqësore nga Imer Pira për Ismail Fetën apo Ahmet Kamberin.

... Dikur, kur ishte djalë i ri, Imer Pira me këmbëngulje la Tiranën për Dibrën. Perspektivën e jetës e kërkoi mes njerëzve të thjeshtë. Atje ndjeu t'i rrahë zemra për një jetë më të mirë për njerëzit e varfër, halleshumët e kësaj bote. Në pleqërinë e thellë u kthye në Tiranë. Përkundet në kujtimet e një jete të gjallë në luftën për jetën.

- E deshe këtë kthim në Tiranë? - e pyes.

Qesh.

- I erdha prapa djalit, Aliut. Ky ka emrin e babës. Letën dhe Agimin i kam në Nju Jork. I shoh në kompjuter, vijnë e na shohin. Larg. Si të jenë mirë fëmijët, jemi mirë dhe ne pleqtë, eh.

- Babi nuk e ka lënë punën,- më thotë Aliu. - Ulet dhe shfleton kujtimet, ka një studim për zonën e Muhurrit, fiset, prejardhjen, toponiminë.

- Po bëj një shekull, - thotë Imer Pira. - Kam kaluar shumë vështirësi, nuk kam njohur lodhje. Përsëri, një gjë nuk më del nga mendja: Më duket sikur njerëzve u kam ngelur borxh për punën.

Rruga e Arbërit nr. 164

bisedë

Fatmir Terziu vazhdon të gërryej në bunarin e tij të jetës duke nxjerrë prej andej ujin e pastër me të cilin selit fjalën, vargun.

Fatmir Terziu mes dibranëve...

Është hera e parë që sot takohem me Fatmir Terziun, që i jap dorën dhe i marr buzëqeshjen që i del nga shpirti, por nuk është hera e parë që e lexoj dhe ngrohem me fjalën e tij në rreshta e në vargje.

Për herë të parë ia kam lexuar shpirtin në gazetën lokale "Ushtima e maleve" kur ai shkruante për mësuesit dhe banorët e Ostrenit të Dibrës.

Nuk do ta kisha njohur në qoftë se nuk do të kishte qenë mes nesh mërgimi, "fjala e lirë", aq e dëshiruar në rini e aq "pranë e larg" në pleqëri.

Fatmir Terziu ishte njëndër qindra mësuesit që i erdhën Dibrës nga e gjithë Shqipëria kur ajo kish më shumë se kurrë



nevojë për njerëz të ditur që do ti jepnin dije e kulturë brezit të ri të saj në shkollat e mesme hapur në skajet më të largëta të mbi 1500 kilometrave katrorë të saj, nga Stebleva në Kala të Dodës, Reç. Lurë, Selishtë...

Ishte pjesë e atij brezi që siç më shkruante mësuesi im Gavril Kote nga Përmeti dhe mësuesja ime nga Berati NigjareVelçani, mësues në Brezhdan të Peshkopisë në vitin 1951...

GAVRIL KOTE: *"Unë tash kam hyrë në vitin e 6-të të pensionit, por nuk mund të harroj mikpritjen e atij populli dibran, respektin dhe dashurinë që ata treguan për ne arsimtarët jabanxhinj. Shumë kujtime të pashlyera më janë fiksuar nga gjithë familjet e Brezhdanit. Mikpritja, bujaria, thjeshtësia, komunikimi reciprok na e lehtësonte detyrën tonë të vështirë por humane... Puna e mësuesit i del para sysh gjithsecilit. Është e vetmja rrugë që e kalon gjithkush, është pjesa më e bukur e gjithsecilit..."*

NIGJARE VELÇANI: *"Lexova me vëmendje shkrimin tuaj me titull " Mësuesit – më të përkushtuarit dhe të harruarit", botuar në gazetën " Zëri i Populli " të datës 20 qershor 1993. Të them të drejtën ky shkrim më preku thellë në zemër mbasi më ktheu në kujtimet e 44 vjetëve më parë, në moshën time më të re. Akoma pa mbushur 16 vjeç, pas një kursi metodik pedagogjik, lash Beratin dhe erdha në Peshkopi, fillimisht në fshatin Brezhdan, i cili më ka lënë mbresa të paharruara në kujtesë dhe pastaj në kufi, në fshatin malor të Cerjanit ku e ndjeva veten në shtëpinë time. Pra për herë të parë hyra në jetë, në punë si arsimtare për tu dhënë njohuritë e para të gjuhës sonë të bukur shqipe vocërrakëve aq të etur për dije.."*

Ata, dhe shumë mësues të tjerë të atyre viteve që ditën u mësonin shkronjat e abetares fëmijëve dhe natën, nën dritën e pishës dhe kandilit, ua mësonin ato prindërve do të pasoheshin nga mësues të brezit të Fatmir Terziut, tash në një stad të ri dijesh e kulture.

Tek shfletoja koleksionet e "Ushtimës së maleve" në kërkim të jetës sime 55-vjeçare faqeve të shtypit (1957....2020), midis firmave të shumta që përbëjnë vlerën e pazëvendësueshme të saj, takova edhe Fatmir Terziun, emër tash i njohur nga ana ime në letërkëmbimet në adresat tona elektronike.

Ashtu si edhe shkrimi im i parë në faqet e gazetës "Sporti popullor" më 8 maj 1957 e shkrimet e tjera në "Zëri i Rinisë" në shkollë të mesme dhe në shkollë të lartë, shkrimet e Fatmir Terziut në "Ushtima e maleve" përbëjnë vlerë të madhe njohëse, vlerë në kohë e hapësirë, hapa të parë modestë faqeve të shtypit, faqeve të librave.

Do t'i citoj ashtu si janë shkruar, me thjeshtësinë dhe dashurinë gjer në amshim...

I pari daton më 10 mars 1984. Flet për punët e ditës në Ostren. Flet për Hajredin Koçin dhe brigadën e tij...

I dyti, ai i 21 prillit 1984 ka për titull "Flet puna e shokët", flet për Vera Elezin, mësuesen e shkollës 8-vjeçare "Elez Koçi" Ostren. "Ajo erdhi familjarisht nga rrethi i Durrësit për të punuar vullnetarisht në këtë zonë të thellë malore. Kanë kaluar dy vite shkollore. Rezultatet e kanë shoqëruar gjatë këtyre viteve. Thjeshtësia, sinqeriteti, sjellja korrekte nga ana tjetër e plotësojnë akoma më mirë portretin e saj si një mësuese shembullore..."

Më 2 maj 1984 shkruan për pasurimin e bazës materiale në shkollën e tij. Shkruan për mësuesin e ri Ilir Jorgo, për mësuesit e tjerë- Veli Kajën, Shefik Elezin, Ismail Llagaçin...

Më 9 maj "Tingujt e daulles mblodhën përreth shkollës së mesme bujqësore të bashkuar Ostren grupet artistike të pesë çetave të pionierëve të shkollave 8-vjeçare të fshatrave Ostren, Tuçep, Lejçan, Okshtun e Pasinkë." "Këngët e kënduara, thekson Fatmiri, nga Majlinda Muça e Fëllanxa Muça Ostren, Fatime Stojku Lejçan e grupi i Tuçepit u duartrokitën më shumë nga të pranishmit. U pëlqyen kënga e kënduar nga F. Muça kushtuar atdhetarit Eles Koçi, etj.

Më 30 maj 1984 portretizon punonjësit e tregtisë të Ostrenit, skicon portretin e Ramazan Tolës, Mehdi Ibrahimit e Semije Kurtit. Penelatat për portretet e tyre i ka marrë nga "fjalët e popullit". Flet edhe për Luan Koçin dhe Ahmet Koçin, për punë të mirë e mangësi.

Më 2 qershor ndalet tek ndërtuesit, tek ata njerëz që me punë e djersë ndërtojnë vendin, tek ata nipër e stërnipër ndërtuesish duarartë që rrahën rrugët e Ballkanit, që ndërtuan veprat më të bukura të Perandorisë Otomane, tek ata për vlerën e punës të të cilëve një historian i madh i kohës shkruante " Po të digjej Stambolli, Dibra do ta ngrinte të ri nga themelet, ndërsa po të digjej Dibra askush s'do lëvizte vendit". Fatmiri në shkrimin e tij ndalet tek "15 ndërtuesit Gollobordas, që drejtohen nga mjeshtri i talentuar i ndërtimeve Adil Muça që shtojnë veprat e artit në rrugën e re të Ramnagorës që lidh Ostrenin me Shupenzën" . Shkruan përmjeshtrit në ndërtim, për Fatmir Mijën, Fiqiri Koçin, Halit Canin, për shoferët e palodhur Shyqyri Kurti dhe Liman Rena, për tu ndalë tek cilësia e lartë e punës, vlerë e ndërtuesve gollobordase, ndërtues që vetëm Trebishti ka nxjerrë 11 heronj të punës socialiste.

Fatmiri është një njeri që i dhemb kur gjërat ecin ngadalë apo qëndrojnë për vite në vend. Ai është i shqetësuar pse ndërtesa e dyqanit të Ostrenit të Vogël ka tre vjet që nuk ngrihet nga themelet dhe nuk vihet në shërbim të banorëve. Por ajo " S'është e vetmja, ajo ka edhe shoqet e veta, që gëzojnë fatin e saj. Në të hyrë të fshatit ndodhet edhe shkolla 8-vjeçare e planifikuar, por e papërfunduar, ku të 250 nxënësit e këtij fshati, marrin rrugën akoma drejt fshatit Tuçep..."

Përcolla para jush fragmente të jetës dhe krijimtarisë të Fatmir Terziut në një fshat të Dibrës, në Ostren, Ostrenin e Madh siç quhet për ta dalluar nga Ostreni tjetër në anën tjetër të malit, Ostrenin e Vogël, në një krahinë të Dibrës me njerëz të punës e sakrificës, në një karakoll të madh të qëndresës shqiptare në historinë e Shqipërisë. Shkrimet modeste të Fatmir Terziut në gazetën lokale "Ushtima e maleve" më ngjajnë me gurët e grykës së Bunarit të tij, bunar që ai mori ujin e jetës së tij publicistike, letrare duke u bërë një publicist i dëgjuar, një shkrimtar i suksesshëm, një njeri me germa kapitale.

Dhe ajo që shoh tek Fatmir Terziu është se ai vazhdon të gërryej në bunarin e tij të jetës duke nxjerr prej andej ujin e pastër me të cilin selit fjalën, vargun.

Tek shfletoja koleksionet e "Ushtimës së maleve" në kërkim të jetës sime 55-vjeçare faqeve të shtypit (1957....2020), midis firmave të shumta që përbëjnë vlerën e pazëvendësueshme të saj, takova edhe Fatmir Terziun, emër tash i njohur nga ana ime në letërkëmbimet në adresat tona elektronike.

Fatmiri është një njeri që i dhemb kur gjërat ecin ngadalë apo qëndrojnë për vite në vend. Ai është i shqetësuar pse ndërtesa e dyqanit të Ostrenit të Vogël ka tre vjet që nuk ngrihet nga themelet dhe nuk vihet në shërbim të banorëve. Por ajo "S'është e vetmja, ajo ka edhe shoqet e veta, që gëzojnë fatin e saj. Në të hyrë të fshatit ndodhet edhe shkolla 8-vjeçare e planifikuar, por e papërfunduar, ku të 250 nxënësit e këtij fshati, marrin rrugën akoma drejt fshatit Tuçep..."

Fiti Capa, një histori dashurie dhe mbijetese

(vijon nga faqja 9)

Kështu, me punë, me përpjekje, me dinjitet dhe me besimin tek Zoti, kjo degë e fuqishme e fisit të nderuar Capa, po rrit gjithnjë e më tepër vlerat e saj.

FISI CAPA NE MAJTARE

I pari i fisit Capa, që zbriti nga Selishta, për në zonën e Maqëllarës, ishte Dan Capa. Ai kishte dy djem, Dalipin dhe Sherifin. Fillimisht, nuk u vendosën në Majtarë, ku banojnë dhe sot e kësaj dite. Vendqëndrimi i parë ishte fshati Reshan, që në atë kohë ishte çiflik i Dacit. Aty qëndruan plot 40 vjet si bujq, tek shtëpia e Dacit. Dan Capa dhe dy djemtë ishin punëtorë të mëdhenj dhe në shumë pak kohë e mëkëmbën ekonominë familjare. Duke parë përparimin e tyre, Lleshi e këshillon Dacin t'i largojë nga çifliku, pasi do ta zënë vendin.

Vërtetë pas një kohe të gjatë të qëndrimit atje, të ardhurit blenë një troje në fshatin Majtarë dhe aty do të qëndronin, punonin e krijonin familjet. Në trojen e posablerë, ndërtuan një kullë trekatshe, aty në të hyrë të shekullit të kaluar. Por në një nga bombardimet serbe, kulla u godit me top dhe njëri kat i saj u rrëzua, duke mbetur me dy katet e tjerë. Veç trojes, ata blenë dhe katër hektarë tokë, matanë përroit, pronë e Riza Camit. Dalipi la dy djem, Shaqirin dhe Nazifin, kurse djali tjetër Sherifi la Mersimin. Shaqiri pati tre djem, Laimin, Tofikun dhe Latifin. Në korrik të vitit 1950, Shaqirin e vranë në Gjoricë forcat e shtetit dhe më pas u deklarua se kjo gjë kishte ndodhur gabimisht. Por kjo nuk kaloi ashtu pa pasoja. Laimi qëishte oficer në atë kohë, u largua nga shërbimi dhe u hoq nga partia. Po kështu dhe djali tjetër, Tofiku u përjashtua nga partia. Telashe jo të vogla pati dhe për vëllain e Shaqirit, Nazif Capën. Atë e internuan për disa kohë në Tepelenë e më pas në Tiranë.

Pas këtyre trazirave, jeta e familjeve të fisit Capa rrodhi më e qetë. U shtuan fëmijët, u ndërtuan shtëpi të reja dhe fisi shtohej nga viti në vit. Nazifi u kthye shpejt nga internimi. Ai jetoi më se 90 vjet dhe la një djalë, Dalipin. Ky pati nëntë fëmijë, gjashtë djem dhe tre vajza. Zoti e jep rriskun e njeriut. Të gjithë fëmijët e Dalipit janë punëtorë e njerëz seriozë. Gjashtë djemtë e tij, Tushi, Bektashi, Bexheti, Tasimi, Vaiti dhe Besimikanë ndërtuar vila të bukura në Majtarë dhe në rrugën e Doganës. Ata kanë krijuar një kompani ndërtimi të tyren dhe punojnë në Itali, Francë a diku tjetër, duke dhënë një shembull të shkëlqyer se si fitohet pasuria me mund, djersë e punë të ndershme.

Shumë u shtua dhe degëzimi tjetër, familja e Mersimit. Ai pati katër djem Sherifin, Haxhiun, Rakipin dhe Danin. Secila prej këtyre familjeve u shtuan me djem e vajza . Vetëm djem janë katërmbëdhjetë, që punojnë e jetojnë në Shqipëri, Greqi, Itali, apo në vende të tjera të Europës.

Tre degët e fisit Capa në Maqëllarë jetojnë e punojnë në paqe me Krijuesin e Botës, në paqe me komunitetin dhe me njerëzit që i rrethojnë. E kanë prezantuar veten si njerëz të punës, të paqes, të besës dhe të trimërisë. Ata kanë treguar vlerat e bukura të malësorëve trima, ardhur nga Selishta, bile duke i ngritur këto vlera në nivele akoma më të larta, duke merituar vlerësimet tona maksimale.

histori

Elez Murrja është pinjolli më i vyer i fisit Murrja dhe prijësi jo vetëm i vëllezërve të tij, por i luznakëve dhe i dibranëve.

Atdhetari Elez Murrja

Nga: *Prof. Asoc. Dr.* **ARIF MURRJA**

I - HYRJE

Hulumtimi për patriotin Elez Murrja është pjesa e tretë e studimit "Kronologjia e fisit Murrja në Luzni të Dibrës". Elez Murrja, bashkë me vëllezërit Hasanin, Hysenin, Tafën dhe Limanin janë brezi i dytë i fisit Murrja. Ato janë djemtë e Halilit, i cili u zhvendos nga fshati Lishan i Poshtëm në fshatin Hotesh, po në Luzni. Ndërsa vëllai i Halilit, Osmani dhe djemtë e tij Tahiri, Sinani dhe Rrahmani qëndruan në fshatin e lindjes në Lishan të Poshtëm.



Figura 3.1 *–Atdhetari Elez Murrja*

Elezi është fisniku i pazëvendësuar i fisit Murrja. Pas vdekjes së të atit Halilit, ai trashëgoi Kreun e Malit të Luznisë. Edhe përse i ati u shqua si Prijësi i Luznisë, historia e tij ka patur dritëhije, sepse marrëdhëniet e tij me perandorinë Osmane ishin më shumë miqësore se armiqësore. Elezi në ndryshim nga i ati, si një nga Nëntë Paritë e Maleve të Dibrës, nuk u pajtua me reformat e perandorisë Osmane. Ai kundërshtoi pashallarë turq, ku në disa raste pati edhe mosmarrëveshje me Paritë e tjera të Maleve të Dibrës. Pa eklipsuar mundin, lodhjen, sakrificën, bujarin, ndershmërin, trimërin dhe atdhetarizmin e djemve të tjerë të Halilit, Elezi është pinjolli më i vyer i fisit Murrja dhe prijësi jo vetëm i vëllezërve të tij, por i luznakëve dhe i dibranëve.

II -KRITIKË PËR HISTORIANËT

Në kontekstin shkencor, historianët i kanë hyrë në hakë (nuk i kanë dhënë të drejtën e merituar) Prijësit të Malit të Luznisë Elez Murres. Misioni dhe vizioni i tij atdhetar ishte "Dheu i Luznisë i Lirë". Ndaj studimi i veprës së tij do të kishte qenë një punë shumë e çmuar dhe pjesë shumë e bukur e fototekës historike të kombit, por dhe shumë e shpërblyer në këndvështrimin profesional. Për këtë memorje të munguar historike shpresojmë t'ia kemi arritur qëllimit dhe historianët e ardhshëm t'i japin vendin e merituar atdhetarit Elez Murrja.

III -VEPRIMTARIA ATDHETARE

Pasi mori drejtimin e Malit të Luznisë nga i ati, Elez Murrja përfaqësoi luznakët në Kuvendet e Maleve të Dibrës dhe ishte në krye të të gjitha luftrat për më shumë se tre dekada. Emrie Skuka në librin e saj "Sinoret e Luznisë" shkruan: Vdiq natyralisht. E shoi mosha, por jo zjarri, duke lënë një shtjellë mungimi në krahinë. Me emrin e tij, Luznia iu fal një urtësie më përçore, një urdhëri më të lashtë, një historie më në zë, një kështjelle më të fortë.

1-Elez Murrja në betejën e Gjoricës më 23 tetor 1844

Lufta e Gjoricës kundra Hajredin Pashës është aksiom historike. Sot kënga "Hajredin Pasha i vjen Radikës" është e përmasave kombëtare. Para betejës Kuvendi i Maleve të Dibrës kishte thirrë takimin në Gjoricë, për të kundërshtuar reformën e Tanzimatit, që kishte ndërmarrë perandoria Osmane. Kuvendi i Maleve të Dibrës në Gjoricë udhëhiqej nga Sheh Mustafa i Zerqanit. Ndër krerët që morën pjesë në takim ishin: Cen Leka e Sal Markja i Grykës s Vogël, Ismahil Kaloshi nga Çidhna, Elez Murrja nga Luznia dhe Nel Hoxha e Abaz Pira nga Muhurri.

Veprimtaria atdhetare e Elezit arrin kulmin me pjesëmarrjen e tij në luftë në krye të luznakve kundër Hajredin Pashës në pranverën e vitit 1844 (Kolgjegja 1991:38-41 dhe Ndreu 2003:163-164). Në lidhje me prezencën fizike të Elez Murres dhe luznakve në këtë betejë studiuesi Munir Shehu shkruan: -Elez Murrja me luznakë kishte zanë pritë në kodrat e Drinit të Zi gjer mbi Çerenec. Lufta e perandorisë ishte në disa fronte (Skuka, 2017:101). Si gjithmonë e kudo, pushtuesi bashkëpunon me "aktorët" e brendshëm. Haxhi Pash Zogolli nga Mati kishte ardhur në ndihmë të Hajredin Pashës (Kolgjegja, 1991:42), duke sulmuar Katër Grykët dhe Luzninë (Skuka 2017). Ndër luznakve të shumtë edhe Mustafa Nikollit nga Katundi i Ri po i digjeshin shtëpitë e tre djemve, por ato ishin në Gjoricë me Elez Murren (Skuka, 2017:100:101). Në nderin e Elezit dhe luznakve, frymëzuesit e këngëve këngë folklorike, thurën këto vargje:

Elez Murrja burrë i zi
Me malsor ka ra n'Dri,
Kan zan vend n'kodër t'par,
Luft po bajn me pashallar.
Daut Murrja burr idhnak,
Ka shem krahinën tan luzak'.

Shporru turk mos na mërzit,
S'ke ç'na ban more jezit.
Ndash simjet ndash n'mot,
Ta shtrojm' vendin me barut.

2-Elez Murrja në Kuvendin e Maleve tek Gjurra e Mazhicës më 2 qershor 1855

Edhe përse perandoria Osmane, ishte në dekadat e fundit të qeverisjes, karrieristët ushtarak turq merrnin përsipër aventura. Haki Stërmilli dhe Munir Shehu, në kujtimet e mbledhura nga populli, shkruajnë se pas humbjes së Hajredin Pashës në luftën e Gjoricës, Hysni Pasha edhe përse i ri në moshë kishte kërkuar që të vihej në krye të ushtrisë turke për të futur nën kontroll Dibrën. Për këtë u vendos thirrja e Kuvendit tek Gjurra e Mazhicës më 2 qershor 1855. Aty morën pjesë përfaqësues nga paritë e qytetit, përfaqësitë e maleve, krerët e fshatrave dhe burra të mendjes dhe pushkës.[1] Nga Mali i Luznisë morën pjesë Elez Murrja, Sali Nikolli dhe Hysen Manuka (Skuka, 2017:106-107).

Në këtë takim, Elez Murrja hodhi mendimin se koha nuk priste për "lojra", "marifete", "kurthe", "nënshtrime" e servilizma. Sipas tij vetëm lufta ishte zgjidhja dhe nuk kishte mënyrë tjetër. Por iu bind planit të Salë Markes për ta futur në kurth Haki Pashën. Kurthi ishte që ato të takoheshin dhe t'i kërkonin zgjidhjen e kundërshtive pa luftë. Mirëpo takimi nuk shkoi siç u parashikua. Elez Murrja me Pasha Hakiun u konfrontua verbalisht jo vetëm me fjalë, por edhe me xheste duke kapur armët që mbanin në brez. Nëse pashai turk fliste si harbut nën "hyqmin" e perandorisë, Elez Murrja i pakompromis për çështjen atdhetare nuk i la "kusur" (s'la gjë më shumë pa thënë). Kërcënimi i Hysen Pashës ndaj Elezit ishte dorëzimi i vulës së Kreut të Luznisë, i cili nuk hezitoi t'ia jepte (dorëzonte). Në ato momente debati, vula u administrua nga Salë Markja sepse kishte qëllim të fuste në grackë pashin turk, që të lironte të burgosurit, ku ishte edhe i biri dhe ta përzinte (largonte) atë pa luftë.

3-Elez Murrja me luznakë vrau Sekretarin e Vezirit të Shkodrës në Kullën e Zunës në Sohodoll

Ndryshimet e kufijve administrativ janë "epshe" të çdo qeverisje, e sidomos të pushtimit disa shekullor të perandorisë Osmane. Në hulumtimet tona nuk kemi gjetur datë dhe vit, por Veziri i Shkodrës kishte filluar përpjekjet për të futur nën "pashallëkun e tij" Dibrën. Për të bërë të mundur ndryshimin administrativ Skeretari Vezirit të Shkodrës ishte i deleguari për të dialoguar me krerët e Oxhaqeve dhe krerët Maleve në Dibër.

Në lidhje me këtë objekt bisede, Elez Murrja ishte thirrë nga Sekretari i Vezirit të Shkodrës bashkë me Salë Marken e Grykës së Vogël dhe Salë Demirin e Çidhës tek Hoxholli i Dibrës së



Figura 3.2 *-Pozicioni strategjik i Kullës së Elezit dhe gjendja sot (Burimi: Foto nga Edmond Hasani)*

Madhe (në Sheher). Në këtë bisedim pati oferta në monedha floriri, por Elezi nuk pranoi. Ai iu përgjigj Sekretarit të Vezirit të Shkodrës: "-Unë nuk e shesë dheun me pare". Nga mos pranimi i ofertës Adminstratori i Lartë, i Pashallëkut të Shkodrës e ka fyer Elezin dhe ai është larguar nga takimi.

Vendqëndrimi i përkohshëm i Sekretarit të Vezirit të Shkodrës në këtë ekspeditë të ndryshimit territorial ishte kulla me katër pode e Zunës në Sohodoll të Dibrës së Poshtme. Elezi mblodhi luznakët dhe harton planin e hakmarrjes ndaj fyerjes dhe nënvlerësimit që i bëri Sekretari i Vezirit të Shkodrës në takimin tek Hoxholli në Dibër të Madhe. Në këtë atentat ai merr Cok Hasën, Ahmet Canin, Truc Manukën, Musli Skukën dhe Ibrahim Merën. Ndërkohë më parë, kishte porositur tek Abaz Pira në Kishavec, shkallë druri me palosje. Në një natë shiu e bore të ashpër Elezi me luznakët niset për tek kulla e Zunës në Sohodoll. Pasi asgjesuan rojet rreth kullës, kanë vendosur shkallët dhe Cok Hasa me plumbin e hutës ka ekzekutuar Sekretarin e Vezirit të Shkodrës në podin e fundit. Ngjarja është përjetësuar me vargjet folklorike të mëposhtme:

Kulla e Zunës me katër pode,
S'pranon vezir pa u ba vorre.
Mrena n'Shkodër u çudit Valia,
Haber t'keq na çoi Luznia.
Kush ja hoqi jetën pashës,
Ai Cok Hasa burrë i besës.
Kush i hyni kullës mbrapa,
Ahmet Cani, Truc Manuka e Musli Skuka.

Çidhna e Gryka e Vogël,
Janë vlla me Shkodër.
Në mes kemi Luznin',
I lashim Perënin'.

IV –FAKTE ARKEOLOGJIE TË VEPRIMTARISË

1-Kulla e Elez Murres

Veprimtaria atdhetare e Elezit ka gjurmë të "gjalla" arkeologjike. Kulla e tij është e përmasave rezidenciale. Nga luznakët njihet si kulla me 12 qoshe e tre pode (kate). Elez Murrja mendohet se ka lindur para viteve 1810 dhe jetoi mbi 60 vjeç. Ndërsa kulla mendohet se është ndërtuar në 10-vjeçarin e katërt të viteve 1800.



Figura 3.3 *-Rrënimi i Kullës së Elezit në* sistemit *socialist*

Gjendja e saj sot është e mjerueshme. Është e rrënuar dhe "rënkon" me za të naltë.

Elezi e ndërtoi kullën në majë të shkrepit/shkëmbit buzë Drinit të Zi në verilindje, në hyrje të fshatit Hotesh (Shikoni fotot në figurën 3.1). Ndërtimi i kullës në majë të shkrepit është shumë strategjike. Nga kulla kontrollohen të gjitha hyrjet për në fshat. Ndërtimi i saj i përket arkitekturës mesjetare të vonë. Para se të fillonte ndërtimi i kullës muratorët/ustallarët kanë bërë këtë provë: -Kanë bashkuar dy gurë me gëlqere të stazhinuar në vite dhe i kanë hedhur nga shkrepi ku ndodhet sot kulla. Gurët e ngjitur janë rrokullisur dhe janë grisur xhepat e buxhetit nga babëzia dhe u janë errësuar sytë nga padituria. Si do që të bëhet, edhe nëse kulla të zhbëhet, Elez Murrja ishte atdhetar i madh i bashkimit të luznakve për çështjen kombëtare; ndërsa kulla e tij ishte fortesa e unitetit patriotik midis luznakve në luftrat kundra pushtuesit Osman.

kanë rënë në lendinën pa u ndarë. Atëherë ata i kanë thënë Elezit se gëlqerja është stazhionuar për të filluar ndërtimin.

Kulla i rezistoi luftrave, por jo sistemeve. Në sistemin socialist kulla jo vetëm nuk u mirëmbajt, por u degradua duke u përdorur si stall për bagëti të imta. Rreth viteve 70-80' të shekullit XX (të kaluar) u banua nga njerëz të pastreh si Rexhep Jova. Kulla prej shekujsh mbeti në mëshirën e fatit. Në fund të viteve 90 të shekullit të kaluar filloi të rrënohej. Shkatërrimi i saj ekspozohet në fotot e Figurës 3.2.

2-Karakolli i Elez Murres në Qenok

Karakolli shërbente si pik vrojtimi. Munir Shehu në studimin e tij "Dibra në shekujt e sundimit osman" shkruan: -Elez Murrja për të qenë i sigurtë ndaj sulmeve të ushtarëve turq në majën e kodrave të Qenokut ndërtoi karakollin (vendrojen) me fshatarët nga Trepça, Peka dhe Pjeça. Karakolli kishte një kaush (dhomë e madhe) ku mund të sterhoeshin rreth 15 vetë, një kuzhinë dhe një zyrë. Kjo ndërtesë është përdorë më vonë edhe nga administrate turke dhe shumë më vonë nga ajo e kohës së Zogut. Karakolli gjerë në shembje quhej "Karakolli i Elez Murres".

V-PËRFUNDIME

Elez Murrja mendohet të ketë lindur para viteve 1810 në fshatin Hotesh. Ai qeverisi dhe udhëhoqi luznakët në më shumë se tre dekada në konfrontimet ushtarake me perandorinë Osmane. Elezi refuzoi ofiqet dhe florijtë, dhe nuk shiti "Dheun e Luznisë" tek pashallarët turq. Elezi është korifej (maja) i/e patriotizmit në fisin Murrja në Malin e Luznisë dhe në Dibër. Për atdhetarin Elez Murrja duhet të "ulërasin" historianët, arkeologët, organizatat qytetare që zëri i tyrë të "shpojë" veshët e institucioneve qeveritare për të investuar në rindërtimin e kullës së tij. Lavdia historike e këtij patrioti të madh dhe rikonstruksioni i kullës së tij do të jetë një nga më të mirat, në më të shumtat vende për vizitorët vendas dhe turistët e huaj në Hotesh të Luznisë. Populli thotë: "Daullja bie për atë që kanë veshë"; por fatkeqësisht institucioneve qeveritare që e kanë detyrim ligjor të merren me "ringjalljen" e vlerave historike; u

1 Pjesëmarrësit e tjerë ishin: Cen Dacit, Maliq Zajmit, Kahreman Kodrës, Hasan Bllacës, Osman Shemsibegut, Dalip Karajt, Mustafa Shehut të Zerqanit, Sefer Lleshit, Rrahaman Demës, Salë Markes, Salë Demirit, Ali Lushës, Demir Nokës, Hasan Bulkut, Mahmut Trocit, Jusuf Dodës, Mahmut Methasanit, Bajram Bardullës, Bajram Zenelhasanit (Skuka, 2017:106-107).

**Analizë kritike e jetës
dhe veprës së Skenderbeut**

Epoka e Gjergj Kastriotit,
bazament i vetëdijes kombëtare shqiptare



Dr ENVER HALILI
Melburn, Australi

(vijon nga numri i kaluar)

Gjergj Kastrioti së bashku me tre vëllezërit e tij u mor peng nga Sulltani, u dërgua në Turqi dhe atje u rrit dhe shkollua në oborrin mbretëror. Qysh si fëmijë u dallua për shkathtësitë e veçanta fizike dhe zgjuarsinë mendore. Herët u dëshmua se ai ishte shume inteligjent dhe arriti me sukses t'i mësojë disa gjuhë të huaja si turqishten, tatarishten, sklavonishten, latinishten, persishten dhe velshisten. Gjergji po ashtu ishte njohës shumë mirë historisë sidomos historisë së lashtë iliro-pellazge. Mbi të gjitha Gjergji kishte virtyte të larta humane; ishte i urtë, i dashur dhe shumë i respektueshëm nga shokët e tij. Edhe pse u rrit larg atdheut ai ishte një djalosh me edukate tipike arbërore.

Gjergji me shkathtësitë e tij të veçanta luftarake dhe aftësitë të larta mendore çdo herë shkëlqente në dyluftime në fushë të mejdanit, shkëlqente si luftëtar, edhe si komandant në fushë-betejë. Pasi mbaroi shkollën u bë SPAHI dhe vu në krye të 5,000 kalorësve. Pa i mbushur ende 18 vjet korri fitore të rëndësishme në Azi. Sulltani gjithashtu e dërgoi për të luftuar edhe kundër europianëve për ta sprovuar seriozitetin dhe besnikërinë e tij. Pas fitoreve të suksesshmen në fushëbetejë Kastrioti fitoi gradën ushtarake të sanxhakbeut (e dyta pas pashës). Pastaj shpejt e fitoi titullin Skënderbe (Iskender Bej- Prijësi Aleksandër) për nder të Aleksandrit të Madh, pasi që ai vinte nga viset e Maqedonisë së Lashtë.

Më 1437-1438 sulltani emëron Skënderbeun qeveritar dhe pastaj Sanxhakbe në Krujë. Kjo periudhe edhe pse qe shumë e shkurtër i ndihmoi Gjergjit t'i njohë nga afër arbërit dhe të lidhet shumë me atdheun. Kur sulltani e hetoi dashurinë e Kastriotit për atdheun dhe ndërlidhjen e tij me princat e vendin amë ai mori vendim dhe shpejt e ktheu në Adrianapojë. Largimin nga Kruja Skënderbeu në njërën anë e përjetoi si një grusht të rëndë, por në anën tjetër ky akt i sulltanit i ndihmoi atij ta njohë më mirë fytyrën e tij dinake dhe shtoi edhe më shumë urrejtjen ndaj tij. Mbi të gjitha ky akt i shtoi Kastriotit dashurinë ndaj atdheut dhe e lidhi atë përjetësisht me Arbërinë.

Në fillim të viteve të dyzeta të shekullin 15 deri sa osmanët shtonin dhunën dhe reprezaljet në viset e pushtuara, në Evropë dhe Ballkan filluan të gjallëroheshin shpresat për dëbimin e pushtuesit lindor. Në vitin 1442-1443 në frontin verior të Ballkanit, ushtria e Gjeneralit hungarez Huniadi, rritej e forcohej vazhdimisht dhe arrinte fitore të suksesshme kundër osmanëve. Pas fitoreve të njëpasnjëshme trupat e Huniadit kaluan Danubin dhe marshuan përgjatë luginës së Moravës drejt viseve verilindore shqiptare. Sukseset e Huniadit në frontin verior i dhanë një shtytje të fortë lëvizjeve çlirimtare në Arbëri. Në vitin 1443 Gjergj Arianiti filloi sulmet kundër osmanëve në viset qendrore të vendit. Po ashtu Gjin Zanebishti me trupat e tij nga Saranda e Gjirokastra u nis për të çliruar Kosturin por fatkeqësisht forcat e tij nuk patën sukses.

Në atë kohë në horizontin arbëror filluan të duken aspirata më të avancuara organizative me qëllim që të hiqej qafe zgjedha e huaj. Princat arbëror filluan të mendonin për përdorimin e një strategjie tjetër në nivel të gjerë kombëtare dhe në një shkallë më të lartë organizative. Ata shtruan idenë për krijimin e një force unike të organizuar nga të gjithë principatat me qëllim që të mundësohej formimi i një ushtrie të përbashkët kombëtare. Në atë kohë Skënderbeu edhe pse ishte larg vendlindjes bënte planin për t'u kthyer në atdhe. Qëllimi i tij ishte që të bashkohet me princat tjerë epirotë për të krijuar një ushtri të unisuar dhe menjëherë të fillonte luftën kundër pushtuesit e cila do të çlironte vendin dhe do të krijohej një shtet/mbretëri arbërore.

Disfatat e viteve 1442-43 ishin shumë të rënda për ushtrinë osmane. Sulltani nuk mund ta duronte poshtërimin nga humbjet e një pas njëshme që ushtria e tij pësoi nga forcat e Huniadit. Kështu që, në vjeshtën e hershme të vitit 1443 ai përgatiti një ushtri të madhe për ta sulmuar Huniadin dhe për komandant të forcave osmane emëroi Gjergj Kastriotin. Zgjedhja si kryekomandant i ushtrisë osmane ishte një rast ideal për Skënderbeun për të realizuar porosinë e të atit të tij që i kishte dhënë kur u mor peng nga sulltani: 'biri im kurrë mos i harro këto male!" (Filmi Skënderbeu, 1968).

Kastrioti, me kohë kishte vënë kontakte me Gjeneral Huniadin në mënyrë që të luftojnë së bashku kundër armikut të përbashkët. Me qëllimin që të arrinte synimin e tij, Skënderbeu zgjodhi ushtarët më të mirë arbëror që ishin të rekrutuar në repartet e ushtrisë osmane dhe u nis drejtë Nishit. Ai tani më kishte krijuar lidhje të forta me princat arbëror dhe kishte bërë gati planin për kthimin në atdhe.

Me 3 Nëntor të vitit 1443 u zhvillua beteja në Nish në mes ushtrisë së Huniadit dhe asaj osmane. Në atë ditë Skënderbeu mori një vendim të duhur në kohë shumë të duhur. Skënderbeu bëri kthesën historike e cila definitivisht do ta ndërrojë fatin e popullit shqiptar. Fati e deshi aty të ishte një zyrtar osman nga i cili mori një dokument (ferman të rremë) i cili dëshmonte se Skënderbeu emërohej qeveritar i Krujës.

Largimi i Kastrioti nga fushëbeteja i mundësoi Gjeneral Huniadit të shënojë edhe një fitore sa të rëndësishme aq edhe të lehtë. Me largimin e kryekomandantit nga fushëbeteja, forcat osmane mbetën të hutuara dhe u bënë pre e lehtë e ushtrisë hungareze ku pësuan përsëri një humbje të rëndë.

Me 300 trima të zgjedhur shqiptar Skënderbeu lëshoi frontin e luftës dhe nga Nishi i Kostandinit të Madh u nis drejt Arbërisë. Në ato ditë vjeshtë kalorësia e Skënderbeut marshonte përgjatë luginës së Moravës Dardane, vazhdoi rrugën nëpër shpatet e Sharrit Plak për t'u ndalur në Dibër e cila ishte pika më e rëndësishme strategjike e kohës. Dibranët e pritën me gëzim të madh kryetrimin maqedono-epirot i cili u shfaq si një yll shprese për lirinë arbërve. Në Dibër Kastrioti gjeti përkrahje të fortë nga populli arbëror-maqedon. Që në fillim Skënderbeu u bind se populli ynë ishte shume i irrituar nga dhuna dhe represioni barbar osman dhe ishte i gatshëm të hidhej në luftë për ta çliruar e atdheut.

2.2. KTHIMI I GJERGJ KASTRIOTI NË KRUJË- ÇLIRIMI I ARBËRISË

Skënderbeu ishte një strateg luftarak i shkëlqyer dhe kishte vizion çlirimin e atdheut dhe krijimin e shtetit kombëtar. Për disa jave sa qëndroi në Dibër bëri të gjitha përgatitjet e nevojshme dhe në fund të nëntorit të viti 1443 u nis për në Krujë. Arritjen e Skënderbeut në Krujë më së miri e përshkruan rilindasi ynë i madh Naim Frashëri në vargjet e tij te mrekullueshme të publikuara në vitin 1898, ku në mes tjerash thotë: "Krujë o qytet i bekuar, prite, prite Skënderbenë, po vjen si pëllumb i shkruar, të shpëtojë mëmëdhenë."

Më 28 Nëntor 1443, flamuri i Kastriotëve valonte i lire në kështjellën e Krujës. Lajmi për arritjen e Skënderbeut në atdhe u përhap si vetëtima anë e kënd vendit dhe shume njerëz arritën në Krujë për të festuar. Atë ditë në Krujë, kryeqendrën e Arbërisë, Skënderbeu mbajti një fjalim historik, i cili nuk do të harrohet kurrë. Kastrioti kishte një oratori të shkëlqyeshme. Në atë fjalim të rastit, Ai në mes të tjerash tha: "Lirinë nuk ua solla unë, por e gjeta këtu,... atë e pashë kudo në krahërorët, në ballët dhe në shpatat tuaja" (Barleti, 1508). Ky lajm u përhap shumë shpejt në tërë Epirin si dhe në Europë dhe shihej si një sinjal shprese për lirinë e popujve të shtypur. Pas çlirimit të Krujës "kudo oshëtinte zëri i ëmbël i lirisë" (Barleti, 1510).

Çlirimi i Krujës i dha një shtytje të paparë luftës për çlirimin e atdheut, ku forcat arbërore filluan menjëherë sulmin kundër pushtuesit osman. Vala e luftës për liri u përhap në të gjitha viset e vendit që nga jugu deri në veri. Luftëtarët e Skënderbeut



Skënderbeu ishte një strateg luftarak i shkëlqyer dhe kishte vizion çlirimin e atdheut dhe krijimin e shtetit kombëtar. Për disa jave sa qëndroi në Dibër bëri të gjitha përgatitjet e nevojshme dhe në fund të nëntorit të viti 1443 u nis për në Krujë.

shpejt i çliruan kështjellat e Petrelës (në jug të Tiranës), Ohrin, Strugën, Sopotnicën, dhe vunë nën kontroll rrugën kyçe Kërçovë-Shkup, përgjatë lumit Treska etj. Kryengritja arbërore përfshiu edhe vise e Shqipërisë së Veriut, Qendrore dhe asaj Jugore të vendit deri te lumenjtë Devoll e Seman. U çliruan një numër principatash si Principata e Arianitëve, e Topijave, dhe ajo e Muzakajve. Gjithashtu u rimëkëmbën një numër zotërimesh të rëndësishme si ato te Dukagjinëve, Stres-Balshajve, Zahariajve, dhe Kastriotëve. Në veri shpejt u mor kështjella e Jeliçes në Pazarin e Ri dhe Zveçani u çlirua nga Spanët. Pastaj, dukagjinët u nisën në drejtim të Dardanisë dhe vunë nën kontrollin e tyre rajonin e Pejës, etj. (Historia ..., 2002).

Gjergj Kastrioti kishte vizion shtetëror dhe siç theksonte akademik Fuga (2018) ai ishte i madhërishëm e magjik sepse ishte largpamës dhe drejtohej nga ideja. Skënderbeu ishte i vetëdijshëm se për të arritur qëllimin e tij dhe për të realizuar dëshirën e popullit duhet të bashkohen të gjithë princat epirot-maqedon dhe të veprojnë me një program të koordinuar nga një qendër. Gjithashtu Kastrioti e kishte të qartë se për këtë plan madhor duhet të veprohet në dy fusha, në atë luftarake dhe politiko-diplomatik dhe duhet të punohet në dy nivele, në atë të brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm.

Për Kastriotin koha ishte shumë e çmueshme, kështu që ai menjëherë vuri kontaktet me të gjithë princat e vendit dhe filloi bisedimet me qëllim të bashkimit të të gjitha forcave në një ushtri të vetme. Në ato biseda ai shtroi idenë e krijimit të një 'besë-lidhje kombëtare' e cila do të mundësonte krijimin e një shteti kombëtar. Një rëndësi të veçantë Kastrioti i kushtonte lidhjes se aleancave me vendet europiane të cilat jo vetëm do të ndihmonin ndërtimin e shtetit arbëror, por edhe do të mundësonin krijimin e një force unike ushtarake. Një ushtri e unisuar europiane do të mundësonte t'i bëhej një rezistencë e fortë dhe do të zhvillohej në një vijë më të gjerë të luftës e cila do t'i bënte ballë ushtrisë osmane.

2.3 THEMELIMI I MBRETËRISË SË ARBËRIT/ EPIRIT- TË GJERGJ KASTRIOTIT

Valimi i lire i shqiponjës dykrenare në kështjellën e Krujës solli shpresë në popull se tani më erdhi dita për ta çliruar atdheun. Mençuria, urtësia dhe largpamësia e udhëheqësit të ri u pa që në ditën e parë kur ai potencoi se "lirinë e gjeta këtu- nuk e solla unë"! Këto fjali kredibile treguan se Kastrioti kishte vizion dhe qëllim të lartë kombëtar. Skënderbeu mendonte se atdheu mund të çlirohet vetëm kur të gjithë princat arbëror bashkohen dhe e krijohet një ushtri e cila duhet të ngrihet, zhvillohet dhe forcohet vazhdimisht për t'i bërë ballë superfuqisë ushtarake osmane. Kjo forcë mund të arrihej vetëm me krijimin e shtetit të përbashkët epirot ku të gjithë principatat do të bashkonin forcat e tyre nën komandën e përbashkët.

Themelimi i Mbretërisë Arbërore nën udhëheqjen e Kastriotit u bë më 2 Mars të vitit 1444, në Kuvendin e Lezhës. Thirrjes historike të Skënderbeut iu përgjigjën gati të gjithë princat arbërorë si: Gjergj Arianiti, Andrea Topia, Nikollë e Pal Dukagjini, Teodor Muzaka, Gjergj Balsha, Lekë Zaharia, Lekë Dushmani, Pjetër Spani, dhe Stefan Gjurashi. Në atë mbledhje edhe Venediku e kishte dërguar një vëzhgues të vetin.

Në Kuvendin historik të Lezhës Skënderbeu shtroi çështjen e krijimit të një 'besë-lidhje kombëtare' si një akt juridik në bazë të së cilës do të lidhen të gjitha marrëveshjet ndërprincore mbi të cilin do të ngrihet dhe ndërtohet shteti i ri. Me këtë ide u pajtuan të gjithë princat maqedono-epirot. Qëllimi i 'Lidhjes së Lezhës' ishte bashkimi i fisnikëve e principatave epirote për të çliruar atdheun me qëllim të formimit të një shteti kombëtar siç ishte dikur Mbretëria e Arbërit.

Skënderbeu në fjalimin e tij, së pari filloi të elaborojë nevojën për bashkimin e të gjitha forcave dhe krijimin e një ushtrie kombëtare me një komandë të përbashkët. Pastaj analizoi situatën rajonale pas fitoreve të suksesshme të Huniadit kundër osmaneve. Vend të rëndësishëm në diskutimin e tij Kastrioti i kushtoi vullnetit të popullit i cili ishte i gatshëm të hidhej në një luftë çlirimtare. Kastrioti qysh kur erdhi në Krujë si Sanxhakbe e kishte vërejtur vullnetin dhe forcën e brendshme të arbërve për të luftuar kundër pushtuesit. Dhe në fund, Skënderbeu shtroi idenë dhe elaboroi çështjen e krijimit të mbretërisë kombëtare e cila ishte jo vetëm vullneti i princave arbërorë por edhe dhe domosdoshmëri e kohës.

Kuvendi i Lezhës, është institucioni i parë e organizuar në nivelin mbarëkombëtar i cili solli krijimin e shtetit të parë shqiptar. Pas një pune të frytshme me pëlqimin e princave arbëror Kuvendi Lezhës arriti të shpallë:

a.Organet e Mbretërisë/Shtetit: si Kryetari i shtetit, Kuvendi i Fisnikëve, Këshilli i Lartë dhe Këshilli i Luftës.

b.Mbretërinë e Parë Arbërore (Shqiptare) dhe Skënderbeu u shpall unanimisht Mbret i Epirit/ Maqedonisë/Arbërisë.

c.Simbolet e Mbretërisë si flamuri, stema dhe vula. Për flamur të mbretërisë u vendos të përdoret flamuri me shqiponjën dykrenëshe me yllin gjashtë cepësh. Shqiponja dykrenore ishte simbol i Kastriotëve, Gjurashëve, dhe Arianitëve. Ylli gjashte cepësh përdorej nga principatat e Balshajve dhe Muzakajve. Në stemë dhe vulë të Mbretërisë u vendos të vihet shqiponja dykrenare.

d.Krijimin e ushtrisë arbërore, e cila duhej të organizohej në dy forma, atë të rregullt dhe vullnetare (parregullt).

e.Krijimin e arkës/buxhetin të shtetit, vendosja e taksave dhe kontributeve publike dhe përcaktimi i monedhës mbretërore.

f.Krijimin e diplomacisë si një faktor shumë i rëndësishëm për të vënë lidhje me vendet Europiane me qëllim të krijimit të një fronti ushtarak të përbashkët kundër pushtuesve aziatikë.

Sipas vendimit të Kuvendit të Lezhës principatat arbërore ruanin një autonomi të gjerë dhe nuk kishin të drejtë të ndërhynin në kompetencat territoriale të njëra-tjetrës. Po ashtu principatat kishin të drejtë të mbanin një ushtri të vetën për të mbrojtur territorin dhe interesat e veta. Principatave gjithashtu u lejohej të ndërmerrnin vendime dhe krijonin marrëdhënie me vendet tjera. Në një mënyrë secila principatë ishte anëtare e barabartë në mes të barabartëve. Vendimi më i rëndësishëm i Kuvendit të Lezhës ishte pajtimi

⟶

Një rëndësi të veçantë Skënderbeu gjithashtu i kushtonte komunikimit me ushtarëve si para, gjatë dhe pas operacioneve luftarake. Ushtarët njoftoheshin rregullisht për të gjitha operacionet e mundshme para çdo aksioni luftarak.

Mbretëria e Kastriotit është institucioni kryesor i etnisë shqiptare në kohën e re. Në atë kohë secili princ ishte më trim se tjetri, secili ishte më i ditur se tjetri, secila Principatë ishte më e organizuar se tjetra. Të udhëhequr nga vetëdija e lartë kombëtare ata vendosen unanimisht që një prej princave të jetë në krye të të gjitha principatave. Atëherë u mundësua bashkimi i të gjitha principatave nën një ombrellë të vetme dhe u krijua Mbretëria Arbërore të udhëhequr nga krye princi Gjergj Kastrioti.

i princave arbërorë për themelimin e një shteti dhe kryerjen e obligimeve ndaj shtetit, si dhe pranimi i Skënderbeut si kryetar i shtetit. Në rast të rrezikut nga armiku të gjithë princat ishin të obliguar "të vepronin" sipas urdhrave të Gjergj Kastriotit pasi që ai u zgjodh komandant i ushtrisë së Shtetit Arbëror.

Arritja e marrëveshjes ndërmjet princave arbëror shënon kulmin e suksesit historik e cila ishte rezultat i ngritjes së vetëdijes kombëtare e cila i hapi rrugën krijimit të shtetit të parë kombëtar shqiptar. Fryma e tolerancës, bashkëpunimi ndërprincor, vurja e interesit kombëtar mbi atë personal e rajonal është fondamenti kryesor i vetëdijes arbërore të asaj kohe. Atëherë kur princat arbërorë arritën të vënë interesin e përgjithshëm kombëtar mbi atë lokal dhe individual, atëherë u arrit të çlirohet vendi dhe krijohet shteti.

Mbretëria e Kastriotit është institucioni kryesor i etnisë shqiptare në kohën e re. Në atë kohë secili princ ishte më trim se tjetri, secili ishte më i ditur se tjetri, secila Principatë ishte më e organizuar se tjetra. Të udhëhequr nga vetëdija e lartë kombëtare ata vendosen unanimisht që një prej princave të jetë në krye të të gjitha principatave. Atëherë u mundësua bashkimi i të gjitha principatave nën një ombrellë të vetme dhe u krijua Mbretëria Arbërore të udhëhequr nga krye princi Gjergj Kastrioti. Në Kuvendin historik të Lezhës të gjithë pjesëmarrësit vendosën që në krye të Mbretërisë të jetë Mbreti (Skënderbeu).

Me kalimin e kohës dhe sidomos pas sukseseve të njëpasnjëshme si në fushë-betejë, po ashtu edhe në fushën diplomatike autoriteti i Skënderbeut gradualisht rritej si dhe besueshmëria te fisnikët arbërorë ndaj tij shtohej. Kështu shumë shpejt të gjithë princat arbëror u bindën se Skënderbeu ishte jo vetëm një strateg ushtarak i talentuar por edhe një lider pragmatik i cili meritonte të përfaqësonte Shtetin e Ri të Arbërve. Kjo bindje solli shkrirjen graduale të principatave dhe përqendrimin e kompetencave në nivelin qëndror të shtetit. Sukseset e jashtëzakonshme të Kastriotit si në fushë-betejë dhe në fushën politiko-diplomatike në aspektin e jashtëm dhe në atë të brendshëm bënë që Kastrioti të shndërrohet në një lider jo vetëm politike dhe ushtarak por edhe në një prijës shpirtëror kombëtar dhe simbol i lirisë së popujve të shtypur.

2.4 MBROJTJA DHE NDËRTIMI I SHTETIT TË ARBËRIT

2.4.1 Një jetë në fushëbetejë

Skënderbeu e kaloi tërë jetën në fushë-betejë ballë për ballë me superfuqinë e asaj kohe dhe me sukses mbrojti lirinë në territorin e çliruar arbëror. Për një periudhe kohore prej 25 vjetësh Kastrioti zhvilloi rreth 30 lufta të ashpra në Arbëri në të cilat ushtria epirote arriti fitore të bindshme kundër forcave osmane të cilët vërsuleshin me dhjetëra e qindra mijëra ushtar të komanduar nga sulltanët, pashallarët, bejlerët dhe oficerët e lartë ushtarak.

Pa dyshim fitorja kundër dy sulltanëve më të njohur osmanë, Muratit II dhe Mehmetit II (Kola, 1983; Noli, 1964; Hadri, 1995) është ndër fitoret epike të cilat kurrë nuk u harruan jo vetëm nga arbërit por as nga osmanët dhe opinioni mbarë botëror. Pas dështimeve të njëpasnjëshme të ushtrisë osmane Sulltan Murati II u hidhërua dhe egërsua shumë dhe vendosi që vetë ai ta komandojë ushtrinë e tij kundër Kastriotit. Por, që në rrethimin e parë të Krujës (1450), nga dëshpërimi i madh për mos arritjen e nënshtrimit të arbërve sulltan Muratin e II e lëshoi shpirti para portës së kështjellës së Krujës (Barleti, 1508). Djali i tij, Mehmeti e barti Sulltan Muratin e II si kufomë në Stamboll. Edhe dy herë të tjera (1466 e 1467) Sulltan Mehmeti II- pushtuesi, do të trumbetonte nga Stambolli se definitivisht shteti i arbërve do të shkatërrohet. Kastrioti e njihte mirë strategjinë ushtarake dhe dredhitë e otomanëve. Ai me sukses arriti të zhvillojë luftë të fortë mbrojtëse dhe arriti tri fitore të lavdishme kundër dy sulltanëve më të ashpër të Perandorisë Osmane. Për 25 vjet nën udhëheqjen e Kastriotit dhe 10 vjet nën udhëheqjen e Lekë Dukagjinit Arbëria qëndroi heroikisht.

Në gjithë ato luftëra të tmerrshme me mijëra ushtarë turq u vranë në fushëbetejë, në mes tyre dy pashallarë, Talip Pasha në luftën e Modriçes (1452), Ballaban Pasha në Rrethimin e -II- të Krujës (1467) dhe dy bejlerë Ibrahim beu u vra në fushë të Shkupit dhe Jakup beu la kokën në fushën e Kosharit. Ndërsa dy pashallarë të tjerë u kapën të gjallë, Hamza Pasha në luftën e Modriçes (1452) dhe vëllau i Ballaban Pashës Jonuz (Jonima) Pasha me të birin e tij në rrethimin e dytë të Krujës (1467). Me të vërtetë siç pohonte shkrimtari Raguzian David, Skënderbeu për njëzet e pesë vjet ishte bërë tmerri i turqve (Barleti, 1508).

Secila fitore i ka veçoritë dhe rëndësinë e vet veçanërisht kur merret parasysh se forcat e Skënderbeut luftonin trimërisht dhe me fitoret e tyre krenoheshin jo vetëm epirotët, por e tërë Evropa dhe popujt liridashës. Megjithatë disa fitore është me rëndësi të dallohen prej të tjerave, sepse ato janë kulminacioni i luftërave epike të cilat jo vetëm se janë krenaria arbërore, por edhe pse ato vunë bazën e qëndresës dhe të krenarisë kombëtare shqiptare. Ndër të gjitha ato do veçoja shtatë lufta në të cilat u korren fitore legjendare, siç janë:

i. Fitorja e Tri Rrethimeve të Krujës (1450, 1466 e 1467). Në Rrethimin e Parë Sulltan Murati II me të birin Mehmetin rrethoi Krujën me një ushtri prej 100 mijë ushtarësh. Kruja me koordinimin e shkëlqyeshëm në mes të Skënderbeut e Vrana Kontit qëndroi heroikisht. Në rrethimin e Dytë, Sulltan Mehmeti përgatiti një forcë prej 150 mijë ushtarësh për ta sulmuar Krujën. Por Kruja qëndroi heroikisht dhe ai kokëulur dhe me turp u largua për në Stamboll. Aty e la Ballaban Pashën me 80 mijë ushtarë për ta vazhduar rrethimin. Në ndihmë Ballabanit i erdhi vëllau i Jonima (Jonuz Pasha) ku së bashku me të birin e tij Hederin u zunë të gjallë nga forcat e Kastriotit ende pa iu afruar kështjellës. Kur Ballabani pa përfundimin tragjik të vëllaut dhe nipit të tij, humbi toruan dhe si derr i egër u vërsul drejt kështjellës për t'u hakmarrë. Por ende pa iu afruar mirë portës, Ballabani u vra nga një ushtar krutan pranë portës së kështjellës së Krujës. Herën e trete Sulltan Mehmeti rrethoi Krujën me 150 mijë ushtarë. Kësaj radhe Mehmeti ndau ushtrinë në dy pjesë; një pjesë e rrethoi Krujën dhe pjesa tjetër shkatërronte çdo gjë në terren, që nga Durrësi deri në Shkodër. Skënderbeu si zakonisht me repartin e tij sulmonte nga jashtë dhe arriti ta shkatërrojë ushtrinë osmane. Gjate tri rrethimeve Kruja qëndroi e pamposhtur dhe radhët e ushtrisë osmane u shkatërruan nga sulmet e forcave epirote. Kështu që Sulltan Mehmeti II për të tretën herë do të kthehet në Stamboll i dërrmuar dhe poshtëruar (Konica, 1957).

ii. Fitorja e Luftës së Albulenës me 1457. Sulltani përgatiti 50 mijë ushtarë nën komandën e Isak bej Evrenozit për ta sulmuar Arbërinë. Evrenozi trumbetoi se përfundimisht do ta shkatërronte shtetin e Kastriotit. Sulltani në Stamboll e dekretoi Hamzanë mbret të Epirit. Kastrioti kësaj radhe ndërroi taktikën e luftës dhe lejoi ushtrinë osmane të futet thellë në brendi të vendit deri në fushën e Matit. Forcat osmane pasi që nuk hasen në ndonjë rezistencë u shfrenuan dhe filluan të dëfreheshin dhe pushonin nën hije duke krijuar bindjen se Kastrioti kishte marrë arratinë dhe kishte ikur jashtë vendit. Por në një pas dreke në fillim të shtatorit kur temperatura përcëllonte, Kastrioti papritmas u vërsul mbi ushtrinë armike. Atë ditë u zhvillua një luftë shumë e përgjakshme ku otomanet humbën mbi 20,000 ushtarë dhe mbi 7,000 të tjerë u zunë rob (Barleti, 1508). Kjo ishte një hakmarrje për masakrën e Beratit. Hamzai u zu i gjallë dhe me duar të lidhura u dërgua në Krujë dhe pastaj u internua në Napoli. Jehona e kësaj lufte ishte shumë e madhe dhe u përhap shumë shpejt në tërë Europën liridashëse. Arbërit kurrë nuk e harruan fitoren e luftës së lavdishme të Albulenës.

iii. Fitorja në Luftën e Apulisë në vitin 1461. Këtë operacion luftarak Kastrioti e ndërmori i inspiruar nga motoja tradicionale 'miku i mirë për ditë të vështirë'. Kastrioti gjatë kohe kishte ndërtuar marrëdhënie shumë miqësore me mbretin e Napolit Alfonsin i cili çdo herë e kishte përkrahur materialisht dhe ushtarakisht shtetin e Arbërit. Kur trashëgimtari i tij, Ferdinandi I u rrezikua nga armiqtë, Kastrioti pa hezitim kaloi detin dhe shkoi për t'i ndihmuar mikut. Ushtria arbërore korri dy fitore vendimtare dhe për një vit sa qëndroi atje solli rendin dhe qetësinë në vend. Pas një viti me nderime të veçanta dhe dhurata të shumta Kastrioti me ushtrinë e tij u kthye në Arbëri.

iv. Fitorja në tri ekspeditat e vitit 1462 (Mokër, Pollog dhe Livadhi). Të arrish fitore në fushëbetejë kundër tri ekspeditave të njëpasnjëshme vërtet është një sukses për ta lakmuar çdo ushtri e madhe. Por për të korrë fitore një ushtri modeste si ajo e Kastriotit ndaj një force gjigande siç ishte ushtria osmane, vërtetë këto ishin suksese të jashtëzakonshme.

v. Fitorja në Fushën e Pollogut në shtator të vitit 1462. Kjo luftë është e veçantë për një arsye sepse ajo u zhvillua në terren të hapur fushor. Një veçori tjetër e kësaj lufte është sepse në këtë luftë Kastrioti sulmoi i pari. Forcat osmane morën arratinë dhe fitorja u sigurua që në sulmin e parë.

vi. Fitorja në pesë ekspeditat e vitit 1465 kundër Ballaban Pashës i cili sulmoi me dhjetëra e mijëra ushtarë. Ekspedita e parë u zhvillua në Vajkal në muajin prill ku Ballaban Pasha sulmoi me 18 mijë ushtarë; në qershor përsëri sulmoi me 18 ushtarë në Meçad; në korrik sulmoi me 20 mijë ushtarë në Sopotnicë dhe në gusht përsëri në Vajkal sulmoi me 18 mijë ushtarë. Ekspedita e fundit u zhvillua në Kashar (afër Tiranës) kur Jakup Pasha u vërsul me 20 mijë ushtarë kundër arbërve. Është e rëndësishme veçanërisht beteja e Sopotnicës (afër Sfetigradit). Aty u zhvillua një luftë e ashpër ku edhe vetë Kastrioti u rrezikua në një moment kur papritur iu vërsul një luftëtar i armikut. Falë shkathtësisë së një ushtari arbëror i cili e shtriu të vdekur për dhé ushtarin osman, Kastrioti shpëtoi pa kurrfarë lëndimi. Pas pesë ekspeditave të pasuksesshme, më në fund Ballaban pasha u largua me turp për në Stamboll, ndërsa Jakup Pasha la kokën në fushë të Kosharit (Barleti, 1508; Hadri, 1995).

vii. Fitorja e Luftës së Shkodrës, në janar të vitit 1468. Kjo fitore është sa e rëndësishme aq edhe e lavdishme sepse u arrit pa pjesëmarrjen e kryekomandantit të ushtrisë arbërore. Në këtë luftë Skënderbeu për shkak të sëmundjes së papritur nuk mundi të marrë pjesë fizikisht, por fama dhe emri i tij kaherë u kishin dhënë zemër ushtarëve epirotë dhe në anën tjetër u kishin futur tmerrin në palcë ushtrisë osmane. Kështu që ushtarët osmanë morën teposhtëzën që në fillim të luftës dhe frika nga emri i Kastriotit i mundësoi ushtrisë arbërore të kalojë në epërsi dhe të sigurojnë një fitore të rëndësishme. Fama e Gjergj Kastriotit do t'i shoqërojë edhe për shumë vite të tjera ushtarët epirot të cilët do bëjnë rezistencë heroike dhe të dalin triumfalisht në shumë beteja nën udhëheqjen e kryekomandantit të ri Lek Dukagjini.

Ushtria arbërore arriti fitore të bindshme në të gjitha luftërat kundër forcave osmane të cilët suleshin me dhjetëra e qindra mijëra ushtarë të komanduar nga gjeneralët të cilët mbanin grada të larta ushtarake. Në anën tjetër, ushtria maqedono-epirote prej të gjitha atyre luftërave të tmerrshme pësoi vetëm një humbje në betejën e Beratit e cila u zhvillua më 1455. Kjo humbje kryesisht ishte pasojë e dinakërisë së osmaneve të cilët arritën të 'blejnë' kohë deri sa u erdhi në ndihmë Isak bej Evrenozi me një numër të madh ushtarësh. Një faktor tjetër i kësaj humbje ishte mos pjesëmarrja e Moisi Golemit në betejë, i cili ia lehtësoi rrugën Evrenozit të hyjë në Berat. Por dhe pakujdesia e disa komandantëve epirotë sidomos e Muzakë Topisë ishte një faktor tjetër e asaj humbje. Humbja ishte shumë e madhe jo vetëm pse arbërit humbën komandantin e njohur Tanush Topinë, por edhe pse forcat osmane bënë një masakër të padëgjuar ndonjëherë në trevat tona e cila shkaktoi një tronditje të madhe në popull.

2.4.2 Strategjia luftarake e Gjergj Kastriotit

Skënderbeu ishte strateg ushtarak dhe komandant i përkryer. Ai e dinte se luftëtarët osmanë jo vetëm se ishin të përgatitur në shkollën ushtarake më të njohur të kohës por ata ishin edhe të regjur në luftëra të shumta të cilët nënshtronin popujt e ndryshëm. Prandaj, Ai ishte i vetëdijshëm se duhet të krijohet një ushtri e cila do të vepronte në bazë të kodit ushtarak dhe rregullave luftarake. Strategjia ushtarake e Kastriotit bazohej në moralin e lartë tradicional arbëror ku liria e atdheut ishte mbi të gjitha. Morali i lartë luftarak mbështetej në atdhedashurinë e luftëtarëve epirot sepse ata

Një rëndësi të veçantë Skënderbeu gjithashtu i kushtonte komunikimit me ushtarëve si para, gjatë dhe pas operacioneve luftarake. Ushtarët njoftoheshin rregullisht për të gjitha operacionet e mundshme para çdo aksioni luftarak. Pozicionimi adekuat i reparteve ushtarake ne fushëbetejë dhe komunikimi dhe koordinimi efektive i operacione luftarake...

zhvillonin luftë çlirimtare. Ushtarët e arbërit ishin të vetëdijshëm për misionin e shenjtë të tyre dhe e konsideronin veten luftëtarë të lirisë. Rënia në fushëbetejë për ushtarët e arbërit ishte një gjë e shenjtë dhe konsiderohej nder t'ia falësh jetën atdheut. Vetëm një ushtri e cila e kuptonte se liria e atdheut ishte gjëja më e çmueshme ishte në gjendje të përballet me një forcë aq të madhe siç ishte ushtria osmane.

Ushtria arbërore ishte mjaft mirë e organizuar, trajnuar dhe shumë e disiplinuar dhe çdo herë ishte në gjendje të gatishmërisë së lartë. Përgatitja fizike dhe morali i lartë luftarak e shoqëronin ushtrinë arbërore ne çdo moment. Kastrioti e përgatiste ushtrinë e tij me qëllim që të luftojnë në çfarëdo kushtesh atmosferike, në çfarëdo terreni, dhe në çfarëdo situate luftarake. Kastrioti e urrente plogështinë e qulltë të ushtarëve si pasqyron Barleti (1508). Ai e dëshironte një ushtri aktive dhe mirë të përgatitur. Përgatitja e lartë ushtarake dhe kalitja e përhershme në beteja të shumta e bëri ushtrinë e Kastriotit të pathyeshme dhe krijoi një famë aq të lavdishme sa që edhe anmiku ia kishte lakmi. Ushtria epirote arriti fitore gjithkund si në fushë të hapur, në territor të ashpër malor, në vendbanime e qytete, korri fitore në dimër të ftohtë me dëborë e shi dhe në vapën përcëlluese të verës. Me të drejtë deklaronte Volteri, "sikur Skënderbeu ta kishte mbrojtur Konstantinapolin, turqit nuk do të kishin mundur ta merrnin në maj të 1453."

Në bazë të vendimeve të Kuvendit të Lezhës Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, ishte komandant e përgjithshëm i ushtrisë arberorë. Repartet kryesore të ushtrisë epirote ishin, këmbësoria, kalorësia dhe shigjetarët. Bashkëpunimi në mes të komandantëve të reparteve ushtarake ishte ndër parimet kryesore të doktrinës ushtarake të Kastriotit. Ai çdo herë bënte përgatitjet dhe hartonte planet e luftës së bashku me komandantët e reparteve. Ai gjithmonë konsultohej me komandantët dhe oficerët e vetë për çdo çështje me rëndësi dhe sidomos për përgatitjen e betejave. Skënderbeu planifikonte operacionet luftarake në mes të reparteve ushtarake në mënyrë të përpiktë dhe arrinte t'i akordojë të gjitha aksionet luftarake si para betejës, gjatë gjithë betejës dhe pasi që përfundonte beteja. Armata arbërore kishte një strukturë komanduese efektive dhe ndërlidhja në mes të reparteve ushtarake çdo herë ishte funksionale. Efektiviteti i ushtrisë vërtetohet çdo herë sikur gjatë periudhave të luftërave po ashtu edhe në periudhat relativisht të qeta. Kastrioti e kishte organizuar ushtrinë në bazë të rregullave tradicional arbërore të trashëguara nga e kaluara a lashtë pellazge e paraqitur nga Homeri (Iliada).

Një rëndësi të veçantë Skënderbeu gjithashtu i kushtonte komunikimit me ushtarëve si para, gjatë dhe pas operacioneve luftarake. Ushtarët njoftoheshin rregullisht për të gjitha operacionet e mundshme para çdo aksioni luftarak. Pozicionimi adekuat i reparteve ushtarake ne fushëbetejë dhe komunikimi dhe koordinimi efektive i operacione luftarake në mes të divizioneve luanin një role vendimtar në suksesin e ushtrisë së arbërve kundër një superfuqie ushtarake siç ishte ushtria osmane.

Gjate fushatave luftarake secilin repart e vendoste në vendin e duhur. Kastrioti zakonisht e ndante ushtrinë në tri pjesë, në dy krahët e fushëbetejës vendoste repartet të cilat komandoheshin nga oficeret e regjur në luftërat e mëparshme ndërsa reparti i tij e mbante pozicionin qendror. Njësitë e pararojës dhe të prapavijës padyshim kishin një role të veçante. Kastrioti çdo herë zgjidhte ushtarët më të shkathtë dhe me syçelë për kryerjen e këtyre operacioneve luftarake. Ai gjithmonë i këshillonte ushtarët e këtyre reparteve që të jenë vigjilentë në mënyrë që t'i eliminojnë të papriturat, befasitë dhe pusitë të cilat mund t'i kurdiste armiku.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Shuhet një tjetër protagonist i historisë së futbollit dibran

Musa Lala, ikja pa kthim e një ikone

Nga **DEFRIM METHASANI**

Një e nga një duket se ish-ët e dikurshëm të futbollit dibran po ikin dhe se historia nis të zbehet nga dëshmitarët e gjallë të saj.

Pas Shemsi Manjanit, nga të fundit është edhe Musa Lala, ish futbollisti i Korabit që në moshën 80 vjeçare iku nga kjo botë, duke lënë pas emrin e mirë të fiksuar në një histori që kurrë s'do të venitet, veçmas ajo kohë e artë, kur skuadra e Korabit në futboll doli për herë të parë në kategorinë e parë, pra bëhet fjalë në vitet 1962-1963.

Por, cili ishte Musa Lala dhe çfarë kontributi la pas ky mjeshtër i sportit, që jo vetëm si ish-futbollist, por mbi të gjitha si njeri dhe familjarë e veprimtarë, fitoi respektin dhe admirimin e njerëzve, ndaj kujtohet edhe sot në mungesën e tij nga kjo jetë.

Musai u lind më 8 prill 1939 në Zerqan të Dibrës, një fshat ky me shumë intelektualë dhe histori. Aty ai mbaroi me sukses shkollën fillore dhe që asokohe shquhej si nxënës i përgatitur dhe i aftë për të vazhduar më lart. Studimet i vazhdoi në shkollën e mesme ekonomike në Tiranë dhe menjëherë post mbarimit të studimeve ai nis punën si ekonomist në ndërmarrjen e Nish Prodhimeve. Por futbolli, krahas shkollës, duket se ishte një pasion i dytë tepër i lakmuar i tij.

Musa Lala e dashuroi topin e rrumbullaket që kur ishte në shkollë në Zerqan, por që njohu ngjitje cilësore kur vajti në Tiranë në shkollën e mesme. Mësuesit e fizkulturës e shihnin gjithnjë si një futbollist që mund të luante me skuadra profesioniste. Gjithsesi, ai vendosi te rikthehej në Peshkopi dhe aty të niste edhe karrierën futbollistike. Starti i tij është në vitin 1959 me ekipin e të rinjve të Korabit, por falë aftësive lëvizore dhe intuitive, ai do të kalonte shpejt tek të rriturit e Korabit. Shërbimi ushtarak e ndërpreu marrëdhënien e re që sapo kish nisur me Korabin dhe shkon në Krujë, ku edhe kryente shërbimin ushtarak dhe nisi të luante futboll. Për një vit ai ishte lojtar i skuadrës krutane, ndërsa më pas rikthehet sërish tek Korabi, pikërisht atëherë kur Dibra kishte nevojë më shumë se kurrë, sepse skuadra u ngjit për herë të parë në histori, në kategorinë e parë, krahas emrave të mëdhenj si Partizani, Tirana, Dinamo, etj.

Kontributi i tij tashmë u konsolidua dhe lojtari me nr. 6 shquhej si figurë sportive popullore duke fituar edhe simpatinë e një publiku të gjerë. Karriera e tij me Korabin zgjati deri në vitin 1972, sepse të tjerë breza erdhën në skenën e futbollit dibran. Por për një dekadë që ai luajti me Korabin, dy ishin tiparet dalluese të tij. Së pari lufta e fortë sportive dhe së dyti shpirti që tregonte në lojë.

Musa Lala ishte një sportist karizmatik që bënte diferencën me vetmohimin e tij. Ai i shërbente skuadrës me energjitë pozitive që e karakterizonin. Sa herë bëheshin përvjetorë apo kumtesa e festa sportive, kujtohej emri dhe kontributi i tij, si një protagonist i atij brezi të artë që Dibra nxori në ato vite.

Në një bisedë me mjeshtrin e sportit, ish trajnerin dhe specialistin e mirënjohur Bexhet Shehu, mësojmë faktin se Musai kish fituar admirimin e tij dhe tifozëve të futbollit, sepse ai ishte një mbrojtës luftarak dhe se përpiqej që në lojë të jepte maksimumin e tij.

Kështu mendon edhe njëri nga bashkëkohësit e tij, Shuaip Methasani. "Shkoja e shihja ndeshjet e Korabit në stadium. Musai ishte në krah të Taxhit dhe që të dy bëheshin barrikadë për kundërshtarin. Sa merrte topin Musai, njerëzit brohorisnin sepse futej fort për topin e parë dhe frenonte aksionet e rrezikshme të kundërshtarit".

Pas lënies së futbollit, Musa Lala vijoi të punonte në detyra të ndryshme si revizor dhe ekonomist, qofshin këto në komitetin ekzekutiv, apo në ndërmarrjen pyjore dhe në kontrollin e shfrytëzimit të automjeteve. E gjithë jeta e tij, ishte e lidhur me njerëzit dhe korrektesa ishte tipari dallues për të.

Këshilli i Qarkut të Dibrës, në kuadrin e 75-vjetorit të krijimit të Klubit Sportiv "Korabi" e ka nderuar me titullin "Nneri i Futbolit Dibran", me motivacionin "për kontribut në zhvillimin masiv dhe përparimin cilësor të futbollit në Dibër".

Tani që ai nuk jeton, padyshim vlerë marrin kujtimet në adresë të Musait, kujtime që do të jetojnë gjatë dhe do të promovohen shpesh, duke e bërë atë një figurë të paharruar dhe mjaft popullore, jo vetëm në Peshkopi, por edhe në Tiranë, ku pas viteve 1990, si shumë të tjerë, zgjodhi të jetonte në metropol.

Komuniteti dibran ishte i shumtë në pjesëmarrje edhe në ditën e lamtumirës së tij, duke ndarë dhimbjen me familjen Lala dhe të afërmit e tyre.



VLERËSIME PËR MUSA LALËN

NJAZI SHEHU, ISH FUTBOLLIST:

Musa Lala në pozicionin e tij si mesfushor shkatërrues ishte përherë një garanci në mesin e fushës së atij ekipi të madh të asaj periudhe. Dallohej për intelektin e tij si dhe forcën shkatërruese të kundërshtarit, duke qenë një nga protagonistët e rezultateve pozitive të asaj periudhe. Nuk mund të lë pa përmendur që ai ishte shumë komunikues dhe ndihmonte me këshillat e tij edhe ne, që atëherë ishim më të rinj si unë, Mufit Shehu e të ndjerët Mustafa Melani, Njazi Qorrollari (Sadiku), e portierët Bashkim Lala e Fadil Shulku.

Në këtë periudhe ekipi ishte me përbërje gjeneratash të kombinuar, të vjetër e të rinj nga trajneri i mirënjohur Bexhet Shehu , ku luanin edhe të ndjerët Taxhedin Shehu e Islam Rama, si dhe mësuesi im Lutfi Manjani, Atli Shehu e kolegët si Remzi e Naxhi Lazimi. Pa e ekzagjeruar, ky ekip ishte shumë i respektuar dhe ndoshta nga më të vlerësuarit e asaj periudhe si nga publiku ashtu edhe nga kundërshtarët.

Largimi i tij, përveç boshllëkut që lën në familjen e tij, na prek dhe na hidhëron të gjithëve ne, që e njohëm dhe kaluam kujtime të paharruar nga ato vite.

FEHMI LLESHI - BASHKËQYTETAR:

Ndarja nga jeta e ish futbollistit të Korabit të viteve 1960-1972 më preku shumë dhe më ngjalli kujtime, sepse kam pasur rastin që ta shoh në fushë kur luante si lojtar me nr. 6.

Ishte një lojtar i fortë dhe jepte më të mirën për ekipin, ku dallohej ne mesin e fushës si shkatërrues, duke ndihmuar shumë në mbrojtje. Ishte model, me disiplinë dhe korrekt gjatë lojës, duke zbatuar me rigorozitet udhëzimet e trajnerit.

Unë e njihja mirë familjarisht dhe ruaj kujtimet shumë të mirë për Musain si njeri i dashur me shokët dhe miqtë e tij. Ai krijoi një familje të mrekullueshme, bashkë me bashkëshorten Drita, e cila edukoi breza të tërë si mësuese dhe fëmijët Fatbardhin, Adrianin dhe Elsën, duke dhënë kontributin e tyre në shoqëri, nën shembullin e babait të tyre, Musa Lala.



Në foto: Ekipi i Korabit në vitet '65. I pari, djathtas, ulur: Musa Lala.

homazh

Ndahet nga jeta veterani **Elez Murra**

Më 18 janar 2020 u nda nga jeta një figure e nderuar dhe mjaft e respektuar e Grykës se Vogël, veterani Elez Murra. Mjaft qytetarë u mblodhën si rrallë herë për t'i bërë nderimet e fundit e përcjelljen në banesën e fundit, këtij qytetari fisnik, mik i të gjitha moshave, burrë i zakonit e i parimit, human e me zemër të madhe, bamirës e përkrahës i atyre në nevoje, dashamirës i progresit e i përparimit shoqëror, mbartës i vlerave të larta njerëzore , një simbol i krahinës së vet e i Dibrës mbarë që do të kujtohet e nderohet me respekt nga brezat që do të vijnë.

Atë e përcollën me dhimbje të madhe jo vetëm familjarët e tij, por në një pjesëmarrje jo të zakonshme mjaft miq e dashamirë nga fshati e zona, nga Bulqiza e Dibra, por dhe mjaft të tjerë të ardhur nga Tirana e rrethe të tjera te vendit. Po kush ishte kjo figurë popullore që meriton nderime kaq të mëdha e të veçanta.

Elez Murra lindi në një familje të varfër fshatare në Shupenzë 89 vjet më parë. Aty kryqëzohen rrugët për në Dibër, Gollobordë, Dibër e Madhe, Selishte, Bulqizë, Mat etj. Ai u rrit dhe u edukua në një mjedis të shëndoshë e patriotik me vlerat e një dibrani e shqiptari të mirë. Konaku i Ramiz Murrës, xhaxhait të tij, priti e përcolli miq e dashamirë dhe patriotë e luftëtarë si mjaft familje të tjera të Shupenzës e të Grykës së Vogël. Babai i tij Rushit Murra ishte një njeri i urtë e punëtor që u muar me bujqësi e blegtori, por dhe një shqiptar e prind i mirë që ndikoi fuqimisht në formimin e dhe edukimin e tij.

Në moshë të re, Elezi në shtëpinë e tij dhe në odat e Dibrës u njoh me heroizmat e Isuf Murrës, Selman Kurtit, Mersim Demës, Rrahman Lekës, Ramiz Dacit, Jakup Canit, Dan Camit e shumë të tjerë, u njoh me ngjarjet si Kuvendet e Dibrës te varret e Shupenzës, Gropën e Ukut, Fushë të thatë Gjoricë, Gjurën e Mazhicës e plot histori të patriotizmit të krahinës e të mbarë Dibrës. Edhe pse i ri në moshë, ai përcolli si pjesëmarrës e dëshmitar aktiv shumë ngjarje të luftës nacionalçlirimtare. Ai i jetoi ato vite në mënyrë aktive e fuqimisht duke shërbyer si udhërrëfyes apo korrier për çetat partizane si atë të Grykës së Vogël, të Grykës së madhe apo të Gollobordës për të dalë në mal të Homeshit, në pyjet e Tërnovës, në drejtim të katër grykëve apo të Okshtunit.



Elez Murra mori disa urdhra e medalje, por po veçojmë atë që i dha popolli i Shupenzës, emërtimin e njeriut të mirë që e shoqëroi gjithë jetën dhe që ai e mori me vete. Kryetari e veteranëve të zonës, Xhevat Jella, mbajti një fjalë në ceremoninë e varrimit të tij. Prandaj ne u mblodhëm nga të katër anët e vendit për ta përcjellë në banesën e fundit njeriun e mirë Elez Murra.

Pas çlirimit ai do të ishte një aktivist i mirë i reformave të kohës dhe një punonjës shembullor kudo që i takoi të punonte. Gjatë viteve 1952-1954 kreu shërbimin ushtarak, më pas punoi në postë telegraf. Në vitet 1959-1972 ishte punonjës i ndërmarjes së grumbullimit dhe iu krijua mundësia të njihej me gjendjen ekonomike të fshatrave nga Maqellara deri në Steblevë, i rifreskoi miqësitë e vjetra të familjes dhe krijoi të tilla të reja për efekt të detyrës që kryente.

Pas vitit 1972 punoi në Kooperativën bujqësore Shupenzë, fillimisht si brigadier dhe më pas si drejtues i niveleve më të larta. Në këto detyra ai njohu më nga afër hallet dhe problemet e fshatit, njohu njerëzit, punëtorët, hileqarët, dembelët, por mbi të gjitha shqetësimet e familjeve fshatare për furnizimin, ushqyerjen, mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve, mënyrën e jetës dhe plot shqetësime të tjera. Si dëshmitar të kohës e kemi parë se rrallë kush si ai jetoi me hallet e popullit dhe mori pjesë në zgjidhjen e tyre.

Në vitet 1972- 1981, kreu detyrën e Sekretarit të Byrosë së partisë për zonën e Shupenzës, një detyrë kjo e rëndësishme dhe delikate për kohën. Kush ka punuar me të është i gatshëm të dëshmojë se ai e kreu me devotshmëri detyrën, se u përpoq të bënte më të mirën, se ishte luajal dhe mjaft i arsyeshëm në zgjidhjen e problemeve, se në shpirtin e tij kishte dashuri për njerëzit dhe kjo e bënte të ishte kundërshtar i fortë i çdo qëndrimi sektar, simbol i njeriut të mirë e siç populli i thotë, i njeriut babaxhan. Me këtë frymë ai së bashku me bashkëshorten, Nadiren, rriti dhe edukoi edhe fëmijët e tij. Ai i shkolloi shumë prej tyre me arsim të lartë, gëzoi shumë nipër e mbesa që e deshën dhe i deshi shumë.

U përpoq pa u lodhur asnjëherë të jepte drejtësi, të nxiste të renë e përparimtaren në jetën e komunitetit ku jetoi, të nxiste emancipimin e gruas dhe rolin e saj në jetën e vendit dhe të përmirësonte nivelin dhe kulturën e jetesës në fshat e në shoqëri.

Për efekt të detyrave që kryente, por edhe për prirje personale, ai priti me ngrohtësi dhe krijoi marrëdhënie pune e njerëzore me mjaft kuadro që erdhën e punuan në Shupenzë në ato vite. Ai lidhi miqësi me shumë prej tyre, miqësi që nuk u shkëput asnjëherë edhe kur ata u larguan prej andej. Ai mbeti mik i përjetshëm i Nazmi Koçit, Laze Dautit, Tajar Petanit, Fehmi Agollit, Alfred Sopit e shumë kuadrove të tjerë që punuan e jetuan me vite në Shupenzë. Kuadrot, komunistët dhe populli i Shupenzës e deshën Elez Murren , pikërisht për cilësitë e tij morale e njerëzore.

Në vitin 1982 , pas lodhjeve e peripecive që kishte kaluar, u dërgua të punonte magazinier në spitalin e Shupenzës, detyrë që e kreu më së miri. Ka qenë e veçantë e tij fakti se nuk qe një punonjës i thjeshtë aty, por që shqetësohej për fatin e të sëmurëve aty, për furnizimin me ushqime e ilaçe, për shërimin e shpejtë të njerëzve dhe rehabilitimin e tyre. Me atë natyrë njerëzore që pati, ai ishte bashkëpunëtor i afërt i mjekëve dhe i gjithë personelit mjekësor të spitalit.

Me ndjenjën e lartë të një patrioti dibran, Elez Murra i ndoqi me vëmendje ngjarjet në Kosovë, luftën dhe përpjekjet e vëllezërve atje dhe u lumturua për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës.

Në prill të vitit 1999, ai pati nderin të priste në shtëpinë e tij , komandantin ilegal të UÇK, Ashim Thaçin dhe darkoi e bisedoi gjatë me të. Me nipërit e djemtë tij ai e përcolli atë shëndoshë e mirë përmes Gjoricës duke e kaluar nëpër Drinin e Zi në kufirin me Maqedoninë e Veriut. Bëri atë që kishte bërë edhe gjatë luftës nacionalçlirimtare dhe që ai e njihte mirë. Hashim Thaçi e thërriste "Bace" dhe ndoshta për herë të parë e shqiptoi në Shupenzë thënien e tij proverbiale "Bacë u krye". Dhe Elez Murra ishte shqiptari i parë që e dëgjoi këtë thënie aq të dëshiruar për çdo shqiptar.

Elez Murra mori disa urdhra e medalje, por po veçojmë atë që i dha popolli i Shupenzës, emërtimin e njeriut të mirë që e shoqëroi gjithë jetën dhe që ai e mori me vete. Kryetari e veteranëve të zonës, Xhevat Jella, mbajti një fjalë në ceremoninë e varrimit të tij. Prandaj ne u mblodhëm nga të katër anët e vendit për ta përcjellë në banesën e fundit njeriun e mirë Elez Murra. Qofsh i pa harruar dhe i përjetshëm kujtimi juaj i dashur mik.

Bashkim Lleshi, Nazmi Koçi, Shyqyri Balla, Qazim Zebi, Xhevat Jella, Besnik Xhepa.

SKICË NGA SELMAN MËZIU

Ushtimat e një mentari

Trupi i tij gjatosh, eleganca në ecje e komunikim, veshja e tij e bukur, kultura e gjanë, aftësia depërtues, njohës i psikologjis së nxanësit, kolegëve dhe vete fshatarëve e shndërruan Xhemal Berishën në një shtatore të pavdekshme, shëmbëlltyrë e intelektualit shkëlqim yjor e bilbilit të historisë e mësuesisë.

(Vijon nga faqja 16)

Kuptohet edhe shkruar. Mësuar brezave të rinj. Prandaj në vitin njëmijë e nandëqind e gjashtëdhjetë e tre mbaron universitetin e dytë. Tanima ky ishte i fushës së historisë. I rrallë në llojin e vet. Orator në të folur. Lëvizjet studiuara në shpjegimin e landës së historisë. Virtytet njerëzore bashkë me kulturën e gjan e çojnë Xhemal Berishën Kryeinspektor i Arsimit për Dibrën e Poshtme. Detyrë e vështir për një moshë rinore. Duheshin aftësi organizative. Kërkohesh kujdes në veprimet, diskutimet, programet, kontrollet. Sillej me edukatë me bashkëpunëtorët. Korrektësia dhe mirësjellja kudo ku shkonte e nderuan atë në çdo vit pune.

Lëvizje kuadri. Burokracia sëmundje fashitëse. Gjallëria duhesh në arsimimin e nxënësve. Prandaj emërohet drejtor i shkollës tetëvjeçare në Fushe Çidhën. Lufta e klasave vepronte. Marksizmi sundonte. Mësuesit duhet të ishin metodist. Por drejtor Xhemali ishte psikolog. Ai kishte aftësi depërtuese. Ai të lexonte në sy. Lëvizjet e fytyrës, hijeshin e ballit e kishte hartë të karakterit. Kështuqë ai shprehesh lirshëm, sakt e bënte për vete nxanësin, mësuesin. Prindin e bindte me argumenta për fëmijën e dobët në mësime. Kontrollonte ditaret e mësuesve. Bënte vërejtje. Bashkërisht me mësuesit organizonin mësim shembullor. Përfundimet i nxirrte dhe shtronte detyra për të ardhmen.

Përsëri kalon drejtor në shkollën e Kastriotit. Më pas kthehet po me këtë detyrë në vend lindje. Dhe e mbaron karrierën si i tillë në Hurdh Muhur. Një veprimtari shkëlqimtare për dyzetë e pesë vjet. Metodist në mësimdhënie. Organizator i pashoq. Ai shpesh theksonte se mësuesi është si një bujk i mirë, që hedh farën në hulli. Ardhshmëria e rendimenti varen nga agroteknika e përdorur. Mësuesi duhet të përgatis ditarin. Të shpjegoj me plot art. Të pyes në mënyra të ndryshme. Në kërkesa të jetë serioz. Me pyetjet të kërkoj thelbësoren e mësimit. Të paraprijë me edukatën dhe kulturën. Përgatitur kështu, nxënësit udhëtojnë vet drejt shkollës së mesme dhe universiteteve.

Xhemali dinte të prashiste arën, të ujiste e vilte, misrin e groshën. Ai e vinte për bukuri mullarin me gjethë dushku e jonxhë. Xhemali përdorte kosën, draprin dhe sopatën për të prerë dru. Dinte të milte lopën e t'i ushqente me normativa zooteknike. Ishte njëkohësisht bujk e shtëpiak.

Në kuvendet e odave ai ishte orator. Të gjithë e vështronin në sy. E dëgjonin me kureshtje e vëmendshmëri. Ai ju përgjigjesh pyetjeve mbi prejardhjen e fiseve të muhurrit. Mbi Mazrekasit. Qytezat antike e betejat kundër turqëve, serbëve e dhjetëra armiqve të tjerë. Ai ishe ciceron i vërtet. Njohës i shkëlqyer i historisë së vendlindjes. Prandaj shoqëroi gjithë andej historianët Kristo Frashëri, Stefanaq Pollon. Ndërsa debatonte, bashkëpunonte me historishkruesit dibran Hilmi Sadiku, Hysen Lala e dhjetëra të tjerë. Ai gjithmonë , lexonte, studionte. Kujtesa e tij ishte e pashtershme.

Te ish nxënësit e tij, ai mbolli pemën e respektit. Farkëtoi vullnetin, zellin e domosdoshmërin për studime. Ndershmëria në detyre, çiltërsia në komunikim ishin virtyte të pjalmuara te kolegët e nxanësit e tij. Drejtori i pothuajse gjysmë shekulli urrente hipokrizinë, ai t'i thoshte të metat e gabimet ballë për ball.

Trupi i tij gjatosh, eleganca në ecje e komunikim, veshja e tij e bukur, kultura e gjanë, aftësia depërtues, njohës i psikologjis së nxanësit, kolegëve dhe vete fshatarëve e shndërruan Xhemal Berishën në një shtatore të pavdekshme (16.XI.2012), shëmbëlltyrë e intelektualit shkëlqim yjor e bilbilit të historisë e mësuesisë.



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

NE jemi gazetë e lirë dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.** Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603



SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, 100 m² kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe 2 të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është 200 m² + magazinë, qilari është 30 m².
Bari - 30 m² brenda dhe 140 m² ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: *068 65 08 441* *ramizgjini@yahoo.com*





Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE.

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing.

Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

cyan magenta yelloë black